



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.07.2016, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të komisionit datë 12.07.2016 dhe 13.07.2016.
2. Shqyrtimi nen per nen i projektligjit “Per organet e qeverisjes se sistemit te drejtesise” .
3. Shqyrtimi nen per nen i projektligjit “Per rivleresimin e gjyqtareve dhe prokuroreve”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Petrit Vasili dhe Vexhi Muçmata.

Mungon:

Oerd Bylykbashi, Spartak Braho, Keltis Kruja, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Agnes Bernhard, eksperte e Nivelit të Lartë

Gent Ibrahim, ekspert i Nivelit të Lartë

Rainer Deville, ekspert i Nivelit të Lartë

Aurela Anastasi, eksperte e Nivelit të Lartë

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëdita!

Ju kërkoj ndjesë për vonesën, por ishte për një arsye objektive, shpresoj të kem mirëkuptimin tuaj, pavarësisht se paraprakisht kisha njoftuar për të!

Fillojmë mbledhjen e komisionit me projektligjin “Për funksionimin dhe organizimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Fillimisht do të dëgjojmë relatorin, e cila e ka përfunduar prezantimi në parim, janë bërë dhe pyetjet. Relatorja kërkoi kohë dhe sot momenti për të dëgjuar qëndrimin e zonjës Hysi në cilësinë e relatores. Relatimi është shpërndarë, e keni edhe mbi tryezë. Kështu që besoj se do të kem dhe mirëkuptimin e zonjës Hysi, që të bëjë një paraqitje të përmbledhur, për shkak se prezantimi në parim është bërë, pyetjet janë bërë, debati në parim është zhvilluar, njëkohësisht, edhe koha që kanë pasur deputetët për të njohur me këtë projektligj ka qenë e gjatë dhe e mjaftueshme për të mos konsumuar një shpjegim të gjatë.

Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Ashtu sikurse thatë, ky është një ligj shumë i rëndësishëm, nuk ka ekzistuar më parë në mënyrën sesi është organizuar dhe ka funksionuar sistemi i drejtësisë. Nga vetë emërtimi i projektligjit, bëhet fjalë për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, konkretisht janë katër organe kryesore: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

Gjithashtu, bazuar edhe në propozimin që patëm ne si anëtarë të komisionit të posaçëm, ligji “Për Shkollën e Magjistraturës”, pra dispozita për rregullimin dhe funksionimin e Shkollës së Magjistraturës, është përfshirë në këtë projektligj. Në këtë kuadër, ligji tashmë kompletëhet dhe rregullon të gjithë qeverisjen e sistemit të drejtësisë.

Projektligji ka disa risi shumë të rëndësishme ose ndryshime thelbësore lidhur me rolin këtyre organeve. Gjëja e parë dhe e rëndësishme është Këshilli i Lartë i Drejtësisë, që njihet sot, i cili do të emërtohet Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Në radhë të parë, ndryshimet janë në numrin e anëtarëve, pra ka një ulje të numrit nga 15 anëtarë në 11 anëtarë; ka një ndryshim në përbërjen e anëtarëve, pasi do të ketë një përbërje pluraliste, sikurse e ka sugjeruar Komisioni i Venecias dhe praktikat më të mira të

organeve të qeverisjes në një shoqëri demokratike, 6 nga gjyqësori dhe 5 nga jogjyqësori. Ky është një proces i hapur dhe transparent zgjedhjeje ligji rregullon, në mënyrë shumë të detajuar, të gjithë procedurën e thirrjes së hapur publike, të aplikimit, të përzgjedhjes së kandidaturave dhe të votimit të tyre.

Gjithashtu, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kompetenca shumë më të mëdha seç ka pasur deri më sot, pasi përfshihen pothuajse të gjitha aspektet e administrimit të gjyqësorit, pra realisht bëhet qeveria e gjyqësorit, dhe anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor do të jenë me kohë të plotë dhe jo me kohë të pjesshme, siç kanë qenë deri më sot, në këtë mënyrë eficienta dhe kolegjaliteti i organit forcohen.

Nga ana tjetër, në ligj ka rregulla të detajuara lidhur me përgjegjshmërinë për çdo anëtar, shmangien e konfliktit të interesit, si dhe marrjen e një sërë përgjegjësive për raportimin publik dhe para Kuvendit për çështjet e gjyqësorit. Këtë doja të thosha shumë shkurt për Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Po ashtu edhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë pëson një ndryshim të strukturës, të kompetencave, të emërimit, të karrierës, të ngritjes në detyrë, të procedurave disiplinore. Flasin për një këshill prokurorie me kompetenca më të plota, me një përbërje pluraliste, me zgjedhje të anëtarëve të këshillit nëpërmjet një procedure transparente qoftë të nominimit, të aplikimit, të rregullave që duhet të përmbushin, por shumë të detajuar dhe procedurat disiplinore.

Risia tjetër në projektligj është funksionimi i hetimit disiplinor, pra inspektori i Lartë i Drejtësisë. Besoj se të gjithë e dimë se sa shumë trupa inspektorësh kemi pasur në këtë periudhë dhe konflikte ose përplasje mes tyre. Tashmë do të kemi inspektorin e Lartë të Drejtësisë, i cili do të jetë përgjegjës për verifikimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedurës disiplinore. Ka një ndarje midis atyre që hetojnë dhe atyre që ndëshkojnë për të cilët do të jetë organi ku mund të ankimohet ndaj masave disiplinore.

Gjithashtu, projektligji detajon edhe funksionimin e një organi tjetër, që është Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i cili është përgjegjës për të verifikuar nëse përmbushen kushtet ligjore dhe kriteret profesionale morale të kandidatëve jogjyqtarë dhe joprokurorë, të cilët respektivisht do të jenë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe të kandidatëve për inspektorë të Lartë të Drejtësisë dhe kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Ashtu sikurse e thashë edhe në fillim të fjalës sime, nuk do të kemi një ligj të veçantë për Shkollën e Magjistraturës, por të gjitha rregullat do të përfshihen këtu dhe ka një detajim për të rritur transparencën dhe përzgjedhjen.

Ky është një ligj që në tërësi rrit llogaridhënien, paañësinë e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, përmirëson statusin e tyre, rregullon parimet e mirëqeverisjes dhe të pavarësisë së gjyqësorit, por edhe atë që ne kishim merak *check&balance*, kontroll dhe balancë.

Projektligji ka 229 nene dhe është i ndërtuar në 6 pjesë. Unë do të hyj në detaje, por vetëm një gjë dua të theksoj. Pse kemi ardhur në këtë ligj? Unë e kam studiuar me kujdes dhe me vëmendje ligjin. Ligji pothuajse përmbush të gjitha shqetësimet që janë ngritur në raportin ose në analizën e sistemit të drejtësisë, të zhvilluar nga ekspertët e nivelit të lartë në konsultim me gjithë punonjësit e sistemit të drejtësisë, të prokurorisë, shoqërisë civile dhe të gjitha grupet e tjera të interesit. Pra, zgjidhen të gjithë ato shqetësime që janë analizuar ose janë theksuar në raport për KLD-në, për prokurorinë dhe unë nuk dua të ndalem, sepse secili prej nesh ka pasur dhe ka në dorë analizën e sistemit të drejtësisë në Shqipëri.

Megjithatë, edhe për të qartësuar, që ky ligj nuk shmang atë vendosje kaotike të neneve ose rregullimeve të ndryshme në shumë ligje.

Ashtu sikurse e thashë, për herë të parë do t'i kemi të gjitha rregullat e organizimit dhe funksionimit të këtyre organeve kryesore në një ligj të vetëm, jo vetëm kaq, por qartësohen edhe shumë kompetenca, të cilat kanë qenë të paqarta mes tyre.

Gjithashtu, në kuadër të këtyre ndryshimeve, elementi i dytë, që është shumë i rëndësishëm për qytetarët, është procesi transparent, përfaqësimi, gjithëpërfshirja në të drejtën e përzgjedhjes së emërimit të anëtarëve të organeve të qeverisjes gjyqësori. Duke qenë se është një qasje e re dhe ka një pluralitet të përbërjes së këtyre institucioneve, me të drejtë propozuesit, pra ata që kanë hartuar projektligjin, janë treguar të kujdesshëm për të rregulluar elementet në detaje në këtë projektligj, duke shmangur formulimet e përgjithshme, të cilat mund të çonin më pas në interpretime të ndryshme të ligjit.

Ka një depolitizim të procesit të emërimit dhe të anëtarëve qoftë të inspektorit të Lartë të Drejtësisë, por edhe të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Nga ana tjetër, përveç ndryshimeve që unë i përmenda, në përbërjen e organeve të qeverisjes ka edhe disa ndryshime të tjera për sa u përket kompetencave këtyre organeve.

Të nderuar kolegë, unë dua të theksoj se projektligji ka pasur parasysht të gjitha rekomandimet që ka bërë Komisioni i Venecias, por, njëkohësisht, edhe Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Europianë, SEPEJ-i, lidhur me mënyrën e organizimit të këtyre këshillave dhe kompetencat e tyre.

Nëse do të më lejoni, për ta përmbledhur, është shumë me interes të theksoj që anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë kanë kritere dhe

procedura përzgjedhjeje të kandidatëve komplet të ndryshme nga çka qenë deri më sot. Në këtë kuadër ne arrijmë të përmbushim atë parim të rëndësishëm: këto institucione duhet të jenë në shërbim të qytetarit, duhet të jenë të përgjegjshme dhe llogaridhënëse para qytetarëve.

Pa dyshim që jo çdo qytetarë mund të përfaqësohet në mënyrë individuale në këto institucione, por përfaqësimi i tyre do të bëhet nëpërmjet përfaqësuesve nga shoqëria civile. Pra, të gjithë ata që do të marrin shërbime në këtë sistem do të kenë përfaqësuesin e tyre. Pra, mendohet të ketë nga avokatia, nga noteria, nga shoqëria civile, nga fakultetet e drejtësisë, pra nga jeta akademike. Në këtë kuadër, ky pluralizëm bën që këto institucione të luftojnë atë kemi pasur merak, korporatizmin, pra të ketë një balancim më të mirë midis anëtarëve që vijnë nga gjyqësori dhe anëtarëve që nuk vijnë nga gjyqësori, por nga njerëz ose grupe, të cilat marrin shërbime në sistemin gjyqësor.

Në mënyrë të veçantë unë do të vlerësoj procedimet disiplinore ndaj gjymëtarëve, ndaj prokurorëve, si dhe faktin që ky lloj procedimi rregullohet me ligj edhe te ligji “Për statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit” dhe gjatë diskutimit nen për nen do të doja të ishim të kujdesshëm që të dyja ligjet të konvergojnë me njëri-tjetrit lidhur me rregullat, procedurat, me qëllim që këto dy ligje të harmonizohen më së miri.

E fundit, për ta përmbyllur, zyra e administrimit të buxhetit gjyqësor tashmë me këtë ligj suprimohet, kompetencat e administrimit dhe të buxhetit gjyqësor i merr Këshilli i Lartë Gjyqësor, si qeveria e sistemit gjyqësor. Pa dyshim në këtë kuadër ka një sërë rregullimesh lidhur me aspekte të tilla në dispozitat transitore apo edhe gjatë përmbajtjes së tekstit.

Lidhur me Këshillin e Emërimeve, ky është një institucion, organ i ri, i cili kujdeset për depolitizimin e procesit të emërimeve në pozicionet e larta në drejtësi, ka rregulla të detajuara, kanë synuar të shmangin korporativizmin dhe ndikimin e papërshtatshëm në emërimin e funksionarëve të drejtësisë nga klasa politike. Në kuadër të konsensusit që kërkuan kolegët e opozitës, është futur shumë elementi i shortit mes gjyqtarëve dhe prokurorëve të niveleve të ndryshme, por njëkohësisht është treguar kujdes që të ketë përfaqësim midis përfaqësuesve të gjyqtarëve, prokurorëve jo vetëm të gjykatave dhe prokurorëve të niveleve të ndryshme, por edhe atyre të Tiranës dhe jashtë Tiranës.

Zoti kryetar, në fund të fjalës sime, dua të theksoj se ky ligj shfuqizon një sërë ligjesh të tjera. Dua që grupi i këshilltarëve tanë të jetë i vëmendshëm, sepse ky ligj shfuqizon ligjin “Për krijimin e zyrës së administrimit të buxhetit gjyqësor”, ligjin “Për organizimin e funksionimit të Konferencës Kombëtare të Gjyqësorit”, ligjin “Për Shkollën e Magjistraturës”, ligjin “Për organizimin e funksionimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”. Pra, dua të di se cilat do

të jenë ishin dispozitat që preken në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë, sepse kam idenë se ky ligj do të jetë.

E fundit fare, pas miratimit në parim, unë kam komente, propozime për riformulime gjatë diskutimit nen për nen.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Besoj se jeni në dakord në parim. Ka ndonjë gjë?

Miratohet në parim.

Atëherë, mund të fillojmë me shqyrtimin nen për nen, meqenëse jemi dakord në parim.

Neni 1 “Objekti”.

Miratohet neni 1, me ndryshimin e bërë.

Neni 2 “Parimet e qeverisjes”. Dakord.

Neni 3.

Vasilika Hysi – Jemi dakord me nenin 3.

Fatmir Xhafaj – Dakord, por ky do të jetë një nen i hapur për sa kohë që nuk kemi një zgjidhje përfundimtare të formulës sesi do të përbëhet Këshilli i Lartë Gjyqësor. Kështu që do ta konsiderojmë një nen të hapur, i cili do të rishikohet në fund.

Neni 4 “Statusi i anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Vasilika Hysi – Te neni 4 kam një pyetje për ekspertët: përse anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, që do të formojnë këshillin, nuk duhet të kalojnë në procesin e vetingut? Në paragrafin 3 thuhet: “Anëtarët nuk i nënshtrohen vlerësimit të etikës profesionale të veprimtarisë gjatë kohës së shërbimit si anëtarë”.

Fatmir Xhafaj – Kjo nuk ka lidhje me vetingun. Besoj se kjo është për periudhën kur mbaron ai funksionin e tij.

Vasilika Hysi – Kjo duhet sqaruar, sepse te dispozitat kalimtare nuk është vendosur si kusht që këta fillojnë nga puna pasi të kalojnë rivlerësimin.

Fatmir Xhafaj – Po është në dispozitat kushtetuese, për sa kohë që është gjyqtar, është parim i përgjithshëm, ai do t’i nënshtrohet vetingut.

Vasilika Hysi – Por nuk është në ligj.

Fatmir Xhafaj – Po është automatikisht, është te ligji që bëhet për vetingun.

Vasilika Hysi – Atëherë, duhet ta shkruajmë dhe këtu te dispozitat.

Fatmir Xhafaj – Po nuk kemi si e shkruajmë, atje është vetingu, këtu është këshilli. Ai është ligj i përkohshëm, kurse ky ligj i përhershëm.

Gent Ibrahim – Normalisht, kjo është ideja, që ata gjyqtarë që shërbejnë si anëtarë të këshillit, gjatë asaj kohe që shërbejnë të mos vlerësohen profesionalisht, nuk ka lidhje me vetingun. Arsyeja pse ju keni shtuar: pse ndodh kështu, fakti që këta do të jenë vetë autoriteti përgjegjës për vlerësimin e gjyqtarëve të tjerë, duket pak e pazakonshme, e panatyrshme që edhe këta t'i nënshtrohen vlerësimit, të paktën atij lloji vlerësimi që i nënshtrohen gjyqtarët e tjerë.

Me sa kuptoj, në kuadrin e diskutimeve në ligjin për statusin, ju keni rënë dakord që le të mos vlerësohen si gjyqtarë, por ama të vlerësohen në një mënyrë të posaçme si anëtarë të këshillit. Jam shumë dakord me këtë ide, por edhe nëse komisioni është dakord mund ta reflektojmë, por që të ketë një formulim të ndryshëm që këta të vlerësohen si anëtarë, por jo si gjyqtarë.

Fatmir Xhafaj – Miratohet neni 4 me këto ndryshime.

Neni 5 “Shkeljet disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Vasilika Hysi – Këtu thuhet që duhet të rregullohet dhe për aq sa është e mundur të zbatohen dispozitat e ligjit. Jam dakord. Por me ndryshimet e nevojshme nuk arrij të kuptoj pse duhet të ketë ndryshime për masat disiplinore të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjithmonë për funksionin, për detyrën që kanë si anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gent Ibrahim – Për shembull, siç e dini, ligji për statusin tashmë është një kompleks i gjerë mekanizmash dhe rregullimesh, të cilat janë të paramenduara të veprojnë mbi një gjyqtar në detyrë. Për shembull, aty keni dhe transferimin si masë disiplinore, keni uljen në detyrë, keni shumë masa disiplinore, të cilat thjesht janë të panatyrshme për anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, kështu që duhet të përshtaten.

Vasilika Hysi – Mund ta përmirësojmë termin “me ndryshimet e nevojshme”?

Gent Ibrahim – Çfarë të bëjmë?

Vasilika Hysi – Termi të riformulohet, sepse kur thua “me ndryshimet e nevojshme”...

Gent Ibrahim – Atë mund ta heqin gjithë andej.

Fatmir Xhafaj – Të hiqet fare, sepse nuk ka kuptim, le të lihet “zbatohet për aq sa është e mundur” dhe kuptohet.

Miratohet neni 5, me ndryshimet e bëra.

Neni 6 “Procedurat disiplinore”.

Vasilika Hysi – Kam një pyetje për paragrafin e katërt, ku thuhet: “Procedurat disiplinore kundër anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese në bazë të ligjit”.

Gent Ibrahim – “Për Gjykatën Kushtetuese”.

Vasilika Hysi – Atëherë, duhet ta saktësojmë: “Ligjin e Gjykatës Kushtetuese”.

Dakord.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 6, me ndryshimet e paraqitura këtu në tekst.

Neni 7 .

Vasilika Hysi – Në nenin 7, germa “f” mendojmë të thuhet që në kohën e kandidimit të mos ketë asnjë anëtar të familjes, sipas përmbajtjes së ligjit “Për deklarimin e kontrollit të pasurive”, pra të heqim numrin e ligjit.

Fatmir Xhafaj – Jeni dakord?

Gent Ibrahim – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Miratohet neni 7.

Neni 8 “Mbështetja e kandidatëve”.

Vasilika Hysi – Te neni 8 kërkohet që një gjyqtar nuk mund të mbështesë më shumë se një kandidat për çdo vend vakant, por sqarimi që pata edhe me ekspertët është që ai mund të votojë më shumë se një kandidatë, nuk është e thënë që ai detyrimisht do të votojë kandidatin për të cilin ka dhënë mbështetjen.

Gent Ibrahim – Po, kështu është.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, me ndryshimin e paraqitur.

Neni 9.

Vasilika Hysi – Neni 9, te paragrafi 4 thuhet: “Thirrja shpallet në faqet zyrtare të Gjykatës së Lartë, u dërgohet të gjithë gjyqtarëve në adresën elektronike ose në çdo mënyrë tjetër të përshtatshme”. Duhet ta sqarojmë se cila do të jetë “çdo mënyrë tjetër e përshtatshme”, sepse këtë lloj forme të njoftimit nuk e kemi për rastet e tjera. Sugjeroj të unifkohet ose të sqarohet se çdo të thotë “çdo formë tjetër e përshtatshme”?

Fatmir Xhafaj – Kjo mund të jetë nëpërmjet medias...

Gent Ibrahim – Ky është një njoftim i përgjithshëm dhe për një njoftim të përgjithshëm do të mjaftonte faktikisht edhe shpallja në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. Ne thjesht për t’u siguruar, përtej çdo dyshimi, që asnjë gjyqtar nuk do të ngelet pa u informuar, kemi shtuar dhe njoftimin individual. Kjo është thjesht një klauzolë sigurie.

Vasilika Hysi – Pra, ky formulim mund të përfshijë dhe njoftimin në medie?

Gent Ibrahim – Po, patjetër.

Vasilika Hysi – Në rregull. Në qoftë se përfshihen njoftimet në media ose në një konferencë shtypi që mund të bëjmë, atëherë mund ta lëmë zoti kryetar, por vetëm se është thënë vetëm për këtë kategori, për këtë lloj thirrjeje, jo për thirrjet e tjera.

Gent Ibrahim – Mund t'i shtojmë edhe rastet e tjera.

Vasilika Hysi – Në qoftë se do ta shtojmë, në rregull.

Te nenin 10 nuk ka ndonjë gjë, është thjesht redaktim.

Fatmir Xhafaj – Dakord edhe neni 10, me ndryshimet e natyrës redaktoriale, siç janë paraqitur edhe në tekstin bashkëlidhur.

Dua të bëj me dije se të gjithë ne i kemi ndryshimet e paraqitura nga relatori, me redaktime, me rregullime për efekt të teknikës legjislative e të tjera. Nëse ju nuk jeni dakord me ndonjë nga ato, mund ta thoni, por nëse nuk e kundërshtoni, do të thotë se do marrim të mirëqenë dhe për ekonomi kohe nuk do ta lexojmë. Në rregull.

Faleminderit!

Miratohet neni 10, me ndryshimin e paraqitur në tekst.

Neni 11.

Vasilika Hysi – Për neni, 11 shprehja “nën kujdesin e kryetarit”, zoti Ibrahim ka një riformulim.

Gent Ibrahim – “Nën përgjegjësinë e kryetarit”. Jam dakord që është formulim më i përshtatshëm.

Vasilika Hysi – Edhe pikën 3, ku thuhet: “Kandidati i përjashtuar njoftohet në mënyrë të posaçme”, kemi kërkuar ta saktësojmë.

Gent Ibrahim – Do të bëhet “në mënyrë individuale me shkrim”, besoj se e thotë më qartë.

Fatmir Xhafaj – Miratohet neni 11 me ndryshimet.

Neni 12.

Vasilika Hysi – Neni 12 është në rregull.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Neni 13 “Thirrja e mbledhjes së përgjithshme për zgjidhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Vasilika Hysi – Nuk ka probleme.

Fatmir Xhafaj – Zonja Agnes kam një problem, ju kërkoj ndjesë që ju drejtova juve, sepse ndoshta nuk është për ju, është për zotin Ibrahim. Ligji parashikon në nenin 13 thirrjen e mbledhjes së përgjithshme për zgjedhjen e anëtarëve gjyqtarë. A mos do të ishte më mirë opsioni që anëtarët e Gjykatës së Lartë të votojnë për kandidatin e Gjykatës së Lartë, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të votojnë për kandidatin e Gjykatës së Apelit dhe gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të votojnë për kandidatin e Shkallës së Parë? Pse? Shpeshherë midis Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Shkallës së Parë për shkak se ka një lloj konflikt

interesi, për shkak se ata gjykojnë vendimet e gjyqtarëve të Shkallës së Parë, dhe në rastet kur ka cenim të vendimeve, prishje të vendimeve krijohet një lloj konflikti midis tyre. Kjo mund të përkthehet në qëndrime që ata mbajnë ndaj gjyqtarëve të devotshëm, të gjyqtarëve korrekt me detyrën. Ky është një merak, nuk e di. A ka pasur një alternativë që mbledhjet të jenë sipas shkallëve, në mënyrë që të kishim një shprehje më të drejtpërdrejtë të gjyqtarëve? Pse është gjykuar kështu? Mund të përgjigjet edhe zoti Ibrahim, por unë ju drejtova juve, sepse keni qenë shumë e përkushtuar në këtë proces.

Gent Ibrahim – Pa dyshim që kjo ka qenë objekt diskutimi në grupet e mbledhjes së punës. Ne në njëfarë mënyre, vumë në kandar të dyja zgjidhjet për të parë avantazhet dhe disavantazhet e secilës. Këtë që thatë ju e kemi diskutuar, po, ka një lloj padrejtësie dhe konflikti interesi, po të doni, që përfaqësuesit e Gjykatës së Apelit në organin qeverisës, efektivisht të zgjidhen me votat e gjyqtarëve të Shkallës së Parë. Këtu mund të ketë disa incentiva perverse, që ata mund të favorizojnë gjyqtarë nga Apeli, të cilët jo se janë domosdoshmërisht më të mirët, por janë ata që hyjnë në afera me gjyqtarët e Shkallës së Parë dhe shuma forma të tjera të kompromentimit të votës. Argumenti i vetëm që na shtyu ne drejt kësaj zgjedhjeje që keni në draft, është nevoja për t'i organizuar zgjedhjet në një trup relativisht të gjerë, e cila në vetvete ka një lloj antidoti ndaj rrezikut të paracaktimit të rezultatit. Pra, i vumë në kandar të dyja këto dhe na dhamë këto opsione. Në diskutimin që kemi pasur në parim, unë mbaj mend të kem thënë që zgjidhja për këtë është krejtësisht juaja. Të dyja zgjidhjet janë krejtësisht të arsyeshme, krejtësisht kushtetuese. Ju mund ta merrni vendimin këtu dhe ne, me pak mundim, mund ta reflektojmë në draft.

Fatmir Xhafaj - Në rregull, a mund të kemi një reflektim në dy opsione: opsioni i parë mund të ishte që të paktën mbështetjen ai mund ta marrë nga kolegët e shkallës së tij dhe votimi mund të jetë i përgjithshëm; Opsioni i dytë mund të jetë edhe mbështetjen, edhe votimin ta bëjë brenda së njëjtës shkallë. Mundet dikush nga sekretariati teknik ta bëjë këtë gjë dhe ta rishikojmë edhe një herë. Mund të qëndrojë edhe kjo, nuk ka asgjë, por më shumë arsyetoj sesi mund të ishte më mirë, sesa jam personalisht partizan i kësaj apo i asaj. Në qoftë se ju na paraqisni avantazhet e njërës dhe disavantazhet e tjetrës, jam dakord. Në qoftë se në një material prej dy faqesh na i përmbledhni se kjo formulë ka këto avantazhe dhe këto disavantazhe, që të kemi mundësi që ta diskutojmë, gjithsesi në parim ne shprehemi pro, por me këtë rezervë që të bëjmë një diskutim për këtë çështje.

Në rregull.

Kalojmë te neni 14 “Kuorumi”.

Vasilika Hysi – Është në rregull.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, duke e marrë të mirëqenë zgjidhjen.

Neni 15.

Vasilika Hysi – Kam propozuar që fjala “peticion” të zëvendësohet. Zoti Ibrahim ka dhënë një sugjerim.

Gent Ibrahim – Dakord që ta bëjmë “kërkesë”, pasi është më shqip.

Fatmir Xhafaj – Edhe në çdo version pak a shumë thirrja për mbledhje do të mbetet, edhe sikur të jetë sipas shkallëve përsëri kryetari i Gjykatës së Lartë do ta drejtojë në të tria shkallët.

Gent Ibrahim - Nuk është problem, sepse rregullohet edhe në versionin final.

Fatmir Xhafaj - Neni 16 “Procesi i votimit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Vasilika Hysi – Pranohet riformulimi që zoti Ibrahim bëri për rolin që luan kryetari i Gjykatës së Lartë.

Fatmir Xhafaj – Në rregull, me ndryshimin e paraqitur dhe në reflektim të ndryshimit të mëparshëm.

Neni 17 “Numërimi i votave”.

Vasilika Hysi – Po, e njëjta gjë, pra të mos themi “nën kujdesin kryetarit të Gjykatës së Lartë”, por “në përgjithësi”.

Fatmir Xhafaj – Miratohet me ndryshimet e bëra, “me procesverbal tek akti final”.

Vasilika Hysi – Tek akti final e kemi përmendur shumë herë, zoti Ibrahim, në shumë nene, mund të themi se cili do të jetë akti, do të jetë vendim, procesverbal, apo do t’ia lëmë ta caktojë...

Fatmir Xhafaj – Është vendimi i komisionit.

Vasilika Hysi – Duhet të jetë vendim komisioni.

Gent Ibrahim - Mund ta zëvendësojmë me “vendim”.

Vasilika Hysi – Atëherë, që mos ta përmendim vazhdimisht, “vendim komisioni”.

Fatmir Xhafaj - Ashtu siç bëjnë në votimin në Kuvend, komisioni nxjerr vendimin dhe mbarojë.

Vasilika Hysi – Atëherë, e lëmë “me vendim” dhe kjo, zoti kryetar, na shmang çdo lloj komentit në shumë nene. Akti përfundimtar duhet të jetë një vendim, sepse mund të shkojë në gjykatë ai të ankimojë.

Fatmir Xhafaj – Neni 18 “Ankimet kundër vendimeve të mbledhjeve”.

Vasilika Hysi – “Të kontestuara” e kemi hequr si fjalë, te paragrafi i parë jemi dakord.

Fatmir Xhafaj - Dakord neni 18, me ndryshimet e bëra.

Neni 19.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, te ky kapitull duhet të reflektojmë draftin e ndryshimeve kushtetuese të 14 qershorit. Ne kemi kërkuar që në parlament do të vijë 5 kandidatura nga secili grup, kurse këtu diku thuhet 3 kandidatë të propozuar, diku thuhet kandidat i vetëm, diku thuhet 2.

Fatmir Xhafaj – Tani, të gjitha këto janë dispozita që janë në diskutim. I kam lexuar këto dispozita siç janë këtu dhe reflektojnë pak a shumë edhe frymën e negociatave që po bëhen tani. Pra, janë reflektuar, ka një ndërthurje midis asaj që është duke u diskutuar dhe asaj që është në normën kushtetuese. Për këtë shkak ne do t'i kalojmë të gjitha këto në parim dhe, natyrisht, pastaj do të jenë 3, do të jenë 5, do të jenë 2 nga avokatia, 2 nga shoqëria civile do t'i shikojmë në proces, por ata e kanë derën e hapur. Për shembull, kushtet e mëposhtme, sepse kushtet njësoj janë edhe si të zgjidhen 3, edhe si të zgjidhen 5. Si të zgjidhen nga avokatia, si të zgjidhen nga noteria kushtet pak a shumë ne do t'i shikojmë, sepse janë gati të njëjta.

Dakord?

Vasilika Hysi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Kështu që do t'i votojmë për këto elemente, elementet që janë të ndryshueshme nuk do t'i prekim, nuk do t'i përputhim as me Kushtetutën, sepse do të ndryshojnë, në çdo version do të ndryshojnë.

Vasilika Hysi – Më fal, t'ju bëj edhe një pyetje, meqenëse jeni më afër me negociatave.

Fatmir Xhafaj - Jo, unë nuk jam më afër negociatave, jemi të gjithë afër negociatave.

Vasilika Hysi – Ne kemi thënë te Kushtetuta, Këshilli i Emërimeve i rendit.

Në ndryshimet kushtetuese kemi thënë se Këshilli i Lartë i Emërimeve i rendit kandidatët, ndërsa këtu thuhet i rekomandon. Do të pranojmë renditjen, apo...

Fatmir Xhafaj – Ne do të mbajmë renditje dhe më pas do të shikojmë nëse do të biem dakord.

Gent Ibrahim – Ka edhe një mënyrë, që gjithçka që është këtu të reflektojë 100% atë versionin e 14 qershorit dhe më pas ndryshimet të bëhen në momentin e fundit. Madje unë do të thosha që të bëhen kudo ndryshime sipas 14 qershorit.

Fatmir Xhafaj – Dakord!

Ishim përgatitur që do ta arrinim konsensusin, por na zuri shqyrtimi pa arritur konsensusin, kështu që le të ngelemi te 14 qershori dhe më pas e reflektojmë. Më pas ju e keni të lehtë.

Atëherë, biem dakord që do të kihet ky reflektim për çdo nen, që të mos zgjatemi.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, kam edhe një pyetje në parim. Në paragrafin e katërt të këtij neni thuhet: “Dhomat bëjnë propozime të kandidatëve”, nuk e di sa e ka pasur parasysh grupi sa dhoma ka pasur me nga nën 5 anëtarë, sa dhoma ka pasur...

Fatmir Xhafaj – Nuk ka rëndësi sikur të jetë 1, sikur të jenë 5, çfarë rëndësie ka?

Vasilika Hysi - Që të krijohet një barazi, jo disa të favorizohen për shkak se...

Fatmir Xhafaj – Ato vetvetiu nuk janë të barabarta për sa kohë që ke vendosur kriterin numerik. Pastaj 70% mund të jenë nën 50, do të propozohet 1, por gjithsesi në çdo rast ne jemi të bindur se duhet të jenë rreth 30 dhoma avokatie, apo jo?

Gent Ibrahimi - Diçka e tillë, por më pak janë.

Fatmir Xhafaj – 26 janë sa kanë qenë.

Vasilika Hysi – Atëherë, do të vijnë 26 kandidatë.

Fatmir Xhafaj – Minimumi janë 26 kandidatë. Në rastin më të keq, si të thuash, por që nuk ndodh, janë të paktën 26 kandidatë, kështu që jemi në rregull.

Gent Ibrahimi – Janë shumë më tepër.

Fatmir Xhafaj – Sigurisht, po marr sikur të jenë të gjithë, edhe ata që janë nën 50 e kanë të garantuar 1. Po marr një gjë teorike, por jam dakord me ju se mund të jenë edhe shumë më tepër, mund të jenë gati dyfishi.

Zonja Hysi, besoj se nuk kemi gjë tjetër?

Vasilika Hysi – Nuk ka gjë.

Fatmir Xhafaj – Dakord, me ndryshimet që thanë: në përputhshmëri me Kushtetutën, me projektin kushtetues, që është dorëzuar në parlament.

Neni 20.

Vasilika Hysi – Është në rregull.

Fatmir Xhafaj – Neni 21 ka vetëm një redaktim fjale në paragrafin e tretë, “mosbërja e shpalljes”, do të themi “mosshpallja e thirrjes”, që ta kemi njëloj me terminologjinë që përdorim.

Fatmir Xhafaj - Në rregull.

Neni 22.

Vasilika Hysi – Te neni 22 kisha një pyetje, sepse nuk e di sa ekonomike do të jetë që çdo kandidat të shprehë interesin dhe të çojë dosjen si te sekretari i Përgjithësim i

Dhomës së Avokatisë dhe te sekretari i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Zoti Ibrahim: pse duhet aplikimi ose shprehja e interesit me shkrim t'i drejtohet njëkohësisht kryetarit të Dhomës të Avokatisë, sekretarit të Përgjithshëm të Dhomës së Avokatisë, sekretarit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë? Pra, duhet t'i drejtohet njëherazi tre personave.

Gent Ibrahim – Në fakt, ngaqë ka skepticizëm nga shumë vëzhgues të jashtëm të këtij procesi për integritetin e zgjedhjeve që do të bëhen në nivelin e dhomave vendore, qoftë tek avokatia, qoftë te noteria, jemi përpjekur të fusim sa më shumë elemente garantimi, që të themi titullarët e dhomave vendore nuk do ta manipulojnë procesin. Për shembull, unë e çoj dosjen time aty në dhomën vendore në Vlorë, por njëkohësisht e sjell edhe në Tiranë dhe kjo na siguron që nuk bëhen lojëra, pra është një përpjekje për garanci. E bën pak më të ngarkuar për kandidatët, sepse duhet të bëjnë dy kopje dosjesh: njëra do të depozitohet në dhomën vendore dhe tjetra në dhomën kombëtare.

Fatmir Xhafaj – Mund ta bëjmë edhe që, siç i çon kryetari i Dhomës së Avokatisë kërkesën me shkrim, t'i çojë dhe sekretari i Përgjithshëm Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe te sekretari i Përgjithshëm çon vetëm dosjen.

Gent Ibrahim – Më falni, dosjen vetëm ku?

Fatmir Xhafaj – Kërkesën vetëm te Dhoma e Avokatisë përkatëse, vendore, kurse të ajo çon vetëm kërkesën që të regjistrohet se ky njeri ka bërë kërkesë, thjesht që ata të ndjekin procesin dhe Dhoma e Avokatisë shpall publikisht se kush ka kandiduar, që të dihen në faqen e tyre zyrtare, në përfundim të afatit dhe thotë se në Dhomën Avokatisë së Vlorës kanë bërë kërkesë 3 veta, 1, 2, 3 dhe e nxjerr në faqen zyrtare të saj, dhe është transparente dhe fakti i bërjes së kërkesës.

Miratohet me ndryshimet.

Neni 23 “Verifikimi i plotësimin të kushteve ligjore”.

Vasilika Hysi - Kemi ndryshuar te pika 2: “njoftimi do të bëhet në mënyrë individuale me shkrim”.

Fatmir Xhafaj – Dakord, me ndryshimin e paraqitur.

Nenin 24 dakord.

Vasilika Hysi - Neni 25 dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 26 “Kuorumi” dakord.

Neni 27 “Procesi i votimit”.

Vasilika Hysi– Kemi thënë: “nga individual”, “vetjak”, kemi bërë thjesht unifikim të fjalëve.

Kam një pyetje dhe e kam në parim për disa nene. Në administrimin e procesit të votimit krijohet një komision votimi dhe përbërja e komisionit të votimit ndryshon në varësi të grupit të anëtarëve ose të kandidatëve që përzgjidhen, ndryshe te rasti i kandidatëve për avokatinë, ndryshe për noterinë, ndryshe për personat që vijnë nga shoqëria civile e të tjerë.

Fatmir Xhafaj - Shoqëria civile nuk ka dhomë.

Vasilika Hysi – Avokatia dhe noteria kanë të njëjtin organizim, pra kanë dhomë, kanë sekretar, diku thuhet kryetari, diku thuhet presidenti i noterëve. Pyetja ime është: pse duhet të bëhet ky administrim nga kryetari i dhomës, nga sekretari i dhomës, pra nga këta që janë drejtuesit e lartë? E kam pyetje për t'u qartësuar dhe nuk bëj më për nenet e tjera.

Gent Ibrahimi – Ka dy shpjegime për këtë rregullim.

Shpjegimi i parë është se në çdo rast ne jemi përpjekur të reflektojmë realitetin institucional brenda grupimeve të ndryshme profesionale, pra ato tituj dhe ato funksione që eksitojnë tek avokatia dhe noteria i kemi përfshirë në këtë proces.

Arsyeja e dytë është se e mbajmë këtë nivelin e votimit në një nivel shumë të lartë, qoftë edhe me riskun se këta njerëz ta neglizhojnë pak këtë detyrë, është një përpjekje për të siguruar integritetin e procesit. Ne imagjinojmë që në praktikë numërimin e votave nuk kanë pse ta bëjnë këta, por ky proces të bëhet nën përgjegjësinë e tyre...

Fatmir Xhafaj - Sepse ata kanë zgjedhur për të administruar edhe punët e tyre, pastaj ne të krijojmë një komision; ai i komisionit “s’jam, do të iki në Tiranë, jam në gjyq, nuk jam në gjyq”, kurse ky do të marrë një institucion keni të drejtë.

Biem dakord me ndryshimin e bërë për nenin 27.

Neni 28 “Numërimi i votave”.

Vasilika Hysi – Është procedurë. Më vjen mirë që i kanë rregulluar në mënyrë të detajuar, si në Kodin Zgjedhor.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 29 “Ankimet kundër vendimeve...”.

Vasilika Hysi – Edhe kjo është procedurë.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Faleminderit!

Neni 30 “Thirrja e mbledhjes së Këshillit të Përgjithshëm”. Dakord.

Neni 31. Besoj se jeni dakord edhe për nenin 31.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, të vetmen gjë që do të lëmë hapur është: sa kandidatura do t'i shkojnë Këshillit, se këtu thuhet 3?

Fatmir Xhafaj – Thamë që do të ndjekim Kushtetutën, projektin që është depozituar në Kuvend për votim. Nëse ai do të ketë ndryshime, do të reflektojë këtu. Nëse

çmenden deputetët dhe e votojnë kështu siç është, me shumë lumturi, me shumë brohoritje, çfarë do të bëjmë ne?! Do ta respektojmë. Do t'u themi që kemi bërë ligjin ndryshe dhe na falni?! Shyqyr ata çmenden pozitivisht!

Vasilika Hysi – Zoti Brahimi, kam një pyetje në parim: ju thoni që thirrja do të botohet gjithmonë në faqen zyrtare, por do t'u çohet personalisht edhe në adresën elektronike të të gjithë anëtarëve. Në dijeninë tuaj, të gjithë anëtarët e Dhomës së Noterisë dhe Avokatisë kanë adresa elektronike?

Gent Ibrahimi – Ne nuk e dimë këtë, por shpresojmë që ky rregullim ligjor të jetë një shtysë që Dhoma Kombëtare e Avokatisë të bëjë një listë të plotë dhe të përditësuar me adresat e tyre. Do t'i detyrojë kjo. Çdo institucion me anëtarësi, sipas mendimit tim, duhet të ketë një listë të përditësuar të adresave elektronike, sepse është mënyra e komunikimit të së ardhmes.

Vasilika Hysi – Meraku im është të mos shmanget asnjë avokat, asnjë noter i cili nuk ka një adresë elektronike.

Gent Ibrahimi – Në rast se ka ndonjë specie që nuk ka adresë, do të kemi një problem, por besoj se duhet ta bëjmë pjesë të kulturës juridike-legjislativë këtë konceptin që çdokush duhet të ketë një adresë elektronike, sepse është si të kesh adresë shtëpie sot. Besoj se hedhim një hap të guximshëm sot.

Fatmir Xhafaj – Besoj se nuk ka avokat që nuk ka adresë elektronike. Në qoftë se ka, të mos vazhdojë të jetë më avokat. Në vitin 2016 po kërkon adresë elektronike nipi im 7 vjeç. Thotë: “ku e kam email-in tim”.

Pra, jemi dakord me nenin 31.

Neni 32. Dakord.

Neni 33.

Vasilika Hysi – Kemi vetëm redaktim fjalësh.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord me ndryshimin e nenit 33.

Neni 34.

Vasilika Hysi – Te neni 34 kam një pyetjet për paragrafët 5 dhe 6. Këtu thuhet se procesverbalet origjinale të pjesëmarrjes në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm i dërgohen menjëherë Kuvendit dhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Pse duhet t'i vijë edhe Kuvendit, edhe Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, kur është ky i fundit, sipas projektit kushtetues, që ia përcjell njoftimet dhe dokumentacionin Kuvendit të Shqipërisë?

Gent Ibrahimi – Jam dakord me ju, duhet të kufizohet vetëm te Këshilli për Emërimet në Drejtësi.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord me ndryshimet e nenit 34.

Neni 35.

Vasilika Hysi – Të lutem, po kthehem edhe një herë te paragrafi 6. Edhe këtu do t'u përcillet zyrtarisht shpallja e kandidatëve...

Fatmir Xhafaj – Njësoj është.

Vasilika Hysi – Pra, është e njëjta gjë: do t'i përcillet vetëm Këshillit të Emërimeve dhe ky i fundit do t'ia transmetojë Kuvendit.

Fatmir Xhafaj – Neni 35.

Dakord.

Neni 36.

Vasilika Hysi – Propozimi është që të përshtatet me ndryshimet kushtetuese dhe me gjuhën e ndryshimeve kushtetuese.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 37 “Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga noteria”.

Vasilika Hysi – Është i njëjti problem. Paragrafi i parë do të jetë sipas ndryshimeve kushtetuese, pastaj të tjerat nuk kanë probleme.

Fatmir Xhafaj – Neni 38.

Vasilika Hysi – Te neni 38, është gjuhë terminologjike, do të përdorim fjalët “kryetari i dhomës vendore”.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 39.

Vasilika Hysi – Edhe neni 39 nuk ka probleme.

Fatmir Xhafaj – Neni 40.

Vasilika Hysi – Edhe te neni 39 është vetëm problemi i gjuhës. Kam një pyetje në parim: këtu kemi parashikuar dy kritere shumë të rëndësishme, zoti kryetar, që personi do të lëshojë një deklaratë që nuk ka qenë bashkëpunëtor etj. Meqenëse afati i verifikimit është shumë i shkurtër (edhe në diskutimin që pata më parë me zotin Ibrahim), është përgjegjësi e tij, në qoftë se gënjen, nuk tregon të vërtetën lidhur me faktin nëse është bashkëpunëtor, informator apo agjent, për aq kohë sa të ngrihet autoriteti, i cili do të bëjë verifikimet përkatëse për periudhën para viteve '90.

Gent Ibrahim – Dua të shtoj se këto nuk janë nga ato çështje që verifikohen brenda atij 7 ditëshit, por janë çështje që rrinë në dosje dhe të cilat mund të bëhen shkas për...

Fatmir Xhafaj – Më fal, a e keni shtuar këtë të dekriminalizimit?

Vasilika Hysi – Integriteti i figurave në disa vende është, në disa të tjera nuk është.

Fatmir Xhafaj – I gjithë modeli i deklaratës duhet të plotësohet. Të vëmë një standard.

Vasilika Hysi – Mund ta shtojmë për të gjithë.

Fatmir Xhafaj – Po. Do ta kërkojë më vonë Kuvendi. Ai duhet ta ketë pjesë të dosjes, kur ta shqyrtojë Këshilli i Emërimeve.

Vasilika Hysi – Me këtë rast e vëmë një herë e mirë.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord me ndryshimet e nenit 40.

Neni 41.

Vasilika Hysi – Te neni 41 është ky shqetësim: ne themi se brenda 7 ditëve mbyllet afati i dorëzimit dhe bëhet verifikimi. Sikurse tha edhe zoti Ibrahim, dy nga kriteret e përmendura në nenin 40, “c”-ja dhe “d”-ja, nuk mund të verifikohen brenda 7 ditëve. Prandaj duhet ta modifikojmë formulimin që të mos e detyrojmë tjetrin që, meqenëse nuk ka një përgjigje për germa “c” dhe “d”, të mos merret përgjigja për...

Fatmir Xhafaj – Ben verifikimin e dosjes.

Gent Ibrahim – Faktikisht, ato nuk janë kushte. Ato kërkohet të jenë në dosje, sepse kushtet janë të tjera.

Vasilika Hysi – Te neni 41 thuhet: “Mund të bësh përjashtimin e kandidatit, në qoftë se nuk plotëson kriteret e nenit 40”.

Gent Ibrahim – Faktikisht ky është gabim, sepse kushtet janë te neni 37.

Vasilika Hysi – Prandaj duhet të jemi shumë të kujdesshëm te verifikimi që i bëhet të gjithë dokumentacionit. Zoti Ibrahim, këto janë dokumentet që personi dorëzon, krahas jetëshkrimit.

Gent Ibrahim – Ku e patë nenin 40?

Fatmir Xhafaj – Neni 41 “kandidatët e përjashtuar”. Në qoftë se ai nuk sjell njërin prej deklaratave, ai është i përjashtuar.

Vasilika Hysi – Po në rast se një prej deklaratave është e rremë?

Fatmir Xhafaj – Verifikohet në proces. Përjashtohet më pas.

Vasilika Hysi – Pra, nuk do ta kemi si kusht që...

Fatmir Xhafaj – Në qoftë se ai sjell jetëshkrimin dhe nuk e sjell atë, nuk pranohet. Në qoftë se ai nuk firmos deklaratën e integritetit, do të thotë që ka një problem. Si do ta futësh në konkurrim? Nuk e fut fare në konkurrim. I thua: “Më sill deklaratën që të të fut në konkurrim”.

Vasilika Hysi – Veçse në nenin 41, zoti kryetar, ne themi: “Dhoma Kombëtare e Noterisë verifikon plotësimin e kushteve”. Pra, kur thua “plotësimin e kushteve”, i ka plotësuar të gjitha kushtet. Ai mund ta përjashtojë kandidatin nga konkurrimi.

Gent Ibrahim – Ajo që mund të propozoj unë këtu është të themi kushtet. Kur themi “kushtet”, nuk është fjala për këto dosje dhe të shtojmë kushtet (që është neni 37) dhe plotësinë e dosjes.

Fatmir Xhafaj – Po.

Vasilika Hysi – Dakord. A mund të kemi një riformulim, zoti Ibrahim?

Gent Ibrahim – Patjetër.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord me ndryshimet e nenit 41.

Neni 42.

Dakord.

Neni 43.

Vasilika Hysi – Është thjesht riformulim i një fjale.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord me riformulimin.

Neni 44 “Kuorumi”. Biem dakord me riformulimin.

Neni 45. Biem dakord me riformulimet.

Neni 46. Biem dakord me riformulimin.

Vasilika Hysi – Kjo është procedurë e njëjtë, për të cilën kemi folur edhe më parë.

Fatmir Xhafaj – E trajtuam edhe tek avokatia.

Neni 47. Biem dakord.

Neni 48. Biem dakord.

Neni 49. Të gjitha këto nenet e noterisë mund të bien, në qoftë se nuk do të ketë kandidatë nga noteria. Me shumë gjasa nuk do të ketë.

Vasilika Hysi – Do të bien nenet.

Fatmir Xhafaj – I gjithë kreu.

Neni 50 “Kuorumi”.

Neni 51 “Procesi i votimit”, bashke me ndryshimet e paraqitura.

Neni 52. Biem dakord me ndryshimet e paraqitura. Do të ndiqet e njëjta logjikë.

Neni 53. Dakord.

Neni 54.

Vasilika Hysi – Këshillit të Emërimeve nuk mund t’i shkojë 1 kandidat. Kushtetuta thotë 5.

Fatmir Xhafaj – E thamë që do ta përputhim.

Vasilika Hysi – Ka edhe një problem: i bie të rishkruhet komplet, sepse ne themi “çdo dhomë propozon 1”, por sa do të dalin në listë në fund, sepse te nenet e mësipërme themi do të votohet për 1, ndërkohë, në Kushtetutë themi që do të dërgohen 5? Sa do të vijnë nga Tirana në këtë pesëshe dhe sa do të vijnë nga jashtë Tiranës?

Fatmir Xhafaj – Në fund fare mund të dalin të gjithë jashtë Tiranës...

Vasilika Hysi – Jo, e kemi thënë si kusht në ligj ne, që 1 duhet të jashtë Tiranës detyrimisht, por i kanë dhënë prioritet Tiranës.

Fatmir Xhafaj – Jo, atje do ta votojnë njësoj të gjithë listën. A do të votojë në fund fare Këshilli Kombëtar?

Gent Ibrahim – Ajo është për gjyqtarët, zonja Hysi. Kërkohe për gjyqtarët. Kurse për këta njëri, i cili mund të jetë nga Vlora, nga Shkodra, nga Tirana...

Fatmir Xhafaj – Nuk bën dot dallime në urbanë dhe jourbanë, apo kryeqytetas dhe jokryeqytetas.

Vasilika Hysi – Zoti Ibrahim, te ndryshimet kushtetuese ne kemi thënë se kandidatët jogjyqtarë dhe joprokurorë, për çdo kategori kandidatësh, pesë do t'i shkojnë Kuvendit. Po Këshillit të Emërimeve sa do t'i shkojnë?

Fatmir Xhafaj – E thamë që do t'i shkojnë 5. Do t'i shkojë komplet pesëshja dhe ai thjesht do të renditë.

Vasilika Hysi – Atëherë, duhet thënë dhe ai do të renditë.

Fatmir Xhafaj – Patjetër. Është e qartë ajo. Shumë faleminderit për mirëkuptimin!

Neni 55. A jeni dakord me ndryshimet e paraqitura?

Vasilika Hysi – Sipas Kushtetutës edhe kjo.

(Diskutime pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Neni 55 “Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të lartë Gjyqësor nga trupa e pedagogëve të drejtësisë”.

Vasilika Hysi – Unë kam disa pyetje për këtë nen. Këtu thuhet se do të vijnë nga fakultetet e drejtësisë. Sipas informacionit të marrë nga Ministria e Arsimit, me kërkesën time, jo të gjitha universitetet kanë fakultete, por kanë departamente.

Fatmir Xhafaj – A kanë studentë për drejtësi?

Vasilika Hysi – Kanë studentë, por nuk është fakultet drejtësie, por emërtimi i tij është Fakulteti Ekonomik...

Fatmir Xhafaj – A mund ta lëmë të hapur, që ta shikojmë me vëmendje si është gjendja?

Vasilika Hysi – Se ka ligj të ri.

Fatmir Xhafaj – Jo, e vlerësoj shumë faktin që e keni marrë këtë informacion. Na i vini edhe neve, që të krijojmë një ide.

Vasilika Hysi – Në rregull.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Hysi!

Biem dakord me ndryshimet e nenit 55.

Neni 56.

Vasilika Hysi – Në rregull.

Fatmir Xhafaj – Pra, jeni dakord.

Neni 57 “Shpallja e thirrjes për paraqitjen...”.

Vasilika Hysi – Thjesht do të plotësojmë emërtimin... A mund të themi “ministri përgjegjës për arsimin”, se mund t’i ndryshojë emërtimi. Ne sot e kemi emërtimin “ministër i Arsimit dhe i Sportit”.

Fatmir Xhafaj – A ka një mënyrë tjetër që mund ta bëjmë që të mos e shpallë ministri i Arsimit këtë gjë?

Vasilika Hysi – Ministri përgjegjës për arsimin...

Gent Ibrahimi – Vetëm kini parasysh që këto janë zgjidhje rezervë, kur nuk funksionon për një arsye apo për një tjetër zgjidhja kryesore, në një llogari të fundit, vendi ka nevojë për...

Vasilika Hysi – Zoti Ibrahimi, në rast se do të përdorim emërtimin, duhet të japim emërtimin zyrtar që ka sot, por çdo qeveri i ka ndryshuar strukturën e saj dhe emërtimet e ministrave. Kështu që është më mirë të themi “ministri përgjegjës për arsimin”.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord me ndryshimin e nenit 57.

Neni 58.

Vasilika Hysi – Duke pasur parasysh nëse do të jenë fakultetet apo edhe universitetet që kanë departamente.

Fatmir Xhafaj – E thamë që do ta reflektojmë.

Neni 59. A jeni dakord? Dakord.

Vasilika Hysi – Te neni 59 duhet të kemi kujdes, se ka një ligj të ri për arsimin, që është ligji nr. 80 i vitit 2015, dhe ka një riformulim: mbledhja e dekanatit përbëhet nga një sërë institucionesh; unë u kam bërë komentet e mia. Këtu duhet të kemi kujdes, sepse duke qenë se verifikimin e plotësimit të kriterëve do të bëjë dekanati, këtu mund të jemi në konflikt interesi. Ju thoni se një nga kandidatët, që do të konkurrojë, nuk duhet të marrë pjesë në këtë mbledhje. Mirëpo, ne mund të heqim nga gara njerëzit më të mirë. Pra, e kemi zgjeruar

konceptin e dekanatit. Po të shikoni, sot dekanati përbëhet nga dekani, nga zëvendësdekanët, nga administratori, nga drejtuesit e departamenteve...

Fatmir Xhafaj – Dakord. Po, mirë, do të marrin pjesë të tjerët, kurse ai nuk do të marrë pjesë në mbledhje?

Vasilika Hysi – Jemi në një situatë të tillë, zoti kryetar: sikur të kandidojnë shefat e departamenteve, atëherë kush do ta marrë vendimin, se ne i përjashtojmë të gjithë?

Nga ana tjetër do të detyrohemi të ulim cilësinë e kandidatëve që do të konkurrojnë.

Gent Ibrahimi – Zonja Hysi, këta përjashtohen vetëm nga procesi i verifikimit të kushteve. Ata janë të lirë të kandidojnë.

Fatmir Xhafaj – Po, pra...

Vasilika Hysi – Po kush do ta bëjë verifikimin, kur ju thoni: “Me gjysmat e votave dekanati...”

Fatmir Xhafaj – Do ta bëjë kancelari, pra ata që mbeten.

Gent Ibrahimi – Ata që mbeten.

Vasilika Hysi – Zoti Ibrahimi, merak im është: nëse marrim një situatë të tillë: sikur të kandidojnë tre përgjegjësit e departamenteve, dekani dhe një nga zëvendësdekanët, i bie që të mbetem dy veta të marrin vendime për pesë të tjerët?!

Gent Ibrahimi – Në fakt, ky është një proces shumë formal.

Fatmir Xhafaj – Rishikim i kushteve ligjore është ai.

Gent Ibrahimi – Nuk është se ka ndonjë vendimmarrje thelbësore brenda. Megjithatë, ne mund të gjejmë një zgjidhje që t’ia lëmë zëvendësdekanit...

Fatmir Xhafaj – Jo, se janë shumë. Pastaj është administratori i njësisë, drejtuesit e njësive bazë, autoritetet e tjera për të përcaktuar statusin e institucioneve... Më vjen keq...

Biem dakord me formulimin që keni bërë, kurse kjo nuk më duket shqetësuese.

Gent Ibrahimi – Nëse ia lëmë në dorë vetëm dekanit, është pak problem. Në rregull, do të japim një zgjidhje më të arsyeshme për këtë. Ndoshta do të propozojmë një trupë me tre veta për këtë proces, dekani, zëvendësdekani dhe kancelari. Në rast se ata janë kandidatë, të zëvendësohen nga anëtarë të tjerë të dekanatit. Në fakt, është një proces shumë bazik dhe nuk ia vlen të përfshihë gjithë këta njerëz.

Vasilika Hysi – Është shumë e tepruar.

Fatmir Xhafaj – Rishikojeni këtë. Në qoftë se kjo përputhet me ligjin e ri, mirë. Në qoftë se jo, të gjejmë një zgjidhje tjetër.

Neni 60. Dakord.

Neni 61 “Mbledhja e asamblesë”.

Vasilika Hysi – Te neni 61 kam një pyetje, zoti Genti. Ju thoni “dekani i Fakultetit të Drejtësisë”. Jo të gjitha fakultetet private kanë dekan; është departamenti ai.

Fatmir Xhafaj – Do ta shikojmë nëse do t'i futin departamentet ose jo. Nëse do t'i futim departamentet, do të themi “shefi i departamentit...”

Vasilika Hysi – “Dekani” ose aty ku nuk ka fakultet...

Fatmir Xhafaj – Këshilltarët le ta mbajnë shënim që te neni 61 do të reflektojnë zgjidhjen që do të japim më lart.

Neni 62 “Kuorumi”. Dakord.

Neni 63 “Procesi i votimit”. Dakord.

Neni 64. Biem dakord me ndryshimin që kemi thënë për pikën 5.

Neni 65.

Vasilika Hysi – Është procedurë.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 66. Dakord.

Neni 67.

Vasilika Hysi – Te neni 67 unë kam një diskutim. Ju ia keni lënë përzgjedhjen e kandidaturave mbledhjes së posaçme të rektorëve dhe të dekanëve. Ne nuk kemi asnjë rektor jurist. Rektorët mund të jenë mjek, inxhinierë, informaticienë, pra nuk ka. Si do të bëhet vlerësimi i dosjeve nga rektorë, të cilët nuk janë të profesionit? Në këtë kuadër, ne themi që një kandidat do të vijë nga fakultetet publike, një nga privatet, ndërkohë që kemi vetëm një rektor të fakultetit publik dhe 17 të privatit. A mund të njihen kandidaturat, të bëhet një përzgjedhje e mirë e kandidaturave nga fakultetet publike nga rektorë dhe dekanë të fakulteteve private që nuk janë fare juristë?

Fatmir Xhafaj – Mund të mos jetë jurist ai, por...

Vasilika Hysi – Po si do ta gjykojë dosjen, punën shkencore dhe si do ta bëjë vlerësimin?

Fatmir Xhafaj – Do ta shikojë nga letrat. Ata janë personalitete. Në qoftë se ai është personalitet, do të shkojë të konkurrojë atje. Është pedagog që njihet. Edhe unë mund ta gjykoj një pedagog të Ekonomikut.

Vasilika Hysi – Pse mund të gjykoj unë për dosjen dhe për karrierën e tij në një fushë të caktuar?

Fatmir Xhafaj – Unë nuk po vlerësoj punimet shkencore. Po të vlerësoja punimet shkencore, po, por në qoftë se unë shikoj dosjen e tij...

Vasilika Hysi – Jo, këtu do të votojë ai për kandidatin më të mirë.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Edhe unë votoj. Më fal, të të bëj një pyetje, zonja Hysi: ne të gjithë në parlament jemi juristë, ekonomistë kur votojmë kandidaturat, për shembull në Këshillin Drejtues të Bankës së Shqipërisë? Ne nuk jemi ekonomistë.

Vasilika Hysi – Por jemi brenda fushës.

Fatmir Xhafaj – Brenda fushës janë edhe ata. Do t’jua japë ligji. Pse jemi brenda fushës? Ne jemi politikanë të formateve të ndryshme dhe gjykojmë për cilësitë e tyre dhe themi se ky është i vlefshëm për të shkuar në këshillin e bankës. Edhe ata do të vlerësojnë nëse X është i vlefshëm me këtë CV që ka dhe me këto dokumente që ka, sepse dokumentet do të vlerësojnë. Ata nuk do të vlerësojnë punën shkencore.

Vasilika Hysi – Po do të votojnë këta?

Fatmir Xhafaj – Si ta bëjmë? A keni një zgjidhje tjetër, që është më e leverdishme dhe në interes të procesit?

Vasilika Hysi – Personalisht, nuk mund ta konceptoj, me gjithë respektin që kam, që rektori i Inxhinierisë Elektronike të votojë për një pedagog të Fakultetit të Drejtësisë së Tiranës dhe të gjykojë dosjen nëse ai është kandidat i përshtatshëm për të qenë në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Gent Ibrahimi – Një alternativë mund të ishte që t’i hiqnim fare rektorët nga kjo trupë zgjedhore dhe të mbanim vetëm dekanët e fakulteteve. Por këtu ka një problem, është ai që thatë ju që këta shpeshherë mund të jenë vetë kandidatë; janë njerëz që kanë dhe kontrollojnë...

Fatmir Xhafaj – Mund të kenë konflikt të shprehur interesi.

Gent Ibrahimi – ...procesin brenda fakulteteve, trupa ngushtohet shumë.

Fatmir Xhafaj – A mund ta lëmë ta diskutojmë edhe këtë pikë?

Gent Ibrahimi – Në parim nuk ka problem.

Fatmir Xhafaj – Në rregull për nenin 67.

Neni 68 “Kuorumi”.

Vasilika Hysi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 69 “Procesi i votimit”.

Vasilika Hysi – Kemi thënë që do të rregullojmë fjalën “ministrisë”. Te paragrafi 10 do të kemi parasysh që të thuhet një kandidat nga universitet publike, një kandidat nga ato jopublike, pra, do të rregullojmë edhe terminologjinë në përputhje me ligjin e ri të arsimit të lartë. Sa kandidatë do të shkojnë në Këshillin e Lartë të Emërimeve?

Gent Ibrahimi – Në rast se i kthehem versionit të 14 qershorit, do të shkojë vetëm një kandidat. Këtu kemi sigurinë që ai kandidati, që do të shkojë do të jetë nga privatët?

Vasilika Hysi – Në ndryshimet kushtetuese kemi thënë që nga çdo kategori të shkojnë nga 5 kandidatë.

Gent Ibrahimi – Jam dakord, por në fund 1 do të zgjidhet.

Vasilika Hysi – Patjetër, por çfarë do të përcjellim, se neni 10 ka të bëjë me atë se sa kandidatë përcjell.

Gent Ibrahimi – 5 .

Vasilika Hysi – Atëherë, trupa që do të lihet do të votojë për një listë me 5 kandidatë, të cilët do t'i shkojnë Këshillit të Emërimeve.

(Diskutime pa mikrofon.)

Neni 71 do ta lëmë, sikurse do të vendoset. Do të ndjekim të njëjtën logjikë.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord me nenin 71, që të ndjekë logjikën e ndryshimeve.

Neni 72 “vendimmarrja nga Kuvendi”.

Vasilika Hysi – Do të riformulohet fjalia e fundit sipas neni 147, paragrafët 4 dhe 5 të Kushtetutës.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Vazhdojmë me nenin 73 “Procedurat e zgjedhjes së anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga Shkolla e Magjistraturës”. Biem dakord me ndryshimet.

Vasilika Hysi – Do të kemi edhe referimin në Kushtetutë.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 74. Dakord.

Neni 75.

Vasilika Hysi – Kemi redaktim vetëm te fjalia e tretë, kur thuhet “moshpallja e thirrjes”.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord me ndryshimin.

Neni 76. Biem dakord me ndryshimet e paraqitura në tekst.

Neni 77.

Vasilika Hysi – Te neni 77, të paragrafi 6 kemi hequr fjalët “në mënyrë të posaçme” dhe do të vendosim fjalët “njoftim me shkrim individual”.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Miratohet me ndryshimet.

Neni 78. Dakord.

Neni 79. Dakord.

Neni 80. Biem dakord me ndryshimin e paraqitur.

Neni 81 “Procesi i votimit”. Biem dakord me ndryshimin e paraqitur.

Neni 82 “Numërimi i votave dhe shpallja e rezultateve”. Biem dakord me ndryshimet e paraqitura në format, me redaktimet e bëra dhe me reflektimin e normës kushtuese.

Neni 83 “Ankimet kundër vendimeve të Këshillit Drejtues”. Dakord.

Neni 84.

Vasilika Hysi – Te neni 84 do të përmendim renditjen që do t’i bëjë Këshilli i Lartë në Drejtësi.

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me nenin 85 “Procedurën e zgjedhjes së anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që përfaqëson shoqërinë civile”.

Vasilika Hysi – Përsëri do ta lëmë sipas ndryshimeve kushtetuese.

Fatmir Xhafaj – Sigurisht, dhe biem dakord me ndryshimet e tjera që ju keni paraqitur në tekst.

Vasilika Hysi – T’ju bëj një pyetje, nëse do të qëndrojë kjo: ju keni vënë kushtin që kandidati të mos ketë ushtruar në mënyrë aktive profesionin e avokatit. A ka ndonjë mënyrë pasive të ushtrimit të profesionit të avokatit?

Gent Ibrahimi – Ja, për shembull, unë jam teorikisht avokat, sepse kam një licencë, por nuk e ushtroj.

Fatmir Xhafaj – Edhe unë jam avokat, e kam licencën, por nuk më lejohet ta ushtroj.

Vasilika Hysi – Edhe ne, por e kemi pezulluar licencën, pra nuk e kemi ushtruar.

Fatmir Xhafaj – Po, pra që nuk e ushtrojnë funksionin e avokatit.

Vasilika Hysi – Ju thoni “ushtrim në mënyrë aktive”. Nuk e ushtron dot. Po ne që e kemi pezulluar licencën? Nuk e ushtrojmë. Nuk ka ushtrim aktiv apo pasiv. Nuk e ushtron profesionin e avokatit.

Gent Ibrahimi – Dakord.

Vasilika Hysi – Kam edhe një pyetje, zoti Genti: organizatat e shoqërisë civile do të jenë të gjitha nga A-ja te ZH-ja. Kemi mbi 2800 organizata të regjistruara, sepse janë organizata aktive, joaktive, ekzistente dhe inekzistente, me adresa fiktive etj., pra organizata që nuk kanë fare lidhje me sistemin gjyqësor, apo keni parasysh organizatat e të drejtave të njeriut ose organizata që lidhen me shërbimet?

Fatmir Xhafaj – Do një përcaktim kjo.

Gent Ibrahimi – Ka dy momente: momenti i organizatave nga vijnë kandidatët, në këtë rast patjetër që duhen specifikime, shteti ligjor, të drejtat e njeriut, të cilat janë.

Fatmir Xhafaj – Dhe të kenë bërë një projekt të paktën 5 vjetët e fundit, se ai mund të thotë që e ka dhe e mban të fjetur, por ai duhet të ketë bërë një apo dy projekte me donatorët, apo diçka të tillë. Nuk e di, sepse nuk e njoh këtë pjesën e shoqërisë civile. Ju, zonja Hysi, e njihni mire, kështu që mund të na bëni një riformulim, pra të jetë veprues në mënyrë aktive.

Vasilika Hysi – Dhe të jetë efektiv.

Fatmir Xhafaj – Por duhet gjetur, se hajde ta ndajë njeri. Duhet të vendoset një kriter objektiv.

Gent Ibrahim – Të ketë produkte pune në këtë lëmë. Mund të gjejmë një formulim.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord me ndryshimet e nenit 85; do të reflektohen edhe ato që u thanë gjatë këtij konsultimi.

Neni 86.

Vasilika Hysi – Është përsëri shqyrtim i shprehjes së interesit. Nuk ka problem.

Fatmir Xhafaj – Neni 88. Dakord.

Neni 89. Dakord.

Neni 90. Biem dakord me reflektimin që thamë.

Neni 91 “Vendimmarrja nga Kuvendi”. Dakord.

Vasilika Hysi – Do t’i referohemi vetëm Kushtetutës. Do ta citojmë sipas rregullave të përcaktuara në Kushtetutë.

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me “Organizimin dhe mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Neni 92 “Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Unë kam bërë një sugjerim, zoti kryetar, për t’u unifikuar edhe me disa nene më pas. Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të raportojë të paktën një herë në vit dhe duhet të marrë masa për publikimin e raportit, por, nga ana tjetër, ne kemi parashikuar që më pas ai mund të raportojë në Kuvend edhe kur është e nevojshme, ose kur kërkohet nga Kuvendi. Kështu që unë sugjeroj të shtohet kjo gjë. Pra, mund të ndodhë që për çështje emergjente, për të cilat vetë Këshilli kërkon të dëgjohet në Kuvend ose vetë Kuvendi kërkon, mund ta thërrasë Këshillin e Lartë Gjyqësor. Pra, të mos e lëmë thjesht me mbledhjet vjetore. Kjo është një balancë më e mirë për atë që kemi merak, pra për kontrollin dhe balancimin. E kam fjalën për germën “f”, ku thuhet se çfarë kompetencash ushtron kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Fatmir Xhafaj – Edhe këtë formulimin: “Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor zgjidhet në mbledhjen e parë të këshillit nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë me shumicën thjeshtë të votave të anëtarëve. Kryetari qëndron në detyrë deri në përfundim të mandatit...” më shumicë të thjeshtë e kemi lënë në Kushtetutë?

Gent Ibrahimi – Sipas ligjit.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Vasilika Hysi – Jo, te neni 147 është ndryshe, ku thuhet te Këshilli i Lartë Gjyqësor...

Gent Ibrahimi – Shikoni paragrafin 6: “Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor zgjidhet në mbledhjen e parë të Këshillit nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë sipas ligjit”. Pra, i delegohet këtu...

Vasilika Hysi – Po, por nuk votojnë vetëm anëtarë jogjyqtarë, apo jo, zoti kryetar?

Fatmir Xhafaj – Jo, thamë të gjithë në mbledhjen e parë të Këshillit.

Vasilika Hysi – Në rregull. Pra, këtu është neni 47, paragrafi 6 i Kushtetutës.

Gent Ibrahimi – Po të doni, dikur kemi pasur një formulë edhe më të komplikuar, që më shumicë të cilësuar, por mund të ketë vështirësi në procesin e zgjedhjes, ndaj kemi menduar ta bëjmë të thjeshtë këtë moment...

Fatmir Xhafaj – Ideja ishte se mund të kishte një raund me dy të tretat,

Gent Ibrahimi – Mund të bëhet edhe ashtu.

Fatmir Xhafaj – Do të ishte më serioze të kishte një raund me dy të tretat. Në qoftë se nuk kanë të dy kandidatët, ai të bënte një raund të dytë. Do të ishte më i fortë nëse do ta merrte që raundin e parë.

Vasilika Hysi – Kryetar, kam një pyetje: ne themi që mbledhja e Këshillit të Lartë Gjyqësor është e vlefshme kur marrin pjesë gjysma, pra 6, tani po ta zgjedhësh me gjysmën e gjysmës, i bie ta zgjedhësh me 4?

Gent Ibrahimi – Këtu lind gjithmonë nevoja për të balancuar nëpërmjet nevojës për eficiencë, që të ecësh përpara, dhe nevojës për të përfshirë.

Fatmir Xhafaj – Ja pra, e lamë me dy raunde që ta përforcojmë.

Biem dakord me ndryshimet e nenit 92.

Neni 93.

Vasilika Hysi – Nuk ka riformulime. Është i saktë.

Fatmir Xhafaj – Këtu kam një gjë unë: duhet të jetë nga radhët e anëtarëve jogjyqtarë edhe zëvendëskryetari?

Gent Ibrahimi – Duke qenë se do të ushtrojë kompetencat e kryetarit, atëherë logjika është që do të ketë pasur ndonjë arsye pse kryetarin e kemi zgjedhur jogjyqtar. Duke qenë se ky, ndoshta për periudha relativisht të gjata, do të ushtrojë të njëjtat kompetenca, atëherë është e logjikshme. Nuk është fjala për dy njerëz që ndajnë pushtetin, por janë dy njerëz që ushtrojnë të njëjtin pushtet.

Fatmir Xhafaj – Biem dakord me nenin 93.

Neni 94 “Mbledhja plenare”. Pse është futur fjala “plenare”; mund ta bëni “Mbledhja e Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Gent Ibrahimi – Mund të jetë kështu.

Vasilika Hysi – Unë kam një pyetje për paragrafët 3 dhe 4. Shoh se kanë mbetur jashtë kompetencave të mbledhjes lëvizjet paralele, transferimi, delegimi, komandimi te pika 3, kurse te pika 4, kur thuhet “vendos masën disiplinore të shkarkimit të gjyqtarëve”, po pezullimin dhe uljen në detyrë kush i vendos?

Gent Ibrahimi – Komisionet përkatëse. Duhet vetëm lista e vendimeve që merren ekskluzivisht nga mbledhja plenare.

Vasilika Hysi – Shumë mirë. Ju keni lënë komisionet përkatëse, atëherë do të më lejojnë, zoti kryetar, të bëj një pyetje, meqenëse komisionet vijnë më pas. Me ligj janë ngritur disa komisione, të cilat përbehen nga tre veta, 2+1, kryetari. Kush quhet vendimmarrje, se ju thoni nga shumica, që i bie të jenë 2? A mund të merret një vendim pezullimi, transferimi, ngritjeje në detyrë vetëm me dy veta? Po kur votat e dy personave ndahen në mënyrë të tillë që nuk merr dot vendim, a mund të bësh veprime kaq të rëndësishme me një vendim të këshillit, i cili përbëhet nga tre veta, ku shumica e treshit është dyshi.

Gent Ibrahimi – Aty nuk ka mundësi për abstenim, kështu që të gjithë do të votojnë ose pro, ose kundër.

Vasilika Hysi – Po dy veta janë. Këta dy veta do të vendosin për masa të tilla? Pezullimi, transferimi, komandimi në një Këshill të lartë Gjyqësor me 11 veta, t’u lësh vendimmarrjen dy vetave, mua më duket jo shumë e përshtatshme.

Gent Ibrahimi – Në njëfarë mënyrë, kjo është e detyrueshme në momentin që shkon drejt organizimit mbi bazë komisionesh, duhet t’u japësh fuqi këtyre, përndryshe kot sa i krijove.

E dyta, duke qenë se këto vendime, dhe jam dakord me ju që janë të rëndësishme dhe që e afektojnë në thelb statusin e gjyqtarit, për sa kohë ato mund të ankimohen në mbledhjen plenare të Këshillit, besojmë së garancitë nuk cenohen. Ne këtu marrim edhe garancinë, nëpërmjet ankimit në mbledhjen plenare, por sigurojmë edhe efikasitetin

nëpërmjet vendimmarrjes në trupë të vogël. Ndoshta edhe Agnese mund të ketë diçka për të thënë për këtë pikë.

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesja)* Thjesht doja të thosha se në rastet kur merren vendime, të cilat mund të ndikojnë disi direkt te gjyqtarët, mundësia për një proces rishqyrtimi nga pala, e cila nuk është dakord me këto masa, si për shembull, pezullimi, ka shumë mundësi të ndodhë që të kemi rishqyrtim ose kërkesë për rishqyrtim. Megjithatë, për të garantuar efikasitetin, të paktën që një grup i vogël anëtarësh do të hyjnë në detajet dhe elementet e çështjes, është më e thjeshtë dhe më efikase të kemi një vendimarrje nga komisioni fillimisht. Gjithashtu, në këto raste si rregull na duhet t'i dëgjojmë kandidatët, të kemi të gjithë takimin plenar, t'i dëgjojmë çështjet, detajet e këtyre çështjeve dhe kjo gjëja nuk mund të jetë shumë proporcionale. Prandaj do të ishte më e mençur të kishim një gamë më të gjerë vendimmarrjeje me një komision, i cili edhe për rastet jostandarde, nëse do të kemi kundërshtime, ato do të dërgohen në Këshill dhe procedurat për rishikim kanë një procedurë të caktuar. Në të njëjtën kohë këto procedura për rishikim do të kalojnë në Këshill, kështu që ne kontrollojmë edhe Këshillin nëse ai po funksionin brenda masave të caktuara. Nëse përfshijmë këtu këshille të tjera, shumica e tyre kanë vendimet, duke përfshirë vendimmarrjet për masat disiplinore nëpër komitete, për të garantuar efikasitetin e procesit të vendimmarrjes.

Vasilika Hysi – Unë shqetësohem, sepse janë disa vendime shumë të rëndësishme që lidhen me gjyqtarët dhe me prokurorët. Ne krijojmë komisione, të cilave u kemi dhënë vendimarrje.

Fatmir Xhafaj – Aq janë gjithsej Sa komisione janë?

Vasilika Hysi – Janë krijuar pesë komisione dhe çdo komision do të ketë kryetarin dhe dy anëtarët. Vendimarrja merret nga dy vota. Po si do të ndahen dy vota? Madje, edhe vlerësimin e veprimtarisë së gjyqtarit ne ia lëmë Komisionit të Vlerësimit Gjyqësor dhe Etikës, që përsëri janë dy vota që e bëjnë këtë vlerësim, pra nuk është një këshill i tërë...

Fatmir Xhafaj – Janë tre vota.

Vasilika Hysi – Kur votohet, janë tre.

Fatmir Xhafaj – Tani, Gjykata Kushtetuese... Gjykata e Lartë gjykon në treshe. Në gjykojmë fatet e njerëzve me tre gjyqtarë, nuk gjykuakemi dot...

Vasilika Hysi – Në rast se ju gjykoni që puna të bëhet në komision...

Fatmir Xhafaj – Më fal, në Apel a gjykojnë treshet? Në Gjykatën e Lartë a gjykojnë treshet? Që të futet çështja në Gjykatën Kushtetuese, a kalon në dhomën me tre gjyqtarë. U kemi lënë vendimarrje të rëndësishme kushtetuese edhe jo më... Pastaj ai do të

ketë të drejtën e ankimit, të rishikimit; mund të ankohet në mbledhjen e përgjithshme të Këshillit. Po të jetë e nevojshme, mund të vëmë klauzola, pra, kur nuk bie dakord, vendos Këshilli në seancën plenare me 11 anëtarët. Mund të ketë dalje të tilla. Nuk e di. Sugjerojeni që nëse ka ngërçe, pra që mund të mos jenë bindëse, sidomos për masat disiplinore, kalon në mbledhjen e përgjithshme të Këshillit.

Gent Ibrahim – Në rastin e masave disiplinore është edhe garancia që edhe hetimi i shkeljes është bërë në kushtet e një procesi të rregullt ligjor me garanci procedurale, kështu që kur vjen puna te marrja e vendimit janë kaluar disa etapa.

Fatmir Xhafaj – A jeni dakord, zonja Hysi?

Vasilika Hysi – Në rregull.

Fatmir Xhafaj – Miratohet neni 94 me ndryshime.

Neni 95 “Komisionet e përhershme”.

Vasilika Hysi – Nuk kam ndonjë problem. Pyetjet që kisha i parashtrova pak më parë.

Fatmir Xhafaj – A mund të bëjmë, për shembull, që Komisionin Disiplinor dhe Komisioni i Vlerësimit mund të jetë edhe me pesë, pra të jetë një ndryshim, meqenëse janë dy komisione të rëndësishme? Nuk e di si mendon zonja Agnese.

Gent Ibrahim – Këto 5 komisione janë të gjitha shumë të rëndësishme. Por duke pasur parasysh përbërjen me 11 anëtarë të Këshillit... Megjithatë, mund ta marrim në konsideratë edhe këtë ide, që të paktën kur të diskutohet...

Fatmir Xhafaj – Disiplina dhe vlerësimi janë ndryshe nga zhvillimi i karrierës, nga strategjia, nga administrimi i buxhetit...

Gent Ibrahim – Duhet bërë ajo llogaria matematikore, se ndonjëherë thjesht mund të mos ketë njerëz të mjaftueshëm për të shërbyer.

Vasilika Hysi – 11 janë gjithsej.

Fatmir Xhafaj - Po, mirë mund të jenë në dy komisione.

Vasilika Hysi - A mund të themi që një anëtar mund të jetë jo më shumë se në dy komisione.

Fatmir Xhafaj – Po, le të mbetet kjo.

Gent Ibrahim - Në rast se kemi thënë këtë, i bie që një anëtar, për shembull të jetë në komisionin e planifikimit dhe në komisionin disiplinor.

Vasilika Hysi – Zoti Ibrahim duhet të shmangim konfliktin, ai është dhe te disiplina edhe te vlerësimi, nuk duhet të jenë të njëjtët anëtarë.

Gent Ibrahim – Vetëm midis vlerësimit dhe karrierës shikojmë një konflikt. Është rregulluar, aty thuhet, se kush është te vlerësimi nuk mund të jetë te karriera.

Vasilika Hysi – Normal, se është konflikt interesi, më pas.

Gent Ibrahim - Mund ta shikojmë këtë zgjidhje që thoni ju nëse është e mundur matematikisht, pra që të kemi aq anëtarë sa që mund të shërbejnë në tre. Do një llogari matematikore, por ne mund ta shikojmë këtë mundësi që këto dy komisione të jenë me pesë anëtarë në vend të tre.

Fatmir Xhafaj - Dakord me nenin 95 me këto ndryshime.

Neni 96.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Nuk ka gjë.

Zoti kryetar, nëse më lejon te neni 95, kam një pyetje: te pika 16 thuhet: “Komisioni vendos me shumicën e votave në prani të të gjithë anëtarëve”. Ju thoni se nuk lejohet abstenimi. Janë tre anëtarë. Detyrimisht do të vendoset me dy? Dakord. Doja ta saktësoja.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 96 me ndryshimet.

Neni 97 “Ekspertët”.

Vasilika Hysi - Kam një pyetje lidhur me këtë nen dhe ndryshimet kushtetuese. Ne kemi thënë që gjyqtarit nuk i lejohet të ushtrojë asnjë funksion tjetër përveç mësimit, aktivitetit akademik dhe shkencor, ndërkohë që këtu thuhet: “Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të angazhojë kundrejt shpërblimit si ekspertë edhe gjyqtarët”. A bie ndesh kjo me formulimin që kemi bërë në Kushtetutë?

Gent Ibrahim - Po, bie.

Fatmir Xhafaj - Atëherë duhet të ndryshohet.

Dakord me ndryshimin që do të respektohen.

Neni 98 “E drejta për t’u kërkuar informacion”.

Vasilika Hysi - Ky është në rregull.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 99 “Mbledhja e Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Vasilika Hysi - Këto janë thjesht riformulime.

Zoti Ibrahim, por edhe zonja Agnes do të doja që në pikën 8 duhet ta përcaktojmë se çfarë lloj vendimi duhet të marrë Këshilli. Forma mund të jenë elementet, por duhet të jetë një vendim, jo në atë formë që thuhet këtu, për të cilën është rënë dakord. Po sikur ata të thonë do të marrim vendim me gojë, me deklaram? Çdo gjë duhet të jetë me shkrim.

Fatmir Xhafaj – Besoj se ata kanë pasur idenë e përmbajtjes.

Gent Ibrahimi - Bëhet fjalë për përmbajtjen. Ju keni të drejtë.

Fatmir Xhafaj - Është shprehur gabim.

Vasilika Hysi - Duhet ta saktësojmë.

Fatmir Xhafaj – Dakord me këto ndryshime.

Neni 100 “Rendi i ditës”.

Vasilika Hysi - Sugjeroj që duhet të riformulohet kur thuhet: “Rendi i shpërndarë duhet të diskutohet, si edhe t’i jepet zgjidhje në mbledhje”.

Gent Ibrahimi - Dakord nuk është formulim shumë adekuat. Shpresoj që me idenë nuk keni ndonjë problem, që edhe aty për aty në mbledhje nëse gjashtë anëtarë janë dakord, mund të...

Fatmir Xhafaj – Është dhe sot.

Vasilika Hysi – Është dhe sot dhe është normale. Në lidhje me parimin, nuk jam kundër, por duhet të qartësohet.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Neni 101 “Kuorumi dhe vendimmarrja në Këshill”.

Vasilika Hysi - Te ky nen Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Unë shoh një kontradiktë në paragrafin e parë dhe të dytë. Ju thoni që një mbledhje të jetë e vlefshme duhet të jenë shtatë anëtarë, që votimi të jetë i vlefshëm duhet të votojë gjysma e shtatës, katër. Ju mendoni se për vendime kaq të rëndësishme këshilli mund të vendosë me katër vota?

Gent Ibrahimi - Po, në fakt nuk shikoj ndonjë arsye se pse duhet të ketë kaq pak njerëz në mbledhjet e këshillit, ata shërbejnë me kohë të plotë. Rastet se kur duhet të dalin nga vendimmarrja janë të përcaktuara qartësisht në këtë ligj, pra unë e imagjinoj që rrallë do të vijë puna deri te një kuorum me shtatë, pjesëmarrja është e detyrueshme.

Vasilika Hysi - E di pse ju pyeta? Ne kemi futur tre kushte: nuk lejohet abstenimi, pjesëmarrja e detyrueshme dhe votimi i detyrueshëm. Nga ana tjetër e zëmë se kanë arsye shëndetësore, por në vendime kaq të rëndësishme te qeverisja e gjyqësorit nga 11 vetë të quash një mbledhje të vlefshme me shtatë dhe të thuash se po votuan katër përsëri vendimi është i vlefshëm, i bie që të gjitha parimet që kemi përcaktuar të jenë thjesht në letër, teori.

Fatmir Xhafaj - Më fal!

Po Kuvendi çfarë bën? Janë 71, votojnë 36 dhe është kuorumi. Shtata është më shumë se sa gjysma, Kuvendi vetë, komisionet hapen me një më shumë se gjysma.

Vendimet i marrim me një më shumë se gjysma, me 26% të numrit të përgjithshëm. Është kështu?

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesja)* Mendojmë se duhet të kemi parasysh edhe rastet që këshilli mund të ketë vendosur tashmë në apelime për vendimet për t'i ankimuar hetimet ose për t'i mbyllur ato. Në raste të tilla të tre anëtarët që vendosën për këto vendime për t'i arkivuar ose mbyllur çështjet nuk do të jenë pjesë e mbledhjes plenare. Kur të vijë momenti i vendimmarrjes, pra janë vetëm tetë anëtarë që kanë mbetur në këtë rast, sepse tre nuk do të marrin pjesë më, këta të tetë do të marrin vendimin. Duhet të jemi fleksibël për të garantuar vendimmarrjen e këshillit, sepse mund të ketë edhe për çështje të konfliktit të interesit, jo të gjithë mund të marrin pjesë.

Vasilika Hysi - Dakord, zonja Bernhard. Unë kam edhe një pyetje tjetër lidhur me paragrafin e katërt. Ju thoni që anëtari i këshillit të pranishëm në mbledhje nuk mund të heqë dorë nga votimi me përjashtim të rasteve dhe përmendni tre raste. E para, konfliktin e interesit që është e qartë ose pengesat e tjera të zbatimit të ligjit ose konfliktit të interesave përsëri, ose të Kodit të Procedurave Administrative: a mund të qartësojmë se cilat janë rastet kur anëtari i këshillit nuk mund të votojë?

Gent Ibrahim - Pak më poshtë ka një seksion që rregullon pikërisht rastet kur anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk mund të votojë. Këto duhet të ishin rastet e konfliktit të interesave dhe të pengesave ligjore sipas këtij ligji. Përveç këtij ligji konflikti i interesave rregullohet edhe në dy ligje të tjera. Se çfarë do të ishte pengesë ligjore dhe konflikt në kuptimin e këtij ligji është pak më poshtë, e rregulluar në mënyrë shteruese, por ndërkohë ne lëmë të hapur mundësinë që ligjet e tjera, të cilat mund të kenë rregullime lehtësisht ose shumë të ndryshme, të gjejnë rrugën për t'u zbatuar.

Vasilika Hysi - A mund të bëj një riformulim më të plotë, sepse është përmendur dy herë ligji “Për konfliktin e interesave”?

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Vasilika Hysi - Po Kodi i Procedurave Administrative çfarë pengesash mund të ketë?

Gent Ibrahim - Edhe ai ka dispozita për konfliktin e interesave.

Vasilika Hysi - Ai i referohet ligjit “Për konfliktin e interesave”.

Gent Ibrahim - Ju keni të drejtë, duhet të verifikohet me kodin e ri që ka hyrë në fuqi tani. Kodi i vjetër ka pasur dispozita për konfliktin e interesave, siç ka edhe ligje për konfliktin e interesave. Në rast se është kështu, për të qenë brenda duhet t'u referohemi që të gjithave. Në rast se kodi i ri nuk ka dispozita për konfliktin e interesave, ose në mënyrë

më të përgjithshme mund të themi edhe legjislacionin për konfliktin e interesave kudo që të jenë dispozitat, pastaj ato gjejnë rrugën të zbatohen edhe mbi anëtarët. Nëse jeni dakord me këtë që të themi: pengesat ligjore dhe konfliktet sipas këtij ligji që janë të rregulluara më poshtë dhe legjislacionit tjetër për konfliktin e interesave?

Vasilika Hysi - Dakord me këtë reformulim për sa i përket ligjit “Për konfliktin e interesave”. Meraku im është për Kodin e Procedurave Administrative.

Gent Ibrahimi - Do ta heqim atë. Flasim në përgjithësi për legjislacionin që rregullon çështjet e konfliktit të interesave. Në rast se Kodi ka dispozita për konfliktin, do të aplikohen, në rast se nuk ka nuk do të aplikohen. Pra, të flasim në mënyrë më të përgjithshme, të flasim për pengesat ligjore dhe konfliktet e interesit sipas këtij ligji që janë më poshtë dhe për rastet e tjera të parashikuara nga legjislacioni për konfliktin e interesave.

Fatmir Xhafaj - E rëndësishme është se e ka edhe sot Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Ai është i detyruar të votojë. Kjo është e sigurt, edhe rregullimi i ri e ruan të njëjtën gjë. Jemi dakord me shprehjen e “përcaktimit të konfliktit të interesave”.

Gent Ibrahimi – “Edhe në raste të tjera të parashikuara nga legjislacioni për konfliktin e interesave”.

Fatmir Xhafaj - Po, dakord.

Neni 102.

Vasilika Hysi - Kam një pyetje për zotin Ibrahimi, në draftin e parë të projektligjit, kur kemi diskutuar kishit futur si një detyrim edhe transkriptimet, fjalë për fjalë që të botohen. Shikoj që tani është hequr. Ju thoni që mbahen të regjistruara, dokumentohet regjistrimi audio, kushdo që do të dëgjojë se si ka shkuar mbledhja e këshillit nuk e lexon, por e dëgjon, mund të vendosë kufjet në *youtube* dhe të dëgjojë.

E dyta, keni thënë se regjistrimi i audios bëhet publik dhe një përmbledhëse e mbledhjes. Cila është arsyeja që keni hequr botimin në faqen zyrtare të këtij këshilli të diskutimeve fjalë për fjalë?

Gent Ibrahimi - Është praktike, për sa kohë që nevojat e atyre që duan të dinë se çfarë është thënë dhe çfarë është bërë, kënaqen përmes hyrjes në faqen zyrtare të këshillit dhe të dëgjimit të asaj që është thënë, thjesht kursejmë punë për zbardhjen. Pra, nuk është më në formë të shkruar, por është në formë audio dhe çdokush mund ta dëgjojë. Për efekt të dokumentimit ka edhe një përmbledhje, ka një procesverbal me përmbledhjen e diskutimeve. Duket pak sa e vjetruar metoda e zbardhjes së plotë në formë shkresore, mund ta themi edhe aty, në rast se ju e gjykoni.

Vasilika Hysi – Kam një pyetje: nëse lind një problem dhe duhet të shkosh në gjykatë, gjykatës do t'i çosh audion dhe të dëgjojë audion apo do t'i çosh dokumentet?

Gent Ibrahim - Pse jo?

Vasilika Hysi – Kam edhe një pyetje: dua ta lë për rekorde, për ta sqaruar në të ardhmen.

Gent Ibrahim – Nuk besoj se do të ishte pengesë për gjykatën, nëse do të administronte edhe një dokument audio. Gjykata është e supozuar të marrë vendimet duke dëgjuar diskutimet në seancë. Jam i bindur që nuk është problem administrimi i një dokumenti audio. Kjo është thjesht një përpjekje për të qenë pak më praktikë, pa kompromentuar thelbin.

Agnes Bernhard -(*përkthen përkthyesja*) Megjithatë sa herë që të jetë e nevojshme, kushdo mund të kërkojë transkriptim, kjo është e parashikuar apo jo?

Gent Ibrahim - Zbardhja e plotë i vihet në dispozicion kundrejt pagesës nga ana e atij që bën këtë kërkesë. A do ta zgjidhë kjo gjë problemin, pra që kur kërkohet le të zbardhet e plotë?

Vasilika Hysi - Po në këtë nen, në pikën 5 thuhet që procesverbalet me përmbledhjen e diskutimeve u vihen në dijeni anëtarëve, por jo procesverbali siç e kemi në Kuvend, i transkriptuar fjalë për fjalë dhe përmbledhjen e bën dikush tjetër. Unë po të jem anëtare me të drejtë do të them: pse më transformon fjalën? Varet se si është thënë fjala nga anëtari i këshillit, aty diskutohen çështje që janë të rëndësishme dhe dikush tjetër bën përmbledhjen. Kush do ta bëjë përmbledhjen? Përmbledhjen e bën stafi apo jo? A ka të drejtë stafi të më heqë apo të më shtojë fjalë?

Fatmir Xhafaj- Zbardhja e procesverbaleve është në thelb çështje ekonomie?

Gent Ibrahim - Po, në thelb është çështje ekonomie. Ka dy zgjidhje: ose të vihet siç ka qenë, procesverbali i plotë në çdo rast, ose të vëmë këtë që tha Agnesi tani, një pikë tjetër, që sa herë kërkohet i zbardhur i plotë, të vihet në dispozicion. Mund të kërkohet nga anëtarët, nga qytetarët, nga gjyqtarët. Besoj se çdo zgjidhje është e ligjshme.

Vasilika Hysi - Unë jam dakord që në faqen e internetit të ketë një përmbledhje edhe për ekonomi të ketë një audio, megjithëse nuk shkon njeri të vërë kufjet dhe të dëgjojë në internet mbledhjen, me tepër preferojnë ta lexojnë. Mund të ndodhemi në një konflikt gjyqësor, çështja mund të shkojë në Gjykatën Administrative.

Fatmir Xhafaj - Dakord. Të mos merremi me këtë. E tha një si zgjidhje, do ta zbardhin, do ta firmosë kryetari, përputhet kjo me audion.

Gent Ibrahim - Me një kërkesë.

Fatmir Xhafaj - Po, pastaj do ta çojë në gjykatë. Ose një gazetar kërkon një procesverbal të zbardhur, paguan dhe e merr atë kundrejt tarifës që ka për efekt transparence, ose e dëgjon me audio dhe e mbyll historinë.

Dakord me nenin 102, me këto ndryshime.

Neni 103 “Zbatimi me analogji...”

Vasilika Hysi - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 104 “Pjesëmarrja e ministrit të Drejtësisë”.

Vasilika Hysi – Është si te drafti i paraqitur gjatë diskutimit të nismës, vetëm është shtuar fjala “pjesëmarrje”.

Fatmir Xhafaj – Dakord. “Pjesëmarrja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

Vasilika Hysi - Titulli nuk përkon me përmbajtjen. Lart thuhet “Pjesëmarrja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, ndërsa poshtë thuhet: “Këshilli i Lartë i Drejtësisë mund të dërgojë vëzhgues në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Fatmir Xhafaj - Është lapsus.

Pse duhet të bëhet kjo gjë? Në kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet dy këshillave?

Gent Ibrahimi – Po, është një përpjekje për të garantuar një lloj bashkëpunimi të përhershëm, edhe të marrin eksperiencë nga njëri-tjetri se me gjasë ne imagjinojmë që Këshilli i Lartë Gjyqësor do të ecë shumë përpara me rregullimin e procedurave të brendshme, me formatimin e punës, me krijimin e standardeve. Këshilli i Lartë i Prokurorisë duhet ta ndjekë. Besojmë se kjo është një mënyrë e mirë se si mund të arrihet në këtë konvergencë.

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesja)* Duhet të marrim në konsideratë që të dy këshillat do të aplikojnë të njëjtin ligj të shtetit, duhet të sigurojmë që adoptojnë të njëjtat standardet për prokurorët dhe gjyqtarët duke aplikuar dhe duke interpretuar të njëjtat rregulla.

Petrit Vasili - Ju kërkoj ndjesë për rikthimin, por nuk do t’ju marr kohë. Te neni 104 mendoj se përcaktimi që në pikën e parë që ministri i Drejtësisë ka një komunikim me Këshillin e Lartë Gjyqësor, të targetuar dhe të kufizuar, pra lidhet me çështjet e buxhetit dhe me planifikimin strategjik, besoj që bën një reduktim, një përfaqësim të parëndësishëm të tij. Mendoj që në këtë pikë ose duhet t’i futemi diskutimit siç duhet në themel, pa paragjykim, ose do të detyrohemi të kalojmë në një qëndrim fare të thjeshtëzuar pasi ministri i Drejtësisë merr pjesë, sepse diskutohet buxheti, kjo është një gjë pa ndonjë vlerë, pushteti i lartë gjyqësor mund të propozojë një buxhet, ia dërgon ministrit të Drejtësisë, ky i fundit ka detyrimin ta përcjellë në qeveri, e përcjell në qeveri, atje miratohet apo jo, në ato parametra

më shumë apo më pak e vendos qeveria dhe reduktimi i tij në një pozicion të tillë, është fare pa vend dhe qesharak. Nëse është kështu për planifikimin e buxhetit, mund ta heqim. Mund të vëmë këtu që ministri i Financave merr pjesë në pikat e buxhetit meqenëse është ai që e paraqit edhe në parlament buxhetin e shtetit në mënyrë integrale dhe ecim përpara. Ose duhet të kemi një përfaqësim thelbësor, në kuptimin më të mirë të fjalës dhe të qenësishëm, ose ne të gjithë biem dakord që vëmë të tilla përkufizime simpliste nisur nga disa paragjykime, viktima të cilave kemi mbetur të gjithë edhe në shumë zgjedhje të tjera që i kemi dhënë këtij procesi, që mund të ishim edhe më të shëndetshme, i japim vetëm se nisemi nga një paragjykim i caktuar, besoj se nuk na çon asgjëkund. Unë e shikoj shumë të dobishëm të qenit aktiv të këtij përfaqësuesi të ekzekutivit, përfaqësuesin e ekzekutivit e kam në mendje pa emër të përveçëm, kam ndër mend të gjithë ata që kanë shërbyer dhe të gjithë ata që do të shërbejnë dhe kur të mos jemi ne, por të ketë një ministër Drejtësie, i cili vërtet bie në mënyrë sistematike, por jo në mënyrë të targetuar, pra si një OJQ që ftohet një herë dhe nuk mund të ftohet dhjetë herë të tjera, që është tërësisht jashtë dinamikës së Këshillit të Lartë Gjyqësor, sepse ky është pjesë e ekzekutivit dhe ky ekzekutiv qenka ngarkuar me negativitete dhe nuk mund të jetë pranë dhe interaktiv me një Këshill të Lartë Gjyqësor, i cili është një organizëm steril brenda një republike, e cila ka momentet e saj që përmirësohet, ka edhe momentet e saj problematike. Unë them se në këtë pikë, më së fundi duhet të tregohemi mendje hapur për sot dhe për nesër. Nuk është fjala për sot, ne po bëjmë një reformë për nesër, nuk po bëjmë një reformë për sot, një gjë që rron në kohë. Mbajtja e këtij pozicioni në këto parametra e bën këtë një nen në këtë ligj që po jua them sinqerisht që edhe sikur të mos ishte fare ky nen, kështu siç është formuluar nuk do të ndodhte asgjë, i formuluar ndryshe mund të kishte një vlerë. Do të sillte ndjeshmëritë e mëdha të publikut, të cilat tërhiqen nëpërmjet qeverisjes, e cila është në vijë të parë, në komunikim të drejtpërdrejtë me publikun, nuk është Këshilli i Lartë Gjyqësor në komunikim të drejtpërdrejtë me publikun. Do të sillte jo vetëm perceptimet, ndjeshmëritë, problematikat, jo vetëm çfarë mendon qeveria, Kryeministri, përgjegjësia e madhe që merr një shumicë, njëra apo tjetra, cilado qofshin ato, sepse në pluralizëm alternohen, por një opozicion të tillë të reduktuar dhe ne të jemi të qetë, unë për vete nuk jam i qetë. E them këtë sinqerisht, nuk është një gjë që e them sot, kemi pasur mundësi ta diskutojmë disa herë. Kemi pasur një sintoni për disa gjëra që duhen rikonceptuar dhe zoti Xhafaj ka ndarë të njëjtën ndjeshmëri. Unë besoj se duhet të mendohemi një herë për këtë nen në këtë ligj, ose i qasemi në mënyrë dinjitoze, ose edhe nëse e heqim nuk na ndodh asgjë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor do ta paraqesë atë në Ministrinë e Drejtësisë, sepse nuk e paraqet dot drejtpërsëdrejti në parlament, rruga nga kalon një propozim buxhetor dihet që është ministria përkatëse, pa shkuar fare në mbledhje, ai mund të paraqitet. Po të kërkojnë 100 lekë dhe qeveria të ketë 80, do t'i japë 80. Në pastë 110 do t'i japë 110. Pra, nuk ndryshon gjë, por në rast se e bëjmë, ky nuk është njeriu që vjen me një thes me lekë atje dhe u thotë atyre: do ta përcjell, nuk do ta përcjell. Ky lloj simplizmi në trajtimin e këtij pozicioni nuk më duket normal, pasi dinamika, e cila do të përcjellë implementimin e reformës më pas, do të jetë kaq e larmishme, kaq intensive edhe në të gjitha aspektet e këtij implementimi, ku do të duhet të ishte një prezencë tjetër me një tjetër interaktivitet. Ky është një qëndrim i një ministri pasiv, është i barabartë me shumë të tjerë që ka përgjegjësi shumë më të limituara në sistem dhe në shtetin shqiptar. Nuk mendoj që për hir të paragjykimeve, disa që kanë përgjegjësi të kufizuara kanë autoritet të plotë, disa që kanë përgjegjësi të mëdha publike, iu reduktohet autoriteti se ne kemi në mend disa gjëra, disa negativitete.

Unë ju bëj thirrje kolegëve më shumë, jo ekspertëve, pasi këta të fundit nuk e kanë këtë detyrim që të kenë një qasje politike apo vizionare, sepse kanë detyrë tjetër, ta mendojmë edhe një herë këtë gjë. Në rast se ishin pozicionet e reduktuara, unë singërisht do të propozoja që ky nen edhe mund të hiqej fare.

Fatmir Xhafaj – Personalisht nuk jam kundër këtij debati, është një debat që e kam bërë më herët, e kam bërë gjatë gjithë kësaj kohe, sepse mendoj se është një qasje tjetër, jo ashtu siç ishte. Sigurisht, që po, jam dakord, por një qasje krejt e ndryshme nga kjo që kemi, duhet të ishte në raportin midis ministrit si përfaqësues i një pushteti siç është ekzekutivi, po njëkohësisht edhe me një lidhje të drejtpërdrejt me pushtetin legjislativ, sepse buron prej këtij pushteti dhe pushtetin tjetër që është ai gjyqësor, i përfaqësuar me dy këshilla qeverisëse: Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Nga ana tjetër kam një qasje tjetër që ekspertët kanë bërë, atë që i ofroi diskutimi në këtë komision dhe atë që ka ofruar Komisioni i Venecias. Duhet të jemi të qartë që për këtë çështje kemi bërë një debat të madh, parimor. Kolegët e opozitës kanë qenë kategorikisht kundër, kanë çuar faqe të tëra në Komisionin e Venecias kundër këtij komisioni, e kanë paragjykuar. Jam shumë dakord me ju, e kanë parë si një zgjidhje të momentit, një raport të momentit dhe jo afatgjatë. Komisioni i Venecias mbi atë bazë ka dhënë disa rekomandime që nuk kthehen mbrapsht, por unë besoj, do të dëshiroja dhe kjo është ftesa ose më saktë sugjerimi im për ekspertë, që brenda kësaj hapësire, e cila ka norma kushtetuese që reflekton opinionin final të Komisionit të Venecias, çfarë mund të bëhet pa e cenuar normën

kushtetuese, sepse nuk jemi në atë diskutimin që kjo të riformulohet për t'i dhënë më shumë hapësirë ministrit të Drejtësisë në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Do t'ju lutesha ta riformuloni këtë, duke ruajtur atë kornizë. Për sa kohë që nuk është detyra juaj, as jona, as ne nuk mund ta hapim atë debat, sa kohë që nuk kemi në diskutim normën kushtetuese dhe nuk kemi edhe kolegët tanë të opozitës, me të cilët e kemi ndarë këtë gjë. Unë besoj se ka hapësirë për të riformuluar krejt ndryshe këtë gjë. Do t'ju kërkoj të ribënit një riformulim tjetër me zonjën Hysi.

Unë ju kërkoj ndjesë, por i përkas bindjes, të cilën e kam thënë që në nisje të këtij procesi, që ministri nuk duhet të ketë një rol determinant, përcaktues, por duhet të ketë një rol aktiv në Këshillin e Lartë Gjyqësor për të siguruar, për të ndihmuar balancën ndërmjet dy pushteteve dhe kontrollin reciprok, njëkohësisht që t'i japë atij të drejtën të jetë një avokat shumë i mirë i interesave të pushtetit të gjyqësorit dhe i prokurorisë në ekzekutiv. Nëse ai nuk do të përfaqësojë aty, do të jetë një zëdhënës i fortë i këndvështrimeve që ka ekzekutivi, të problematikës, vizioneve, programeve që ka në një moment të caktuar qeveria në mënyrë të veçantë te prokuroria, ai nuk mund të jetë nga ana tjetër edhe një zëdhënës i fortë i interesave të këtij pushteti te pushteti ekzekutiv dhe në legjislativ, sepse të mos harrojmë që ministri ka dhe një ndikim për shkak se është anëtar i një maxhorance, produkt i një votimi nga një maxhorancë e caktuar, është një përfaqësues i fortë i asaj maxhorance për problemet e drejtësisë.

Pra, do t'ju lutesha ta rishikoni këtë gjë. Besoj se zoti Rajner, zonja Agnes, zoti Ibrahim do të kenë mundësi të bëjnë një reflektim mbi këtë gjë dhe te Këshilli i Lartë i Prokurorisë në mënyrë të veçantë. Aty jam pak më shumë këmbëngulës, që të jem i sinqertë, sepse lidhja është shumë më e drejtpërdrejtë ndërmjet ekzekutivit dhe prokurorisë për arsye që i bashkon i njëjti qëllim si pjesë, si gjymtyrë të shtetit: lufta kundër krimit. Kanë objektiva të përbashkëta.

Ramë dakord të gjejmë një riformulim brenda kornizës kushtetuese dhe Komisionit të Venecias.

Vazhdojmë.

Neni 105 “Këshilli i Lartë i Drejtësisë”. Duhet të hiqet kjo. Besoj është “Këshilli i Lartë i Prokurorisë”. Kjo: “mund të dërgojë vëzhgues” nuk shkon. “Mund të ftohet të marrë pjesë në mbledhje me kërkesë të tij ose me kërkesë...”

Neni 105 duhet të jetë bashkëpunimi institucional midis dy këshillave. Këtu duhet të futen edhe mbledhjet e përbashkëta, pjesëmarrja në diskutime që kanë tematika të njëjta.

Pra, duhet të riformulohet ky nen. Ndoshta nuk e ka vendin këtu, mund ta ketë vendin pasi të ketë mbaruar shqyrtimi i dy këshillave.

Vazhdojmë. Neni 106 “Detyrimi për...

Vasilika Hysi - Në fakt, zoti kryetar, ky është një seksion i ri i shtuar, pas diskutimeve që kemi bërë kur u paraqit edhe projektligji në mbledhjen e mëparshme. Ka një sërë nenesh që lidhen me konfliktin e interesave. Në parim, jam dakord që ka një rregullim të detajuar të papajtueshmërisë për shkak të pjesëmarrjes në procedim, të detyrimit për të deklaruar konfliktin, të papajtueshmërisë për shkak të lidhjes familjare, gjinore, krushqisë, të heqjes dorë, të përjashtimit të anëtarit. Për të gjithë këtë seksion nuk kam shqetësime. Të vetmen gjë që kam, lidhur me nenin 106 është ndonjë redaktimi, as për nenin 107.

Te neni 108 keni parashikuar në paragrafin e parë, ku thuhet: “Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk mund të marrë pjesë në shqyrtimin e procedimit disiplinor kundër një gjyqtari në marrjen e vendimit për ngritjen në detyrë”, po kur bëhet fjalë për shqyrtimin e ankesave, kërkesave për lëvizje, për transferim, për akomodim, a mund të marrë pjesë?

Unë jam shumë dakord me sqarimin që bëtë pak më parë që mbledhja e përgjithshme, mbledhja plenare merret me shkarkimin, ndërsa komisioneve iu keni lënë masat e tjera. Po kur vjen në parim shqyrtimi, a mund të marrë pjesë gjyqtari për të cilin diskutohet masa disiplinore? Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor?

Gent Ibrahim - Ai anëtar, i cili ka marrë pjesë në mbledhjen e komisionit, që ka vendosur transferimin dhe komandimin? A mund të marrë pjesë në mbledhjen e këshillit, kjo ishte pyetja juaj apo thjesht një anëtar, i cili ka lidhje familjare apo krushqie...

Vasilika Hysi - Këtu ka dy probleme. Çështja e parë në rast se ai është anëtar i një komisioni, ka marrë vendim që x gjyqtar propozohet të shkarkohet dhe sipas sqarimeve që bëri zonja Agnes, tha që një anëtar, i cili ka gjykuar në komision, nuk mund të marrë pjesë në mbledhjen e përgjithshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Dakord, nëse e kam kuptuar saktë.

Çështja e dytë, këtu nuk flitet për këtë rast. Në këtë nen flitet kur ka lidhje krushqie, gjinie ose lidhje familjare. Pra, nëse një gjyqtar i bie të vlerësojë nipin, mbesën ose një pjesëtar tjetër të kësaj kategorie, ju thoni që ky person, ky anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk mund të marrë pjesë në vendimet vetëm për ngritjen në detyrë. Po për vendimet e tjera, për shembull: transferim, komandim, emërim të përkohshëm, pezullim mund të marrë pjesë?

Gent Ibrahim – Çështjet disiplinore janë trajtuar të gjitha në grup. Çdo procedim disiplinor pavarësisht se me çfarë objekti është, nuk mund të marrë pjesë. Problemi për

mendimin tim qëndron vetëm tek togfjalëshi “për ngritjen në detyrë”, sepse aty ka më shumë se sa kaq, kemi të bëjmë me zhvillimin e karrierës. Në rast se e zëvendësojmë atë “për ngritjen në detyrë” me një togfjalësh të përgjithshëm, të themi: “në vendimet për karrierën”.

Vasilika Hysi - “Emërim, transferim, komandim”.

Gent Ibrahimi - Po të themi karrierën, i kemi përfshirë të gjitha.

Vasilika Hysi - Ky është sugjerimi im, ky ishte merakun im, për të mos përjashtuar rastet e tjera. Pezullimi nuk është masë disiplinore e lehtë, apo ulja e pagës dhe masat e tjera.

Gent Ibrahimi – Me togfjalëshin “procedimi disiplinor” i përfshin të gjitha rastet: të shkarkimit, të pezullimit, të transferimit, si masë disiplinore e kështu me radhë, kurse me togfjalëshin “për ngritjen në detyrë” nuk mbulon të gjitha format që merr zhvillimi i karrierës. Mund ta zëvendësojmë.

Fatmir Xhafaj – Dakord me ndryshimin.

Neni 107.

Vasilika Hysi - Kam një pyetje për paragrafin e parë.

Fatmir Xhafaj - Një paragraf ka.

Vasilika Hysi - Jo, ka dy. I kemi kaluar. Jemi te 109.

Jemi dakord me nenin 106, me nenin 107, me nenin 108.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 107.

Dakord me nenin 108.

Neni 109.

Vasilika Hysi – Në nenin 109 kemi bërë një riformulim: “procedimi disiplinor” në vend të “ngritjes në detyrë”.

Në nenin 109 “Heqja dorë”, në paragrafin e parë ju thoni: “Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor është i detyruar të heqë dorë nga pjesëmarrja në shqyrtimin e procedimit disiplinor, në marrjen e vendimit për ngritjen në detyrë”.

Gent Ibrahimi – Është e njëjta gjë.

Vasilika Hysi - Biem dakord, shumë mirë.

Për zhvillimin e karrierës do të përdorni temin?

Fatmir Xhafaj - Dakord me këto ndryshime.

Neni 110 “Përjashtimi i anëtarit”.

Vasilika Hysi – Këtu duhet një saktësim, do të përjashtojmë anëtarin e komisionit apo anëtarin e këshillit?

Gent Ibrahim – Faktikisht duhet të jetë për të dyja, diku ne themi që rregullat për zhvillimin e mbledhjeve të këshillit vlejné edhe për zhvillimin e mbledhjeve të komisionit, por kemi folur vetëm për mbledhjet, ndoshta duhet ta themi edhe këtu: rregullat që vlejné për kontrollin e konfliktit të interesave për anëtarët vlejné qoftë për veprimtarinë e tyre në mbledhjen plenare, qoftë për veprimtarinë e tyre në komisione. Duhet të ishte e qartë, normalisht.

Vasilika Hysi - Do të preferoja që këtë shtesë që sapo e thatë, ta shtonit, me qëllim që të shmanget çdo lloj diskutimi, apo debati që mund të lindë nëse kjo kërkohet vetëm për këshillin.

Kam një pyetje të dytë, një këshill i përbërë nga tre vetë, kur njëri nga anëtarët heq dorë, sepse është në konflikt interesi, çështja do të gjykohet nga dy anëtarë apo duhet të futet zëvendësuesi më pas, mos duhet të përcaktohet një rregull që në rastin e dorëheqjes do të futet një zëvendësues, sepse nuk ka kuptim mbledhja me dy anëtarë?

Gent Ibrahim - Te pjesa më sipër kur flitet për organizimin e komisioneve thuhet: “Çdo komision ka tre anëtarë, ka dhe dy anëtarë zëvendësues”. Shpresoj që është e qartë, në çdo rast kur dikush nga anëtarët për ndonjë pengesë ligjore ose për ndonjë konflikt interesi, jep dorëheqjen, ose përjashtohet, do të zëvendësohet nga një anëtar zëvendësues.

Vasilika Hysi -...Ju thoni se nuk është e nevojshme të shtojmë një paragraf, kur themi: të njëjta rregulla që përdoren në vazhdim të asaj që sapo riformuluar.

Gent Ibrahim - Mund të shtojmë një paragraf dhe të themi: “Rregullat e këtij seksioni për konfliktin e interesit zbatohen njëlloj qoftë për veprimtarinë e anëtarëve në mbledhjen plenare, qoftë në veprimtarinë e tyre në komisione”. Në rast se ju e gjykoni të nevojshme, sepse ndoshta ne jemi shumë të indoktrinuar tani me këtë dokument dhe me thënë të drejtën nuk më duket e nevojshme, por ju që jeni lexues të freskët në njëfarë mënyre, nëse e shikoni se ka mungesë qartësie, mund ta shtojmë.

Vasilika Hysi – Unë do të shprehja mendimin tim në një ligj të ri, ku ka kaq shumë rregulla të detajuara, procedurë, nuk kemi lënë asnjë hapësirë për keqinterpretime, më mirë të jetë e përcaktuar, që në rast se dikush jep dorëheqjen, hyn anëtari zëvendësues, ose që këto rregulla lidhur me zhvillimin e karrierës nuk janë thjesht për ngritjen e detyrës, por do të zbatohen edhe për... Pra, të mos lëmë asgjë për keqinterpretim dhe debate të pafrytshme.

Zoti kryetar, ky ishte seksioni i tretë që është shtuar.

Fatmir Xhafaj – Dakord me ndryshimet që u propozuan.

Neni 111, “Administrata e këshillit” ose seksioni i katërt, “Organizimi i administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”

Vasilika Hysi – Do të doja të theksoja se organizimi i administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor ka qenë seksioni i tretë, por me shtimin e seksionit “Për konfliktin e interesit” është bërë i katërti.

Unë kam një pyetje për paragrafët tre dhe katër në nenin 111. Iu kemi dhënë statusin e nëpunësve civilë anëtarëve të personelit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Këtu duhet të kemi parasysh se të gjithë anëtarët e personelit kanë statusin e nëpunësit civil, e para?

E dyta, duke iu referuar ligjit nr. 153 të vitit 2013, shoh që ky formulim, në bindjen time, ndoshta e kam gabim, bie ndesh me nenin 2, sepse aty thuhet: “Fusha e zbatimit të nëpunësit civil nuk shtrihet te gjyqtarët, prokurorët dhe nëpunësit e administratës gjyqësore”. Pra, ka dy rrugë: e para që ne duhet të mendojmë është të ndryshojmë ligjin “Për statusin e nëpunësit civil”, sepse ai e ka përjashtuar nga fusha e veprimit të tij faktin që personeli i gjykatave, i prokurorive dhe i Këshillit të Lartë Gjyqësor ka statusin e nëpunësit civil.

Pyetja e dytë: në paragrafin e pestë ju thoni që nëpunësit civilë, të këshillit, ka idenë, mund të marrin pjesë në mbledhjet e këshillit, si dhe të komisioneve, ose të kërkojnë fjalën pa të drejtë vote. Cili është statusi? Çfarë detyrash kanë anëtarët e këshillit dhe pse iu është dhënë hapësirë të marrin pjesë në mbledhjet e këshillit, vetëm nuk kanë të drejtë të votojnë?

Fatmir Xhafaj – Është normale që ata marrin pjesë në mbledhjet e këshillit.

Vasilika Hysi – Jo, që të kërkojnë fjalën.

Fatmir Xhafaj – Që kërkojnë fjalën është... Ata që e kanë shkruar kanë qenë anëtarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me siguri.

Gent Ibrahimi – Më falni, t’i marrim me radhë.

Për çështjen e parë, që ndoshta ligji “Për nëpunësin civil” nuk zbatohet për Këshillin e Lartë Gjyqësor, mendoj se nuk është problem. Nuk e shikoj si problem, sepse tek teksti që keni futur ju thuhet se ligji “Për nëpunësin civil” zbatohet për çdo nëpunës, që ushtron një funksion publik në një institucion të pavarur. Këtu jemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Po, por këtu jemi tek institucioni i pavarur, nuk jemi në gjykatë. Domethënë, Këshilli i Lartë Gjyqësor është institucion i pavarur.

Fatmir Xhafaj – Edhe një herë, këta nuk janë nëpunës të administratës gjyqësore, ky është organ administrativ dhe kjo është logjika.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, mundem?

Fatmir Xhafaj – Të mbarojë zotëria.

Gent Ibrahimi – Këtu kam parasysh rastin kur këshilli shqyrton...

Vasilika Hysi – Vjen i komanduar në magjistrat...

Fatmir Xhafaj – Të lutem!

Gent Ibrahimimi – Për sa i përket të drejtës së fjalës, duke llogaritur që këshilli merr edhe vendime, të cilat janë realizimi i një pune të madhe administrative që ka të bëjë me grumbullim të dhënash, me hartim projektdokumentesh...

Fatmir Xhafaj – Nuk ka nevojë, sepse duket sikur merr të drejtën e fjalës. Me leje flet në këshill. Domethënë, kur kërkohet nga këshilli, sepse ai vartës është.

Gent Ibrahimimi – Atëherë, thjesht merr pjesë kur e kërkon këshilli.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Edhe ajo është shumë, po të jetë, sepse është vartës i këshillit, e thërret këshilli.

Dakord me ndryshimet.

Neni 112 “Sekretari i Përgjithshëm”.

Vasilika Hysi – Kam bërë një shënim te formulimi që është bërë për Sekretarin e Përgjithshëm në nenin 120.

Fatmir Xhafaj – Thuaje!

Vasilika Hysi – “Sekretari Përgjithshëm rekrutohet sipas procedurave të parashikuara në ligjin “Për nëpunësin civil””.

Fatmir Xhafaj – Po. Çfarë problemi ka?

Vasilika Hysi – Nuk e di.

Fatmir Xhafaj – Dakord, e kalojmë dhe, po ngecëm, i kthehemi, sepse ne nuk jemi strikt. Mund ta shikojmë te neni 120 dhe të themi se kemi gabuar te neni 112. Do ta shikojmë.

Vasilika Hysi – Më fal, në draftin e depozituar ju nuk i kishit dhënë të drejtë Sekretarit të Përgjithshëm të propozonte futjen e çështjeve në axhendë. Tashmë në pikën 4 ju i jepni të drejtë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit ose zëvendësit të tij të propozojë futjen e çështjeve në axhendat përkatëse. Pra, nuk ka qenë në nenin 99 të draftit të depozituar në komision. E keni shtuar si element që nga momenti i prezantimit. Ka ndonjë arsye dhe argument?

Gent Ibrahimimi – Ju keni të drejtë. Unë tani po e shikoj që është neni 100 me versionin e rishikuar. Aty parashikohet mënyra e përcaktimit të rendit të ditës dhe kjo që thuhet këtu është një derogim nga rregulli i përgjithshëm për përcaktimin e rendit të ditës dhe mendoj se duhet t'i hiqet kompetenca sekretarit të Përgjithshëm për të kërkuar futjen e çështjeve në rendin e ditës.

Fatmir Xhafaj – Dakord me këtë ndryshim.

Neni 113 “Organizimi i administratës”.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Kam një pyetje në parim për organizimin e administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor. Me këtë ligj ne kemi vendosur që Këshilli i Lartë Gjyqësor do të jetë me kohë të plotë.

Nga ana tjetër, ju krijoni pesë komisione, njëkohësisht edhe disa njësi. Në total mua më duket një qeveri gjigante. Pse? Janë 11 anëtarë këshilli, 5 komisione dhe kaq shumë struktura...

Fatmir Xhafaj – Më fal, mos i mblidh dy herë komisionet, janë anëtarët e këshillit.

Vasilika Hysi – Jo, por çdo komisioni i jepet e drejta të ketë stafin e vetë.

Fatmir Xhafaj – Po, këto janë zyrat, janë njësitë.

Vasilika Hysi – Jo, zoti kryetar.

Po të lexoni, komisionet i kanë njësitë mbështetëse të parashikuara vetëm në germën “b”, ku thuhet: “Njësitë mbështetëse pranë secilit komision të përhershëm”, përveç njësite mbështetëse për secilin komision të përhershëm të këshillit...

Fatmir Xhafaj – Më fal një minutë! Më thotë...

Vasilika Hysi – Ju lutem!

Janë vetëm te germa “b” stafet e komisioneve. Përveç pesë njësite mbështetëse të pesë komisioneve, ke për çështjet e përgjithshme juridike, për administrimin, për etikën, për marrëdhëniet me publikun, për votimet, teknologjinë.

Fatmir Xhafaj – Vetëm t’i përputhim sipas komisioneve tani, të vënë emrat e komisioneve.

Vasilika Hysi – Jo, përveç komisioneve që kanë parashikuar te germa “b”, ke edhe 6 njësi të tjera mbështetëse. Këtu thuhet “së paku”. Pra, mund të ketë edhe më shumë. A nuk është strukturë e fryrë me kaq shumë njësi, me kaq shumë përbërje?

Gent Ibrahimi – Duke pasur parasysh se çfarë po ndodh me Këshillin e Lartë Gjyqësor, që, siç e thatë edhe ju pak më parë, po shndërrohet me një qeveri të vërtetë, me kompetenca, çdokush...

Fatmir Xhafaj – Më falni, këshilli sot ka 30 e ca punonjës, e di unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, nuk është njësi me pesë veta. Ku e ke njësinë me pesë veta? Mund të jetë edhe me një ose dy veta.

Gent Ibrahimi – Kjo është. Se sa e madhe, apo se sa e vogël do të jetë njësia, është një vendim që do ta marrë vetë këshilli në bazë të shumë llogarive, edhe të parave.

Fatmir Xhafaj – Fjala “njësi” është në administratën tonë?

Gent Ibrahimi – Jo, ky është një term gjenerik, i cili duhet përdorur...

Fatmir Xhafaj – Po, e para, duhet përshtatur me strukturën e administratës shqiptare. Ju keni vënë termin “njësitë administrative”, por këto njësi te ne kanë sektorë, zyra.

Gent Ibrahimi – Po, duke pasur parasysh që ky është një orientim i gjerë ligjor, që qeveria e gjyqësorit duhet të ketë, të paktën, njerëz që punojnë me kohë të plotë në këto drejtime, vetë këshilli do të vendosë për strukturën e administratës dhe të secilës njësi. Kur ta bëjë këtë me një akt të brendshëm, pa dyshim që do t’i referohet kësaj terminologjie të përgjithshme që kemi në ligj.

Fatmir Xhafaj – A mund të vendosim një rregull të përgjithshëm pa i ndarë me njësi, deri sa ata ta ndajnë vetë në raport me... Pse do t’i vendosim në ligj, sepse...

Gent Ibrahimi - Ky është detyrim për legjislatorin, që, kur të shkojë nesër *day* me një projektbuxhet, të thotë se unë dua dy për këtë, tre për këtë, një për atë...

Vasilika Hysi – Megjithatë, unë e shtrova këtë pyetje, sepse ...

Fatmir Xhafaj – Legjislatori do ta çmojë, administratë është ajo, do ta shikojë dhe do të thotë: “Më fal një minutë, por çfarë janë këto zyra? Të jap unë...” Ke fatin që mungon një kolegu im deputet këtu, zoti Fino, po ta shikonit çfarë do të ndodhte. Sa herë që vinin strukturat e administratave, insistonte gjithmonë me shumë të drejtë. Prandaj duhet riparë e gjithë kjo.

Gent Ibrahimi – Nga këndvështrimi ynë kjo është garancia, që me ligjin me 3\5-at legjislatori në punën e tij të zakonshme nuk do të ndikojë negativisht në aftësitë administrative të këshillit. Ne duam të sigurohemi në këtë nivel, që të paktën këto njësi do t’i ketë.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Unë të jap numrin e punonjësve dhe më pas ai mund të vendosë një rregull të përgjithshëm aty. Kanë dinamikë, sepse, siç vijnë tani... Më pas ju mund të thoni që ngrihen zyrat, administrata në funksion të komisioneve dhe veprimtarive të tjera që ka këshilli. Ai bën organigramën dhe strukturën. Në një moment të caktuar duhet ta përforcojë, ka shumë punë seksioni i vlerësimit dhe i jep atij më shumë njerëz.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, unë jo pa qëllim e bëra këtë pyetje në parim, sepse ne...

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Vasilika Hysi – Jo, të them një shqetësim tjetër.

Administratën e Këshillit të Lartë Gjyqësor ia nënshtrua ligjit të nëpunësit civil.

Fatmir Xhafaj – Po.

Vasilika Hysi – Në këtë kuadër do të përdoret terminologjia dhe të gjitha rregullat...

Fatmir Xhafaj – Po, e thamë, të riformulojmë komplet nenin 113.

Vasilika Hysi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Ramë dakord ta riformulojmë nenin 113 për të bërë një dispozitë gjenerike, jo kaq të detajuar. Ta shikojmë si do të jetë dhe, edhe qëllimi i tyre dhe kjo që do të themi ne nga praktika që na ka dalë, të përputhen.

Neni 114 “Konflikti i interesi”, dakord?

Vasilika Hysi – Kam një pyetje. Ne kishim një kapitull...

Fatmir Xhafaj – E kaluam një kapitull.

Vasilika Hysi – Po, ne kishim një seksion të veçantë për konfliktin e interesave. Pse të mos e fusim konfliktin e interesave edhe të anëtarit, edhe të administratës bashkë?

Gent Ibrahim - Janë të natyrave krejt të ndryshme, faktikisht, sepse...

Vasilika Hysi – Në rregull.

Gent Ibrahim – Rreziku i vërtetë është atje. Kjo është një klauzolë ...

Vasilika Hysi – Por shikoni çfarë keni shkruar: “Dispozitat që përdoren për anëtarët... Kodit të Procedurës Administrative të ligjit të konfliktit për paanësinë e administratës, zbatohen edhe për personelin e këshillit...”

Fatmir Xhafaj – E administratës publike, një standard është.

Vasilika Hysi – Atëherë del që Kodi i Procedurave Administrative duhet të ketë rregulla.

Gent Ibrahim – Ky është verifikimi që ne do ta bëjmë.

Vasilika Hysi - Edhe ne duhet ta verifikojmë te neni që sapo kaluam.

Gent Ibrahim – Më lart ne e lamë në mënyrë gjenerike “legjisacioni për konfliktin e interesave”. Ndoshta kjo mund të jetë...

Vasilika Hysi – Duhet verifikuar. Ndoshta stafi i këshilltarëve do ta verifikojnë me Kodin e Procedurave Administrative, që të mos lëmë asnjë ligj jashtë.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 115 “Funksionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Petrit Vasili - Do të bëj një koment të integruar me nenet 115 dhe 116, që vlejné për të dyja dhe nuk do të flas për nenin 116 më vonë.

Ky nen, besoj se edhe ju po ta lexoni me qetësi, e shikoni që nuk përcakton objektivat, absolutisht, jep disa parime se si funksionon një sistem i drejtësisë dhe aq më shumë, edhe plani strategjik që rrjedh më pas. Unë i shikoj si dy nene që, në fund të fundit, do të kuptonin se qeverisja e re e gjyqësorit, pavarësisht nga rregullat e reja e të tjera, vazhdon të qeverisë në tradicionalizmin e vetë, ose është vërtet me objektiva të forta dhe sillet si qeverisje gjyqësore. Po ta lexoni me qetësi, do ta shikoni që nuk janë objektiva, të

biem dakord. Ky nen duhet riformuluar dhe duhen vendosur objektivat themelorë, raportet me objektivat, cili është garantimi i paanësisë, cili është raporti se si ecën sistemi në drejtim të freskimit, nivelet e kualifikimit, raportet e tij me sistemet e pushtetit e të tjera. Nuk do të merrem me riformulimin, por neni duhet riformuluar seriozisht me objektiva, sepse kjo qeverisje e re materializohet vetëm tek objektivat. Të themi se ka një administratë kështu, filani ka kështu, ILKPDI-ja, konflikt interesash, nuk themi ndonjë gjë të jashtëzakonshme. Këtu ne kuptojmë se si materializohet kjo qeverisje.

Më pas vjen edhe plani strategjik, i cili nuk thotë se në cilat afate kohore shtrihet, cili është raporti i raportimit mbi zbatimin e planit strategjik, si monitorohet ky plan strategjik dhe neni 116 ka edhe koordinimin me strategjinë e sektorit të drejtësisë. Janë të lidhur me njëri-tjetrin, prandaj po i diskutojmë të dy. Çdo të thotë “strategjia e sektorit të drejtësisë”? Kush e miraton strategjinë e sektorit të drejtësisë?

Fatmir Xhafaj – Ministri.

Petrit Vasili – Ministri? Po ne e kemi thënë se nuk kemi ministër këtu.

Fatmir Xhafaj – Nejse, prandaj merr pjesë.

Petrit Vasili – Prandaj dua të them se ka këtu disa kontradikta të forta, pasi edhe për ekspertët ndërkombëtarë, besoj se këtu ka një problem shumë të madh parimor. Kemi thënë se kjo qeverisje do të bëjë një plan strategjik në përputhje me strategjinë e sektorit të drejtësisë dhe në disa nene më parë kemi vendosur veqilë të sektorit të drejtësisë, simbolik dhe inekzistent. Këtë gjë duhet ta zgjidhim. Ose t’i heqim këto dy nene dhe të rrimë me veprimtarinë rutinore, sepse pa objektiva, pa ndërlidhje... Ne kemi bërë debat me orë të tëra për gjëra minimale, por ky është thelbi i sistemit. Një njeri, në qoftë se do të sqarojë nesër se çfarë bën qeverisja e drejtësisë, do të materializohet në objektivat themelorë që ka, me planet që ka dhe me monitorimin se si realizohen. Më ndjeni, por, të thotë: “Këshilli i Lartë i ushtron funksionet sipas ligjeve dhe i ndërmerr të gjitha veprimet për të garantuar pavarësinë”, nuk është objektiv. Do të përpilohet cili është objektivi për pavarësinë.

Tjetra, “Respektimi i parimeve që udhëheq një status ose gjyqtari në mbarëvajtjen e veprimtarisë”. Sugjerimi im është që këto të dyja duhen riformuluar edhe si objektiva, edhe si ndërlidhje, edhe mënyra e monitorimit të tyre, pasi plani strategjik nga raportimi që ka më pas në Kuvend nuk lidhen gjëkund me njëri-tjetrin.

Cilat elemente të raportimit të planit strategjik do të jenë të detyruara në ligj? Sepse në ligj po përcaktojmë njësitë me dy ose tre veta. Them se në këtë pikë do të duhet një punë shumë serioze, në mënyrë të veçantë për këto dy nene, sepse avokatinë e këtij ligji mund ta bëjmë duke u nisur nga një qasje e re dinjitoze që merr kjo qeverisje në sistem.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Bie dakord me zotin Vasili, që neni duhet të jetë i riformuluar krejt ndryshe. Ndoshta neni për objektivat, mendoj unë, është i tepërt, sepse nuk ka pse ta përcaktojë ligji, kur vetë planifikimi strategjik përcakton herë pas here objektiva. Ne mund t'i shkruajmë në një, por duhet të jetë i detajuar ku synon strategjia, mund të ketë detyrimin për paraqitjen publike, koordinimin me insionet e tjera të sistemit e të tjera. Pra, shtyllat ku synohet një planifikim strategjik, që të mos jetë një dokument me 1 ose 3 faqe, mund të jetë në fillim të çdo këshilli, mund të jetë çdo vit i përsëritur, meqenëse vjen edhe rezoluta e Kuvendit, del në Kuvend, raporton në Kuvend, si i ka, se ku, sepse janë 5 vjet që të formohet këshilli, se duhet ketë një program qeverisës, sepse është i ngjashëm kur konturohet këshilli.

Por, përveç kësaj, ai çdo vit duhet të bëjë një rifreskim të objektivave të tij për shkak të problematikave që ka sistemi. Ndoshta nenet 115 dhe 116 duhet të shkrihen në një, nuk e di si mund t'ju rezultojë më mirë, por në çdo version të dyja duhen riparë dhe duhen riformuluar më shumë.

Biem dakord?

Do t'ju lutesha, nëse ka ndonjë model të ngjashëm të kësaj natyre, duhet parë, ta thoni!

Gent Ibrahimi – VKM-të kanë një rregullim për mënyrën e drejtimit të strategjive.

Fatmir Xhafaj – Dakord, përveç asaj. Mund të themi edhe ndonjë nga këshillat e tjerë analogë që janë.

Gent Ibrahimi – Po.

Fatmir Xhafaj – Por është me interes, sepse, e para, duke qenë se kemi një qasje të re, kjo duhet të konturohet me një dokument.

E dyta, me këtë njerëzit duhet të kuptojnë çfarë sjell kjo. Duhet të kenë ata një autopërgjegjësi, një llogaridhënie.

E treta është kjo që thamë.

Dakord?

(Diskutime pa mikrofon).

Fatmir Xhafaj – Vazhdojmë me nenin 117.

Vasilika Hysi – Kemi ndryshimin e fjalëve “jo më pak se një herë në vit”. Te pika 5, “Këshilli raporton çdo rast tjetër që e vlerëson të nevojshëm ose me kërkesë të Kuvendit”, jam dakord, por duhet ta shtojmë edhe te neni 92, germa “f”. Është thjesht për...

Fatmir Xhafaj – Dakord, por ka diçka. Fjalja nuk mund të fillojë me fjalët “jo më rallë se”.

Vasilika Hysi – Jo, e kemi rivers.

Pra, “Këshilli raporton përpara Kuvendit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor gjatë viteve të mëparshëm jo më pak se një herë në vit”. Raporti përshkruan se gjithçka do të kthehet në... Ky është riformulimi.

Fatmir Xhafaj – Dakord me riformulimin e nenit 117.

Neni 118 “Etika gjyqësore”.

Vasilika Hysi – Është në rregull. Te pika 5 e paragrafit “Këshilli për etikën raporton me shkrim jo më pak se një herë në vit”, do të thosha “Raporton para këshillit për veprimtarinë e tij jo më pak se një herë në vit”.

Kam një pyetje për paragrafin 8 të këtij neni. Ju thoni “burimet njerëzore dhe financiare”. Kur themi se ka komision etike, duhet të ketë edhe staf shtesë? Unë dhe kryetari Xhafaj e ngritëm në fillim këtë shqetësim tek administrata.

Gent Ibrahim – Këshilltari i etikës do të jetë një gjyqtar. Ai mund të jetë me kohë të pjesshme ose me kohë të plotë në varësi të vëllimit të punës.

Vasilika Hysi – Atëherë, kur thua “burime njerëzore”, krijon idenë sikur janë shumë.

Gent Ibrahim – Është e vërtetë, por mund të bëhet fjalë edhe për një njeri të vetëm.

Vasilika Hysi – E lëmë ashtu siç është, të paktën kemi shënim rekord, edhe për transparencë, që mund të ketë edhe më shumë se një person, në varësi të ngarkesës.

Nga ana tjetër, shqetësimi im është të mos abuzohet. Meqenëse këshilli ka kaq shumë kompetenca, i është dhënë edhe pavarësia që të krijojë struktura, të ndryshojë dhe me riformulimin që i bëmë dispozitës tek administrata e këshillit të ketë së paku gjithë ato njësi, mund të bëhet një strukturë supergjigande, e cila ka faturë financiare. Mua më intereson edhe ky aspekt, sepse ky ligj ka faturë financiare.

Gent Ibrahim – Ky është momenti kur ne përplasemi, në njëfarë mënyre, sepse nga këndvështrimi ynë duam të sigurohemi që aftësia qeverisëse e këshillit të mos komprometohet nga shtrëngimet buxhetore, prandaj përpiqemi të jemi sa më të detajuar në këtë fazë. Kurse ju keni hallin tjetër, që të mos abuzohet, ndaj patjetër do të gjejmë një...

Vasilika Hysi – Jam dakord edhe unë, që të ketë administratë efiçente dhe të mjaftueshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Jo, po flasim për nenin 118.

Fatmir Xhafaj – E kaluam nenin 117.

Dakord me ndryshimet për nenin 118.

Neni 119?

Vasilika Hysi - Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 120.

Vasilika Hysi – Te neni 120, për titullin kemi thënë “Rekrutimi, emërimi dhe propozimi i kandidatëve për gjyqtarë”. Apo është veç fjala “rekrutimi”, dhe veç “emërimi i gjyqtarëve”? Unë them se duhet të jetë “Rekrutimi, emërimi dhe propozimi i kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë”. Është e saktë?

Gent Ibrahim – Po, ashtu është e saktë.

Vasilika Hysi – Për ta unifikuar edhe terminologjinë e ligjit “Për statusin”.

Fatmir Xhafaj – Dakord me ndryshimet e paraqitura për nenin 120.

Neni 121.

Vasilika Hysi – Te neni 121 kemi një përsëritje me nenin 94, ku thuhet se Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për çështjet e mëposhtme dhe, në zbatim të ligjit, a mundet të hiqet paragrafi i parë, ta heqim përsëritjen te njëra ose te tjetra. Gjithmonë e shikoj në raport me nenin 94 për të shmangur përsëritjen.

Gent Ibrahim - Po, qëllimi i këtij seksioni është të detajojë paksa funksionet e këshillit dhe ka qenë disi e pashmangshme përsëritja. Megjithatë, mund ta shikojmë dhe ta eliminojmë.

Vasilika Hysi – E dyta, termi “disiplinim” nuk është në ligjin “Për statusin e prokurorit”. Disiplinim është si masë ndëshkuese. Te germa “g” ju thoni “disiplinimi dhe pezullimi”. Mos është “procedura disiplinore”, sepse “disiplinim dhe pezullim” unë nuk arrij ta kuptoj? Çdo të thotë “disiplinim”?

Fatmir Xhafaj – “Procedimi disiplinor” është...

Gent Ibrahim – Po, keni të drejtë. E shikoj që është shtesë e fundit, por, kur flet për disiplinimin, ai ka brenda edhe pezullimin. Ndoshta më shqip do të ishte “zbatimi i masave disiplinore” në vend të “disiplinimit”.

Fatmir Xhafaj – Dakord me ndryshimet e nenit 121.

Neni 122 “Qëndrimet publike”.

Vasilika Hysi – Këtu ka ndryshuar titulli. Më parë ishte “Kërkesa për mendim”. Tani është formulim i qartë, “qëndrimet publike”.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 123 “Trajnimi gjyqësor”.

Vasilika Hysi – Është në rregull. Flet për bashkëpunimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkollën e Magjistraturës me ndryshimet që janë bërë.

Fatmir Xhafaj –Me ndryshimet që janë paraqitur në tekst, kryhen detyrat e të tjera.

Vasilika Hysi – Po.

Fatmir Xhafaj –Dakord.

Neni 124 “Administrimi i gjykatave”.

Vasilika Hysi – Është rënë dakord.

Fatmir Xhafaj – Dakord me ndryshimet.

Neni 125 “Burimet njerëzore në gjykata”.

Vasilika Hysi – Kam një pyetje: në germën “b” ju thoni se Këshilli i Lartë Gjyqësor publikon dhe shpall konkurrim të hapur për vende të lira në shërbimin civil gjyqësor, si dhe fillimin e procedurave për ngritjen në detyrë dhe lëvizjen paralele. Po për gjërat e tjera, nuk vendos?

Gent Ibrahim – Faktikisht këtu duhej t’i referoheshim terminologjisë dhe ligjit “Për nëpunësin civil” dhe, mos qofsha i gabuar...

Vasilika Hysi – Edhe ligji “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit”.

Gent Ibrahim – Jo, sepse për ta kemi zgjedhur të zbatohet ligji “Për nëpunësin civil”, kështu që, këtu mund të biem dakord që të gjejmë terminologjinë e ligjit “Për nëpunësin civil” dhe ta replikojmë.

Fatmir Xhafaj – Dakord me ndryshimin e nenit 125.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, më fal, sepse do të kthehem te pika 4.

Në ligjin “Për statusin e prokurorit nuk kemi përmendur termin “burime njerëzore”, por “stafi, nëpunësi gjyqësor civil”, ose “pjesa tjetër e administratës”. Mos duhet të përmendim terminologjinë që ka Kodi i Punës dhe ligji “Për nëpunësit civil”?

Gent Ibrahim – Dakord. Në përgjithësi do të përdorim atë terminologji që është përdorur edhe te ligji “Për pushtetin gjyqësor”.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesja)* Këshilli nuk ka kompetencë për këtë marrëdhënie, por për këta njerëz do të vendosin këshillat e gjykatave dhe kancelarët. Pra, nuk kemi nevojë t’u referohemi atyre në ligjin e qeverisjes.

Gent Ibrahim - Ata duket sikur përfshihen te burimet njerëzore. Jam dakord të përdorim terminologjinë që të bëhet e qartë, që këta kanë kompetenca vetëm për nëpunësit civilë gjyqësorë.

Vasilika Hysi – Ekzakt.

Gent Ibrahim – Kështu që do ta rakordojmë me ligjin “Për pushtetin gjyqësor”.

Fatmir Xhafaj – Dakord me ndryshimet e nenit 125.

Vasilika Hysi – Ndjesë, edhe për një pikë.

Te germa “k” e nenit 125 ju thoni “Ushtron çdo kompetencë tjetër që ia jep ligji”. E keni fjalën “të parashikuar në këtë ligj”, apo në ligje të tjera?

Gent Ibrahim – Jo domosdoshmërisht në çdo ligj.

Vasilika Hysi - Atëherë do të themi “Ushtron kompetencë të parashikuar me ligj”, jo “që i jep ligji”.

Gent Ibrahim – Po, është më shqip kështu.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 126 “Qasja në drejtësi dhe marrëdhëniet me publikun”.

Vasilika Hysi – Ka një riformulim në krahasim me variantin fillestar, është më i plotë. Jam dakord, përveç riformulimeve të teknikës, që ju i keni përpara.

Fatmir Xhafaj – Dakord me ndryshimet e paraqitura dhe që kanë dakordësi të përgjithshme.

Neni 127 “Sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve”?

Vasilika Hysi – Edhe ky nen, zoti kryetar, është riformuluar. Pas kalimit të ligjit “Për statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit”, edhe këtu është përdorur e njëjta terminologji, prandaj kemi shumë riformulime.

Fatmir Xhafaj – Neni 127 dakord, me riformulimet e paraqitura.

Neni 128 “Mendime mbi legjislacionin”?

Vasilika Hysi - Mendoj se ka nevojë të bëhet riformulimi i germës “b”: “I propozon ministrit të Drejtësisë rregulla dhe dispozita të reja të procedurës gjyqësore civile”. Unë mendoj se duhet të jetë “propozime për ndryshime”, sepse Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk i propozon ministrit rregulla dhe dispozita të procedurës gjyqësore civile, penale dhe administrative, por bën rekomandime për shtesa dhe ndryshime.

Fatmir Xhafaj - Edhe kjo shqyrton funksionimin e rregullave.

Së pari, ato nuk janë rregulla, por janë dispozita. Këshilli jep vetëm mendime dhe nuk merr funksione legjislative. Edhe aty ku themi që ministri të rrijë sa më larg këshillit, kurse për çështjet që i takojnë ministrit themi “bën rekomandime, shqyrton, propozon, jep përgjigje për të dhënë mendim mbi një projektligj”, jemi dakord. Ky nen mund të riformulohet i gjithi.

Vasilika Hysi - Mendoj se gerrat “a”, “b” dhe “c” janë e njëjtat gjë.

Fatmir Xhafaj - Të lutem, e gjithë kjo duhet riformuluar.

Gent Ibrahimi - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Neni 129 “Rregullat e brendshme të gjykatave”?

Vasilika Hysi - Nuk kam asgjë.

Fatmir Xhafaj - Dakord me ndryshimet e paraqitura.

Vasilika Hysi - Këtu te germa “h” të shtohet: “Udhëzues për monitorimin e shtyrjes së seancave gjyqësore”. Edhe kur themi “krijimi i formateve për vendime gjyqësore” duhet të jetë “krijimi i modeleve për standardizimin e elementeve të një vendimi gjyqësor” apo jo, zoti Ibrahimi?

Gent Ibrahimi - Po, për atë është fjala.

Vasilika Hysi - Duhet rregulluar kjo.

Gjithashtu, pika 5, zoti kryetar, “Rregullat për cilësinë e drejtësisë”, duhet të jetë “rregullat e cilësisë së drejtësisë” apo “të dhënies së drejtësisë”? Pra, bëhet fjalë për atë proces, ku gjyqtarët duan të japin drejtësi dhe fillojnë të arsyetojnë për marrjen e vendimit.

Fatmir Xhafaj - Jo, është gabim “Rregullat për cilësinë e drejtësisë” se duhet të jetë “për shërbimin e drejtësisë”, sepse kjo është për shërbimin.

Vasilika Hysi - Për ofrimin e të gjitha shërbimeve, por jo për drejtësinë.

Fatmir Xhafaj - Jo për drejtësinë vetë, por për cilësinë e drejtësisë. Pra, është gabim.

Vasilika Hysi - Gjithashtu, edhe termi tjetër, ku thuhet: “Zhvillimi i vrojtimeve për nivelin e kënaqshmërisë”, unë mendoj se këtu duhet të jetë: “Zhvillimi i vrojtimeve për nivelin e vlerësimit të përdoruesve të gjykatave me shërbimet e tyre”, sepse janë ankimet për të cilat bëhen studimet.

Fatmir Xhafaj - Në rregull!

Neni 129 dakord me të gjitha ndryshimet.

Neni 130 “Buxheti vjetor i këshillit dhe gjykatave”

Vasilika Hysi - Ky është ish-neni 124 dhe nuk kam asnjë sugjerim.

Kam vetëm një gjë për ju, zoti kryetar. Dua t’ju kujtoj se në pikën 3 është vënë me kusht një element buxhetor, që e ka në kompetencën e tij Këshilli i Ministrave. Këtu thuhet: “Në çdo rast, dyshemeja e programit buxhetor afatmesëm për financimin e sistemit të drejtësisë nuk mund të jetë më pak se 1% e shpenzimeve buxhetore”.

Unë nuk flas dot, sepse pritet mendimi i Këshillit të Ministrave.

Fatmir Xhafaj - Kjo nuk shkon.

Gent Ibrahimi - Ne këtë e kemi marrë nga grupi tjetër dhe ka të bëjë me financimin e sistemit të drejtësisë.

Fatmir Xhafaj - Dakord, por hiqeni këtë dhe vendoseni atje. Nëse vendoset ndonjë kusht në rregull, por jo këtu, se duket sikur ka të bëjë me qeverisjen.

Gent Ibrahimi – Është vënë këtu, sepse është vendi i ku u kërkohet këtyre që të hartojnë buxhetin. Do ta kem parasysh këtë gjë.

Fatmir Xhafaj - E ka vetëm Ministria e Mbrojtjes për efekt të NATO-s.

Gent Ibrahimi - Megjithatë sigurohuni që nuk është, sepse, siç e thashë, këtë dispozitë ne e kemi marrë atje.

Vasilika Hysi - Te cili ligj tjetër, zoti Ibrahimi?

Gent Ibrahimi – Nga grupi i punës për financimin, me zotin Panda.

Vasilika Hysi – Dakord!

Te pika 7 jeni shprehur përsëri për fondet dhe thoni: “Rregullat e miratuara nga Këshilli i Ministrave për përdorimin e fondeve ndërkombëtare”, Ne nuk kemi shprehje të tilla si “fonde ndërkombëtare” .

Gent Ibrahimi - Jo nga Këshilli i Ministrave, por nga vetë këshilli.

Vasilika Hysi - Më falni, ka rregulla për përcaktimin e buxhetit dhe për përdorimin e fondeve.

Fatmir Xhafaj - Për përdorimin e fondeve në legjislacionin në fuqi.

Vasilika Hysi - Si do ta riformulojmë “legjislacioni për përdorimin e fondeve”, se unë nuk jam në gjendje ta riformuloj?

Gent Ibrahimi - “Në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën buxhetore”. Kaq.

Fatmir Xhafaj - Neni 131 “Zbatimi i buxhetit gjyqësor”

Vasilika Hysi - Te ky nen mendoj se mungon diçka, zoti Ibrahimi. Te pika 2 thuhet: “Për të zbatuar detyrat e përshkruara në paragrafët e mësipërme”. Në fakt, është vetëm një paragraf. Ideja është për paragrafin e parë?

Gent Ibrahimi - Po, bëhet fjalë për paragrafin e parë.

Vasilika Hysi - Në rregull.

Për pjesën tjetër nuk kemi asgjë, sepse këtu shpjegohet se përse përdoren fondet e këshillit, si përdoret buxheti lidhur me njësinë administrative të buxhetit gjyqësor e të tjerë.

Fatmir Xhafaj - Dakord me këto ndryshime.

Vasilika Hysi - Te kreu 4 janë “Aktet dhe rregullat procedurale” dhe ish-neni 126 është bërë neni 132.

Kam një pyetje, zoti Ibrahimi, për germën “c”, ku thuhet: “Aktet normative nënligjore administrative në zbatim të këtij ligji ose të ligjeve të tjera”, mos ndoshta duhet saktësuar terminologjia?

Gent Ibrahimi - Sido që është shkruar, definicioni i vetëm për këtë është te Kodi i Procedurave Administrative, kështu që do të përdorim po atë gjuhë që është përdorur atje.

Vasilika Hysi - Së dyti, nga pikëpamja narrative te germa “d”, a është e mundur që të bëhet në formë narrative dhe të hiqen këto pikëzimet, sepse nuk janë në ligj.

Gent Ibrahimi - Patjetër.

Vasilika Hysi - Çfarë keni parasysh me “udhëzime jodetyruese”? Unë e kuptoj se këshilli ka akte detyruese dhe jodetyruese. “Udhëzime detyruese” janë rekomandime?

Gent Ibrahimi - Mund të jenë në fushën e etikës. Për shembull, mbi bazën e këshillave të këshilltarit të etikës, këshilli mund të miratojë udhëzime për sjelljen e gjyqtarit në kohën e lirë në ambiente publike e kështu me radhë.

Vasilika Hysi - Këto udhëzime nuk janë të detyruara?

Gent Ibrahimi - Jo, varet në varësi të çështjeve. Në fakt, e mora si shembull, pa u menduar shumë gjatë, por mendoj se ka gjithmonë hapësira që një organ rregullator, sepse këshilli është edhe organ rregullator midis të tjerave, të ketë mundësi të lëshojë dhe udhëzime të karakterit të përgjithshëm.

Do të na duhet të bëjmë një llogari. Tani që ju e ngritët këtë pyetje, në qoftë se ka raste kur këshillit i duhet të veprojë në këtë formë, do ta heqim. Në rast se do të na vijë në mendje se këshilli mund dhe duhet të veprojë në këtë mënyrë do ta mbajmë. Për momentin premtoj se do të japim një mendim më të thelluar se ç’është.

Vasilika Hysi - Në rregull, ta lëmë për verifikim dhe për riformulim. Nuk kam gjë tjetër për këtë pikë, zoti kryetar.

Fatmir Xhafaj - Në rregull, dakord me ndryshimet.

Neni 133 “Njoftimi dhe botimi i akteve të Këshillit”?

Vasilika Hysi - Te neni 138 cili është kuptimi i termit “zyrtarëve të veçantë të administratës”?

Gent Ibrahimi - Ku jeni, më falni?

Vasilika Hysi - Bëhet fjalë për nëpunësit gjyqësorë civilë, ku thoni: “Njoftimi i akteve administrative individuale të këshillit në lidhje me statusin e gjyqtarëve ose zyrtarëve të veçantë të administratës”?

Gent Ibrahimi - Po, bëhet fjalë për nëpunësit civilë.

Vasilika Hysi - A mund ta zëvendësojmë?

Gent Ibrahimi - Patjetër.

Vasilika Hysi - Në rregull.

Fatmir Xhafaj - Dakord me ndryshimet në nenin 133.

Neni 134?

Vasilika Hysi - Është ndryshuar titulli dhe është bërë “Procedura e rishikimit”. Në fakt, ne përdorim herë termin “rishikim” dhe herë termin “rivlerësim”. A do të lemë termin “rishikim”?

Gent Ibrahim - Këtu kemi një problem, në fakt, që Kodi i ri i Procedurës Administrative lë vend vetëm për ankime. Ka ankime tek organi që ka nxjerrë aktin, por ka ankime edhe tek organi më i lartë. Kam përshtypjen se ne këtu e kemi fjalën për ankime të formës së parë, pra për ankime brenda organit. Megjithatë, Kodi i Procedurës Administrative të lejon hapësira që për ligje të posaçme të bëhen rregullime të posaçme. Ne këtu jemi në një situatë të posaçme, ku kemi një organ, i cili, në radhë të parë, vepron në shkallë të parë përmes komisioneve dhe në shkallë të dytë në përbërje të plotë. Kështu që në rast se ne këtu dalim me një koncept të ri, me konceptin e “rishikimit”, që nuk është 100% një ankim administrativ brenda organit që parashikon Kodi i ri i Procedurës Administrative. Kështu, më duket se jemi në rregull.

Kodi i Procedurës Administrative ka vlerën e një udhëzuesi të përgjithshëm për legjislatorin, që kur ulet dhe shkruan ligje të veçanta, mban parasysh, sa është e mundur, ato formate dhe ato koncepte, por nëse legjislatorit nuk i del llogaria në ndonjë rast konkret, ai është i lirë që të propozojë një procedurë të posaçme. Procedura e rishikimit, sipas nenit 134, nuk ka një mbështetje të qartë në Kodin e Procedurave Administrative, por ama është një procedurë që u përgjigjet nevojave dhe natyrës së punës së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Vasilika Hysi - Duke qëndruar po te ky nen, në pikën 3 ju thoni: “Kërkesa mund të bazohet në arsytet e mëposhtme: ka ndodhur një gabim i rëndë procedural.” Këtu bëhet fjalë që vendimi është marrë në shkelje të procedurës? Mos është më mirë ta riformulojmë? Pse duhet të jetë detyruesisht gabim i rëndë? Në qoftë se ndodh një shkelje procedurale, çfarë rëndësie ka nëse është e rëndë apo jo, kur ajo ndikon tek akti administrativ individual?

Gent Ibrahim - Një formulim alternativ mund të ishte: “Një shkelje procedurale që ndikon” ose “që mund të ndikojë”.

Vasilika Hysi - Për të tjerat besoj se biem dakord që do të lemë fjalën “rishikim” në të gjithë paragrafët?

Gent Ibrahim - Po.

Fatmir Xhafaj - Dakord me ndryshimet në nenin 134.

Neni 135?

Vasilika Hysi - Nuk kam gjë.

Fatmir Xhafaj - Dakord me nenin 135.

Vazhdojmë me “Këshillin e Lartë të Prokurorisë”. Besoj se do të jetë përgjithësisht e njëjta gjë.

Vasilika Hysi – Këtu është vetëm një nen. Në qoftë se ju kujtohet, zoti kryetar, kur diskutuam ligjin “Për prokurorinë në Republikën e Shqipërisë”, ne thamë se në këtë ligj rregullohen shumë gjera, por kjo është një dispozitë referuese, sepse në të gjithë paragrafët e saj nga 1-shi te 6-ta tregojnë se dispozitat për Këshillin e Lartë Gjyqësor zbatohen, për aq sa është e mundur, edhe për Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Shqetësimi im, në qoftë ju kujtohen edhe debatet që kemi bërë bashkë, është se Këshilli të Lartë të Prokurorisë nuk i kemi dhënë kaq shumë rregullime, siç e rregullon neni 136, që në variantin e depozituar në komision është neni 130.

Fatmir Xhafaj - Po çfarë rëndësie ka se sa ka qenë?

Vasilika Hysi - Kë do të zbatojmë?

(Diskutime pa mikrofon.)

Gent Ibrahimi - Faktikisht ky duket sikur është një nen. Këtu ne ishim përballë dy opsioneve: ose të përsërisim gjithçka që është thënë më sipër për mënyrën e organizmit, të për zgjedhjes së kandidatëve, për organizmin e administratës, për konfliktin e interesit, për aktet, për gjithçka...

Fatmir Xhafaj - Vetvetiu do të jetë i ndryshëm. Për shembull, fjala vjen, në qoftë se atje do të ngelen noterët, këtu është e sigurt që nuk do të ketë noterë.

Gent Ibrahimi - Për momentin janë edhe këtu. Mund të them se ky nen këtu është i menduar mirë, pra është marrë çdo dispozitë që ka të bëjë me për zgjedhjen e kandidatëve, organizimin e mbledhjes, me konfliktin e interesit dhe është parë nëse bëjnë sens edhe këto për këshillin. Neve na rezultoi se bëjnë sens.

Vasilika Hysi - Jam dakord.

Fatmir Xhafaj - Rregullimet e neneve do të bëhen më vonë pasi të marrin formë. Nuk është problem numri i nenit, sepse është një gjë që bëhet.

Problemi është se ndoshta nuk është shumë serioze të bëhet me një nen të vetëm.

Gent Ibrahimi - Faktikisht duket joserioze, por është racionale.

Fatmir Xhafaj - Racionale është për ekonomi teksti, por për mesazhin është irracionale. Ne do të zgjedhim midis kësaj dhe kësaj tjetrës. Më mirë të kemi një tekst pak më voluminoz, ku pasi të kemi mbaruar punë me dy këshillat t'i për mbledhim, për shembull, konfliktin e interesave, administratën, që të jenë të njëvlefshme, sepse kanë të njëjta principe.

Gent Ibrahimi - Atëherë, ju doni një rishikim të kësaj?

Vasilika Hysi - Zoti Ibrahimi, unë e bëra këtë pyetje...

Farmir Xhafaj - Një sekondë, se i kam kërkuar...

Gent Ibrahimi – Atëherë, ju doni një rishikim të kësaj, në mënyrë që dispozitat për Këshillin e Lartë të Prokurorisë të jenë më të shumta se kaq dhe aty ku është e mundur të ketë rregullime të posaçme? Atëherë, dakord.

Farmir Xhafaj - Besoj se është më korrekte. Nuk e di, zonja Bernhard, a keni të njëjtin koncept me mua, apo e ka të ndryshëm?

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesja)* Unë e kuptoj specifikimin e mëtejshëm të këtij kapitulli, por sigurisht referencat mund ta bëjnë më të arsyeshëm për një institucion shumë të rëndësishëm. Pra, duket sikur nuk është marrë mjaftueshëm në konsideratë. Ai është një institucion, që ka kompetenca shumë të rëndësishme dhe është pjesë e rëndësishme e gjithë sistemit.

Fatmir Xhafaj –Atëherë, do ta rregulloni?

Në rregull! Faleminderit për mirëkuptimin!

Unë mendoj se ne mund të vendosim disa gjëra që janë bazike te kjo. Për shembull, ato që lidhen me administratën mund t'i bëjmë bashkë, sepse administrata gjyqësore dhe ajo e prokurorisë kanë një trajtim, nuk kanë dy trajtime në marrëdhënie me median dhe me të gjithë pjesët. Pra, është e njëjta gjë dhe mund t'i unifikojmë në një. Po kështu, edhe konflikti i interesave është i njëjtë, sepse nuk mund të jetë i ndryshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, ne duhet të vëmë Këshillin e Prokurorisë si Këshill Gjyqësor me funksionet bazike, me organizmin bazik e të tjera, sepse kapitulli “Konflikti i interesave” është i njëjtë. Pra, do të thuhet: “Konflikti i interesave në rastin e Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë”, kaq, dhe kuptohet që do të zbatohen veç e veç.

Kështu që këtyre vajzave me keqardhje do t'u them se u doli një punë e rëndësishme për fundjavën. Në rregull, ramë dakord.

Vazhdojmë me “Inspektorin e Lartë të Drejtësisë”. Numërtimi do të vazhdojë, por natyrisht do të ndryshojë më pas. Ne do të futemi te dispozitat e reja dhe do të ecim me këtë numërtim që kemi këtu.

Neni 137 “Inspektori i Lartë i Drejtësisë”

Vasilika Hysi - Është thjesht për kompetencat dhe personalisht nuk kam ndonjë problem.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Neni 138 “Objekti i veprimtarisë”?

Vasilika Hysi - Te pika 2, nisur edhe nga shqetësimi që ngriti zoti Vasili, ku thuhet: “Për verifikimin e ankesave ose hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj subjekteve të parashikuara në pikën e parë të këtij neni, inspektori vihet në lëvizje”. Këtu duhet “me informacionin me shkrim të ministrit” apo “me kërkesë me shkrim të ministrit”? Si është më mirë?

Fatmir Xhafaj - Siç është bërë për të gjithë. Ashtu siç është bërë për KLGJ-në, le të bëhet edhe për këtë.

Vasilika Hysi - Diku këtu thuhet “informacion”, kurse te pika e parë thuhet: “ankesë ose informacion e shkruar nga çdo person fizik, juridik”. A mund të bëjë ankesë ministri, që mund t’i ketë dalë në punën e tij?

Fatmir Xhafaj - Po patjetër, sepse ministri...

Vasilika Hysi - Se ka Drejtorinë e Burgjeve, ka...

Fatmir Xhafaj - Nuk ka rëndësi, është edhe për gjyqtarët, që mund të bëjnë ankesa te ministri i Drejtësisë. Ky është realiteti që kemi ne në këtë vend, sepse atë e përfytyrojnë si një njeri të sistemit dhe mund t’i shkojnë njerëz të ndryshëm që të bëjnë ankesa.

Vasilika Hysi - Atëherë, do të përdorim vetëm termin “informacion me shkrim të ministrit” apo edhe ndonjë ankesë që mund të ketë marrë ministri?

Gent Ibrahimi - Meraku këtu është që të mos i japim një koncept të mirëfilltë procedural rolit të ministrit në raport me atë që po u bë ankesa do të shqyrtohet patjetër. Ai është një informacion që ...

Fatmir Xhafaj - Po pse të mos e vëmë që ai të jetë i detyruar...

Gent Ibrahimi - Sepse këtë e kemi diskutuar gjatë me Komisionin e Venecias dhe ata kanë refuzuar çdo rol të posaçëm të ministrit të Drejtësisë në raport me...

Fatmir Xhafaj - Nuk jam shumë dakord me ju në këtë pikë. Ndjesë, por kam përshtypjen se ata kanë thënë që nëse do t’ia jepni këtë gjë, duhet ta qartësoni në ligj.

Gent Ibrahimi - Mund ta verifikojmë.

Fatmir Xhafaj - Po, mund ta verifikojmë këtë gjë. Të lutem Matilda, ma kujto këtë gjë.

Gent Ibrahimi - Këtu ideja është që ministri i Drejtësisë thjesht përmendet. Në variantin tonë të parë ne nuk e përmendim fare “në mënyrë të posaçme”, por thjesht kemi thënë “çdo organ publik i interesuar”. Pas diskutimeve që u bënë në këtë komision, e pamë të arsyeshme që ta përmendnim në mënyrë specifike.

Fatmir Xhafaj - Dakord jam, por e shikojmë këtë parashikimin...

Gent Ibrahimi - Ajo ankesë nuk mund të jetë, ose do të jetë “kërkesë”, ose do të jetë “informacion”, pra është çështje linguistike.

Fatmir Xhafaj - Dakord. Vendorsim termin “kërkesë” këtu, sepse informacion është kur e informon, kurse ti po bën një kërkesë.

Gent Ibrahimi - Në rregull e lëmë “kërkesë”.

Fatmir Xhafaj – Por te rasti i ministrit do ta shikojmë si e ka Komisioni i Venecias. Në qoftë se ka thënë që mund ta parashikonim, ne duhet ta fusim, në mënyrë që të jetë pak më ekskluziv në ndryshim nga subjektet e tjera.

Dakord me këto ndryshime.

Neni 139 “Parimet themelore të veprimtarisë dhe organizimit”

Vasilika Hysi - Te neni 139 thuhet: “Parimi i konfidencialitetit të të dhënave dhe dokumenteve që krijon inspektorati ose i vihen në dispozicion”.

Gent Ibrahimi – Ajo është hequr sepse ishte më vete, neve na rezultoi që është thjesht një parim, kështu që e fusim te lista e parimeve.

Vasilika Hysi - Në rregull!

Fatmir Xhafaj – Këto terma që keni lënë te germa “f”, a mund t’i ktheni në gjuhën shqipe?

Gent Ibrahimi - Po, do të jenë fjali në gjuhën shqipe.

Fatmir Xhafaj - Dakord, ose vëreni në fillim, te definicionet.

Gent Ibrahimi - Në këtë ligj nuk ka qenë nevoja për definicione dhe do të ishte mëkat, që t’i vendosnim vetëm për hir të këtyre të dyjave. Atëherë, po i shqipërojmë.

Fatmir Xhafaj - Në rregull, vëreni edhe këtë në kllapa.

Dakord me ndryshimet.

Neni 140 “Pavarësia”?

Vasilika Hysi - Nuk kam asgjë lidhur me këtë. Vetëm te pjesa “passjell përgjegjësi”, a mund të përdorim një fjalë tjetër? Për shembull “shkakton përgjegjësi” ose “mban përgjegjësi sipas ligjit”?

Gent Ibrahimi - “Shkakton përgjegjësi”, mund të jetë një alternativë.

Fatmir Xhafaj - Në rregull.

Neni 141?

Vasilika Hysi - Neni 141, zoti kryetar, bën fjalë për buxhetin e inspektorit dhe inspektoratit dhe të drejtat që ka ai të paraqesë.

Në qoftë se ju kujtohet te ligji “Për prokurorinë” ne kemi thënë se duhet të përdorim të njëjtën terminologji. Mos duhet ta përdorim edhe këtu? Sepse ne i kemi dhënë të drejtë

inspektorit që të vijë dhe të debatojë në komision. A do të lemë këtë formulim apo do të lemë atë lloj formulimi që u propozua në fillim?

Fatmir Xhafaj - Po, ai ka të drejtë të vijë sa herë të dojë dhe nuk ka pasur kundërshtime.

Vasilika Hysi - Pyetja ime është: kush do t'i bëjë riformulimet e neneve për buxhetin në gjuhën e...

Gent Ibrahimi – Pa dyshim që ne do ta bëjmë, por, qofsha i gabuar, kjo është unifikuar me gjuhën që është përdorur te ligji “Për prokurorinë” dhe mund ta verifikojmë.

Fatmir Xhafaj – Le ta verifikojmë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ne duhet të përdorim një terminologji për buxhetin në të gjitha ligjet e sistemit, pra me të njëjtën logjikë edhe si procedurë, edhe si koncept.

Në rregull me ndryshimet në nenin 141.

Neni 142 “Inspektori i Lartë i Drejtësisë”?

Vasilika Hysi - Nuk kam ndonjë sugjerim.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Neni 143?

Vasilika Hysi - Lidhur me nenin 143 kam një vërejtje parimore. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është njeriu më i rëndësishëm dhe kur lexojmë kriteret që duhet të përmbushë, ato janë shumë bazike që t'i mund të kesh për këdo. Cili është ai që sot nuk ka një diplomë master? Cili është ai që nuk ka 15 vjet përvojë pune, që nuk është i dënuar, që nuk ka qenë anëtar partie? Këto kriteret për inspektorin mua më duken shumë pak, zoti kryetar. Unë mendoj se duhet të ketë kushte ligjore dhe kriteret shtesë.

Fatmir Xhafaj - Ku i kemi aplikuar ne këto raste?

Gent Ibrahimi - Te prokurori i Përgjithshëm ndoshta.

Fatmir Xhafaj - A mund t'i shohim pak, të lutem, që të ndajmë kushtet dhe kriteret?

Gent Ibrahimi - Vetëm se duhet të keni parasysh një gjë, sado që mua më duket pak e thatë këtu, por kur të shkojmë te kapitulli “Për Këshillin e Emërimeve” do të shohim që aty këshilli ka kriteret pafund, që efektivisht i pasurojnë këto.

Vasilika Hysi - Në fakt, zoti Ibrahimi, po ta shikoni titullin e nenit 143 thuhet: “Kushtet dhe kriteret e emërimit”. Paragrafi i parë ka vetëm kushtet më bazike, pra: të ketë mbaruar shkollën, të mos ketë qenë anëtar partie dhe të mos ketë pasur funksione.

Gent Ibrahim - Atëherë, do ta përafrojmë me nenin përkatës të ligji “Për prokurorinë”, aty ku flitet për prokurorin e Përgjithshëm.

Fatmir Xhafaj - Ky besoj se duhet të jetë gjyqtar apo prokuror?

Gent Ibrahim - Mund të jetë, por jo domosdoshmërisht.

Fatmir Xhafaj - Kështu e kemi në Kushtetutë, apo jo?

Gent Ibrahim - Po.

Fatmir Xhafaj - A mund ta vendosim si preferencë të qenit gjyqtar?

Gent Ibrahim - Eksperienca relevante është një nga faktorët që merr parasysh Këshilli i Emërimeve. Nëse ti thua se ke qenë gjyqtar për kaq vjet...

Fatmir Xhafaj - A mund të konkurrojmë një gjyqtar për t’u bërë kryeinspektor?

Gent Ibrahim - Po, mund të konkurrojmë.

Fatmir Xhafaj - A mund ta kemi si kriter favorizues?

Gent Ibrahim - Kam përshtypjen se këto rregullohen te Këshilli i Emërimeve.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, po e mbajmë shënim, sepse mendoj se çdo rast është më mirë kur këtë funksion e merr një gjyqtar, apo jo zonja Agnes?

Agnes Bernhard - Ka argumente për të dyja, nëse keni një gjykatës, keni dikë që është i brendshëm dhe e di se si funksionojnë gjërat dhe se si duhet të përcaktohen standardet.

Nga ana tjetër, një gjykatës ose një prokuror mund të jetë shumë i lidhur me kolegët e tij dhe mund të ketë nocionin e korporatizmit këtu brenda. Në Europë ka modele për...

Fatmir Xhafaj - Nëse një pedagog që vjen këtu duhet të ketë kritere shumë të forta korporatizmi, pra kryeinspektori. Kjo është shumë keq, sepse mendova mos ndoshta një lajthitje e imja.

Gent Ibrahim - Faktikisht jemi të detyruar që të mbajmë këto kritere të gjera këtu. Edhe sikur këtu të mos kishim kritere as për këshillat, as për prokurorin, ne e kemi zgjidhur me një dorë të vetme me Këshillin e Emërimeve. Rregullimet që japim aty ne...

Fatmir Xhafaj - Ai hyn atje deri te këshilli, por më mirë t’i ketë që këtu. Në rregull, do ta shohim edhe atje.

Dakord 143 me këto ndryshime që thamë.

Neni 144 “Papajtueshmëritë”? A biem dakord me ndryshimet e paraqitura?

Vasilika Hysi - Po. E vetmja gjë është “pozicion drejtues”, si: funksionet, detyra e të tjerë.

Fatmir Xhafaj - Dakord me ndryshimet e paraqitura.

Neni 145 “Përzgjedhja dhe emërimi”?

Vasilika Hysi - Dakord.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Faleminderit!

Neni 146 “Betimi dhe fillimi i detyrës”? Dakord.

Neni 147 “Mandati i inspektorit të Lartë të Drejtësisë”? Dakord.

Neni 148 “Kompetencat e inspektorit të Lartë të Drejtësisë”?

Vasilika Hysi - Te ky nen i kemi dhënë qaq shumë kompetenca, prandaj të gjitha këto kompetenca kërkojnë edhe disa kushte dhe kritere shumë më të forta.

Fatmir Xhafaj - Po, dakord kemi ndonjë gjë tjetër?

Vasilika Hysi - Te pika “d” ku thuhet: “Është i detyruar të raportojë në Kuvend të paktën një herë në vit për punën e inspektoratit në vitin pararendës”, të shtojmë edhe “sa herë që është e nevojshme dhe që kërkohet nga Kuvendi”.

Fatmir Xhafaj - Dakord me ndryshimet.

Neni 149 “Zëvendësi i inspektorit”? Dakord me ndryshimet.

Neni 150 “Mbarimi i mandatit”? Dakord.

Neni 151 “Shkeljet disiplinore”? Dakord, me redaktimet dhe me riformatimet për teknikë legjislativë.

Neni 152 “Hetimi i shkeljeve disiplinore”?

Vasilika Hysi - Zoti kryetar, të lutem! Te neni 151, paragrafi 2 mendoj se bie ndesh formulimi i paragrafit 2 me germën “g”.

Më lart themi: “Është dënuar për një vepër penale, që e bën atë të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin”, dhe më poshtë themi: “Të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi”.

Fatmir Xhafaj - Ku je, te neni 151?

Vasilika Hysi – Po, te neni 151.

Pra, te germa “g” e paragrafit të parë kur inspektori mund të shkarkohet themi: “kur dënohet për një vepër penale”. Nuk ka rëndësi nëse është krim apo kundërvajtje, por që e bën atë të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin. Ndërkohë, te paragrafi i dytë ne themi: “Shkarkohet nga detyra edhe kur dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi”.

Gent Ibrahim – Kjo, në fakt, e ka një qëllim, sepse jo çdo vepër penale ndoshta e bën të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e inspektorit, kurse pa dyshim që çdo krim duhet të rezultojë në shkarkimin e tij. Megjithatë, në qoftë se kjo ju duket një nuancë e tepruar, mund ta heqim pikën 2, ose të themi: “Dënohet me vendim të formës së prerë për

kryerjen e një vepre penale”. Kaq. Kështu ia vlen ta mbash standardin e lartë për çfarëdo lloj vepre penale.

Fatmir Xhafaj - Në rregull.

Neni 152 dakord me ndryshimin.

Vasilika Hysi - Te neni 152 kam një pyetje: te pika 4 flisni për ligjin “Për Gjykatën Kushtetuese”, zoti Ibrahimimi? Pra, gjykata vendos në bazë të ligjit “Për Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”?

Në pikën 4 “Shkeljet disiplinore thuhet: “Në përfundim të hetimit parlamentar, Kuvendi merr vendim...”

Fatmir Xhafaj - Pse e lexon kaq gjatë ? Thuaj pika 4, në fund, ku thuhet: “Gjykata Kushtetuese vendos shkarkimin”.

Gent Ibrahimimi - Faktikisht aty janë proceduarat e posaçme në ligjin “Për Gjykatën Kushtetuese”.

Fatmir Xhafaj - Kjo kuptohet që është sipas ligjit përkatës, sepse ajo vendos sipas ligji të saj, se nuk do të vendosë me ligj tjetër.

Gent Ibrahimimi - Në rregull po e specifikojmë.

Fatmir Xhafaj - Në rregull.

Neni 152 dakord.

Dakord me ndryshimet e paraqitura në nenin 153 “Kushtet për detyrën e inspektorit”?

Vasilika Hysi – Kam diçka te neni 153, paragrafi 4, germa “j”.

Në germën “b” thuhet: “Kandidati për inspektor të ketë një profil të spikatur shoqëror”. Në germën “j” thuhet: “Kandidati për inspektor është person me reputacion dhe standarde të larta etike dhe morale”.

Gent Ibrahimimi - Po, janë përsëritje.

Vasilika Hysi - Janë përsëritje dhe duhen riformuluar germat “b” dhe ‘j”.

Fatmir Xhafaj - Dakord me ndryshimet dhe riformulimet.

Neni 154 “Statusi i inspektorëve”?

Vasilika Hysi - I vetmi sugjerim është që termi “relevanca” duhet shqipëruar, pra duhet zëvendësuar. Kjo vlen edhe për nenin 153, germa “c”. Nuk kam ndonjë sugjerim tjetër, por kam vetëm se çfarë do të vendosë Këshilli i Ministrave për pagat dhe për përfitimet e tjera.

Fatmir Xhafaj - Jemi te neni 154 “Statusi i inspektorëve”?

Vasilika Hysi – Pra, a do t'i përfitojnë inspektorët gjithçka që kanë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë? Zoti kryetar, mos e kaloni me lehtësi këtë gjë!

Fatmir Xhafaj - Ke shumë të drejtë! Nuk do ta kaloj me lehtësi, se nuk jam dakord më këtë gjë, që inspektorët të kenë pagën e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Po kryeinspektori pagën e kujt do të ketë?

Gent Ibrahim - Të kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Fatmir Xhafaj - Është shumë për inspektorin kjo pagë. Në rregull po ishte gjyqtari i Gjykatës së Apelit, por ...

Gent Ibrahim - Një nga llogaritë që kemi bërë në gjatë hartimit ka qenë edhe nevoja që këto pozicione të jenë interesante dhe atraktive për gjyqtarët.

Fatmir Xhafaj - Nuk është pak që një gjyqtar i Shkallës së Parë të marrë pagën e inspektorit, apo një gjyqtar i Apelit diku nëpër rrethe të marrë pagën e gjyqtarit të Apelit këtu.

Vasilika Hysi - Ka edhe përfitime.

Fatmir Xhafaj - Po, ka edhe përfitime.

Vasilika Hysi - Kryetar, këtu ka dy kategori inspektorësh: inspektorët magjistratë dhe inspektorët me magjistratë.

Kam një pyetje për zonjën Agnes edhe për zotin Ibrahim. Të dyja këto kategori do të bëjnë të njëjtën punë si inspektorë. Njërin do ta paguani me pagën e përcaktuar në ligjin "Për nëpunësin civil" dhe me strukturën e administratës publike, kurse për të njëjtën punë inspektori magjistrat do të marrë pagën dhe privilegjet që ka gjyqtari i Gjykatës së Lartë. A është diskriminuese kjo gjë në një marrëdhënie pune?

Gent Ibrahim - Në njëfarë mënyre po, por problemi kryesor është ai që përmenda pak më parë. Nuk do të jetë shumë e thjeshtë që gjyqtarët dhe prokurorët të pranojnë të bëhen inspektorë, në një kohë që ata janë shumë të dëshirueshëm nga këndvështrimi i nevojave të punës së institucionit. Kështu që ne duhet të gjejmë mënyra që ta bëjmë atraktiv këtë pozicion.

Nga ana tjetër, këto dy kategori njerëzish të gjithë jetën e tyre profesionale e kalojnë në korsi krejt të kundërta, që nuk takojnë kurrë me njëra-tjetrën. Kështu që nuk besoj se ky lloj diskriminimi, që ekziston objektivisht, do të jetë problem në punë e inspektoratit. Dikush që ndjek karrierën në administratën civile, do të bëjë karrierë edhe duke ardhur në inspektorat, sepse do të gëzojë statusin e nëpunësit civil të kategorisë së lartë drejtuese, kurse ai që do të vijë si gjyqtar do të gëzojë statusin e një gjyqtari të lartë, të Apelit tani, pas ndryshimit që bëtë ju. Të dyja palët janë të motivuara për të ardhur dhe për të shërbyer në inspektorat.

Vasilika Hysi - Pra, ata janë në të njëjtën zyrë, ndajnë të njëjtat përgjegjësi, kryejnë të njëjtën punë, të njëjtin volum, ndoshta edhe më shumë, por njëri ka vetëm pagën dhe jo në të njëjtin nivel me tjetrin, kurse tjetri ka edhe pagën edhe privilegjet.

Fatmir Xhafaj - Ai që është magjistrat, ka lënë magistraturën, pa diskutim që do të ketë privilegje shumë më të madha.

Agnes Bernhard - Faktikisht kjo u diskutua disa herë edhe me grupet e punës dhe patëm disa variante. Problemi me këtë zgjedhje është se keni grupe të ndryshme pagash. Gjithashtu, si parim nuk përjashtohet fakti që të kemi si inspektor dikë që vjen nga administrata publike, për shembull, për një gjykatës apo për avokat kjo mund të mos jetë atraktive dhe nuk kemi zgjidhje për ta.

Gjithashtu, mund ta konsiderojmë si zgjidhje alternative që për të gjitha ata të japim të njëjtin status, siç e keni aktualisht për njerëzit, të cilët nuk janë gjykatës të Gjykatës së Lartë, ata të gjithë do të kenë statusin e gjykatësit. Pra, mund të parashikojmë që të gjithë inspektorët të kenë të njëjtin status të inspektorit, i cili është statusi ekuivalent me një gjykatës për periudhën që ata operojnë si inspektorë. Kjo do të shmangte këtë problem diskriminimi, dhe, gjithashtu, do t'i jepte zgjidhje situatës ku një avokat funksionon si një inspektor. E dini që unë kam qenë në favor të statusit për inspektorët, sepse mendoj se njerëzit atje janë shumë të mirë për këtë pozicion.

Gjithashtu, do të ishte mirë që ky pozicion të tërhiqte njerëzit, dhe le të bëjmë këtu një selektim nga gjykatësit e besueshëm tek ata që nuk janë të besueshëm, nga prokurorët e besueshëm tek ata që nuk janë të besueshëm. Pra, t'u dhurojmë një status njerëzve për t'i tërhequr në sektorin e drejtësisë për atë pozicion.

Aktualisht në eksperiencën tuaj është shumë e vështirë që të kesh inspektorë të mirë dhe përgjigjen e dini më mirë e unë. Mendoj se me këtë ligj ne duhet të kujdesemi për një status të mirë dhe kushte të mira për pozicionin e inspektorit dhe të tërheqim njerëzit e duhur për inspektoratin.

Fatmir Xhafaj - Sa veta mund të jenë, në përgjithësi? A keni bërë një analizë për këtë gjë?

Gent Ibrahim – Përpara se t'i kthej përgjigje kësaj pyetjeje, duhet të kemi parasysh që inspektorët, të cilët nuk janë gjyqtarë, mund të shërbejnë aty gjithë jetën, mund të dalin në pension tek inspektorati, kurse ata që janë gjyqtarë, janë për 5 vjet.

Në lidhje me pyetjen tuaj, ne imagjinojmë që do të jenë burimet njerëzore, që, aktualisht, janë të shpërndara në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, në Ministrinë e Drejtësisë dhe në Prokurorinë e Përgjithshme.

Fatmir Xhafaj – Dua ta di si pozicione. Si numër, sa janë?

Gent Ibrahimi – Po, pra, si numër. Ata që, aktualisht, bëjnë inspektimin në këto institucione, me një shtesë të arsyeshme, ne mendojmë të jenë më shumë inspektorë nga ç'janë sot, pavarësisht se...

Fatmir Xhafaj – A mund të kemi një shifër, përafërsisht?

Gent Ibrahimi – Diku te 30 persona. Diçka si ILDKP-ja.

Fatmir Xhafaj – Me gjithë personelin?

Gent Ibrahimi – Jo, vetëm inspektorët.

Fatmir Xhafaj – Vetëm inspektorë, 30?

Gent Ibrahimi – Po.

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesja)* Duhet të kemi parasysh që inspektorati do të inspektojë gjykatës dhe prokurorë, pra kemi një mospërputhje me numrin aktual të inspektorëve. Për shembull, në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, aktualisht, janë 14 inspektorë, që inspektojnë vetëm gjykatësit, megjithatë këta bëjnë edhe vlerësimin e performancës, por vlerësimi i performancës nuk do të jetë pjesë e detyrave të inspektoratit në atë ardhmen, pra le të themi do të jetë përafërsisht 20-30 inspektorë në tërësi.

Fatmir Xhafaj – Pra, ideja është që të ketë edhe magjistratë që shërbejnë në to. Unë jam dakord, por që të jenë në rolin e shefave të zyrës, që të mos kenë të njëjtën gradë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur grupet e inspektorëve i drejton një magjistrat, kanë status tjetër. Jam dakord që të jetë i kufizuar numri i magjistratëve, pra nëse janë 30 inspektorë, 1 në 3 të jetë magjistrat, kurse pjesa tjetër le të jetë jashtë magjistraturës, pra të kemi një kombinim dhe ata të jenë, siç janë të gjithë nëpunësit e administratës, me një status të caktuar.

Agnes Bernhard - *(përkthen përkthyesja)* Atëherë, do të kemi një sistem hierarkik 2 nivelësh; do të keni më pak inspektorë me përgjegjësi të larta dhe do të keni asistentë inspektorët, që do të bëjnë pjesën tjetër të punës, në përgjithësi.

Fatmir Xhafaj – Gjithsesi, ta lëmë të hapur. Mund të rrijë edhe kështu, nuk kam ndonjë gjë.

Dakord.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, duhet të përcaktojmë...

Fatmir Xhafaj - Le ta lëmë gjenerike, në mënyrë që në praktikë e sipër të shikojmë si do të ecet.

Vasilika Hysi – Për mënyrën se si emërohen inspektorët, ky nen lidhet me nenin 155 dhe për secilin prej tyre ka rregulla të veçanta.

Fatmir Xhafaj – Patjetër, kështu do të jetë. Do të jenë dy nivele inspektorësh; do të ketë dy burime, një që do të vijë nga Shkolla e Magjistraturës dhe një që do të vijë nga shërbimi civil, i zakonshëm.

Dakord.

Neni 155.

Vasilika Hysi – Te neni 155, unë kam disa çështje thelbësore.

E para, titulli është “Emërimi i inspektorëve”. Në paragrafin e parë thuhet: “Inspektorët magjistratë komandohen”.

Fatmir Xhafaj – Një lloj emërimi është, si inspektor.

Vasilika Hysi – E dyta, thuhet: “...me të drejtë riemërimi vetëm një herë”, atëherë ose do të themi: “emërohen në këtë detyrë”, pra ta unifikojmë, sepse unë di që komandimi dhe emërimi nuk janë e njëjta gjë. E para.

Fatmir Xhafaj – Ai komandohet. Ideja është që merret nga radhët e magjistratëve dhe emërohet këtu, pra emërimi si inspektor. Kjo është logjika, kush vjen si inspektor.

Vasilika Hysi – Do të jetë me vendim komandim apo me vendim emërim, sepse kemi vendime të ndryshme?

Gent Ibrahim – Me komandim do të jetë, sepse ata janë gjyqtarë në detyrë ose prokurorë në detyrë dhe këshilli përkatës i komandon për 5 vjet.

Vasilika Hysi – Atëherë, kemi të drejtën të themi edhe të dytën, për ta komanduar edhe një herë, sepse kur flasim te ligji “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit”, komandimi është “jo më shumë se 10 vjet”, apo jo zonja Agnes? Pra, nuk mund të komandohet më shumë se 10 vjet.

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesja)* Këtë e kemi parashikuar për një periudhë 10-vjeçare. Është e vërtetë.

Vasilika Hysi – Dua të pyes për paragrafin e dytë.

Thuhet: “Inspektorët emëron nga inspektori i lartë jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Inspektorati miraton ...”

Fatmir Xhafaj – Po, këtë e lexojmë të gjithë. Cila është pyetja?

Vasilika Hysi – Pyetja është: ky inspektorat, i pakaluar në procesin e vetingut të vlerësimit, a mund të vendosë rregulla dhe të fillojë procedurat e konkurimit?

Fatmir Xhafaj – E para, nga emërimi i inspektorit, sepse për tre muaj ligji mund të hyjë dhe nuk është emëruar vetë inspektori. Mund të duhen tre muaj të bëhet procedura e tij; hyn ligji në fuqi, që të bëhet procedura e tij; emërohet ai dhe pastaj nxjerr rregullat e të gjitha këto.

Gent Ibrahim – Madje, unë nuk po kujtoj pse është kjo zgjidhje dhe të mos jetë ajo zgjidhja standarde e zbatimit të ligjit të shërbimit civil, që inspektorët e tjerë emërohen sipas ligjit “Për shërbimin civil”. Kuptohet, kjo bëhet pasi emërohet inspektori.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Të rishikohet dhe të ripunohet edhe një herë neni 155.

Neni 156: “Vlerësimi i performancës së inspektorëve”.

Dakord, me ndryshimet e bëra?

Vasilika Hysi – Jo, përsëri këtu ka disa elemente interesante.

Këtu thuhet: “...jo më vonë se tre muaj nga hyrja në fuqi e ligjit, inspektori miraton sistemin e vlerësimit të performancës.”

Fatmir Xhafaj – E thamë që do ta shikojnë jo nga hyrja në fuqi, por 3 muaj pasi ai të jetë në detyrë, duhet ta bëjë këtë gjë. Janë 2 muaj.

Vasilika Hysi – Do ta bëjë inspektori...

Fatmir Xhafaj - ... i ri që vjen.

Vasilika Hysi – Nuk thuhet kështu. Edhe dispozitat kalimtare nuk është lënë ashtu.

Fatmir Xhafaj – Më fal, të lutem! Thuhet: “... jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi, inspektori miraton sistemin”, pra inspektori i ri që zgjidhet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka mundësi të jetë ashtu. Do të miratohet inspektori, ai që fillon detyrën. Kjo është e padiskutueshme. Edhe në qoftë se nuk është kështu, do të bëhet kështu.

Gent Ibrahim – Ka një dispozitë që llogarit momentin e fillimit, pra cili është momenti i fillimit të institucionit dhe lidhet me një...

Fatmir Xhafaj – Momenti i fillimit është kur ai emërohet; del emërimi nga Kuvendi, që është emërimi final dhe brenda tre muajve nga dita që emërohet, ky person duhet të bëjë 1, 2, 3, 4, 5 gjëra, dy muaj, tre muaj, dikë një muaj, sipas afatit, por do t’i bëjë ai që merr detyrën, nuk do t’i gjejë në tavolinë gati, sepse kemi një qasje të re për këtë gjë.

Dakord me ndryshimin.

Neni 157: “Shkeljet disiplinore”.

Jeni dakord me ndryshimet e paraqitura?

Vasilika Hysi – Ju lutem, në paragrafin e tretë ka diçka. Thuhet: “Vendimet merren nga një komision disiplinor i përbërë nga ...”

Gent Ibrahim – Po, ju kërkoj ndjesë, ka një plotësim të atij boshllëku. Plotësimi është që, duke pasur objektivin për ta ndarë vlerësimin e performancës së inspektorëve, për të mos ia lënë kompetencë ekskluzive inspektorit të lartë, kemi formuluar si më poshtë:

“Veprimtaria profesionale vlerësohet nga një komision i posaçëm me tre anëtarë, i zgjedhur me short midis të gjithë trupës së inspektorëve”.

Vasilika Hysi – Zoti Ibrahim, këtu flitet për shkelje disiplinore.

Jemi te neni 157.

Gent Ibrahim – Më fal, mendova mos ishim te neni 156, sepse edhe aty ...

Vasilika Hysi – Po, edhe neni 156 ka të njëjtin problem, prandaj nuk duhen kaluar shpejt.

Në paragrafin e parë nuk thuhet se nga kush përbëhet komisioni i posaçëm, as këtu.

Gent Ibrahim – Atëherë, po jua lexoj në rast se e gjeni me vend. Pra, ideja është që të krijohet një komision i posaçëm me tre anëtarë, të cilët zgjidhen me short nga trupa e inspektorëve. Këta bëjnë vlerësimin e inspektorëve të tjerë.

Vasilika Hysi – Do të themi: “nga trupa e inspektorëve” apo “nga radhët e inspektorëve”?

Gent Ibrahim – “Nga radhët”, dakord.

Vasilika Hysi – Nga radhët e inspektorëve magjistratë apo jo magjistratë, apo të gjithë së bashku?

Gent Ibrahim – Të gjithë së bashku.

Thuhet, gjithashtu: “Komisioni i posaçëm i vlerësimit”, pra ky komisioni me tre anëtarë “zgjidhet brenda muajit janar të çdo viti dhe qëndron në detyrë për një vit”

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, a mund ta sjellë zoti Ibrahim të riformuluar nenin 157, për të plotësuar edhe terminologjinë për ligjin?

Gent Ibrahim – Po. Janë dy boshllëqe, që, ndërkohë unë i kam plotësuar, por ..

Vasilika Hysi – Nenet 156 dhe 157 kanë nevojë për t’u plotësuar me idenë se si do të jenë komisionet.

Fatmir Xhafaj – A jeni dakord?

Gent Ibrahim – Po, ne e kemi gati.

Fatmir Xhafaj - Pra, dakord.

Neni 158: “Detyrat e inspektorëve”.

Vasilika Hysi - Te neni 158 kam një pyetje për paragrafin e pestë.

Në radhë të parë, po e filloj me paragrafin e dytë, që duhet plotësuar: në cilin nen duhet vënë referenca?

Gent Ibrahim – Është neni 138.

Vasilika Hysi – I ligjit aktualit apo...

Gent Ibrahim - Po, i aktualit.

Vasilika Hysi – Në rregull.

Gjithashtu, te paragrafi 5 thuhet: “Çdo person fizik ose juridik, ose institucion publik të japë akses në përputhje me pikën 2 të këtij neni”. Në pikën 2 të këtij neni nuk flitet për akses, por flitet për verifikimet që bëjnë inspektorët. Mos është në pikën 3? Po ashtu, germa “c” e nenit 5 të jetë: “Referenca të respektojë kërkesat e pikës 4”.

Gent Ibrahim – Ju jeni te paragrafi i 5-të: “çdo person fizik ose juridik ose institucion publik është i detyruar që ...

Vasilika Hysi – të japë akses në përputhje me pikën 2 të këtij neni”.

Referencat i kam edhe te germa “b” dhe te germa “c” e paragrafit të 5-të, të cilat i referohen respektivisht pikës 2 dhe pikës 3 të po këtij neni.

Gent Ibrahim –Po, duhet të jetë pika 3.

Vasilika Hysi – A mund ta shikoni me qetësi, sepse është përgjegjësi shumë e madhe.

Kam një pyetje, zoti kryetar, edhe për ju.

Në dijeni tuaj, sot inspektori mund të hyjë në ambiente, të kontrollojë, të marrë dokumentet, t’i shumëfishojë, të marrë çdolloj dokumenti?

Gent Ibrahim – Në ushtrimin e veprimtarisë së inspektimit të gjyqtarit, të prokurorit, por qoftë edhe të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në rast se inspektori privohet nga mundësia për të marrë kopje të dokumenteve, inspektimi, thjesht nuk mund të bëhet, kështu që ky dallohet nga koncepti i sekuestrimit që mund të bëjë prokurori, por, gjithsesi është një mundësi që i duhet dhënë.

Vasilika Hysi – Atëherë, do të bëhen dy saktësimet për germat “b” dhe “c”.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Tani, lidhur me sistemin e menaxhimit të çështjeve, në ligj ne kemi kërkuar, zoti kryetar, sistem të menaxhimit të çështjeve në gjykata, në KLGJ, ndërsa këtu ia kemi lënë inspektorit krijimin e administrimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve. Inspektori nuk mund të bëjë vetë një sistem të menaxhimit. Ne kemi përcaktuar rregulla shumë të detajuara. Për transparencë...

Fatmir Xhafaj – Për çfarë çështje? Nuk është fjala për çështjet gjyqësore, por për çështjet që ...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Do të ketë një sistem ai: si do t’i inspektojë, me short, në mënyrë të rastësishme që ai të mos vendosë inspektimin...

Vasilika Hysi – Jam dakord me ju, kështu siç po e thoni, por po ta lexoni paragrafin e parë, është inspektori si individ, që krijon dhe administron sistemin, pa short, pa gjë.

Unë jam dakord me këto që po thoni me fjalë.

Fatmir Xhafaj – Përveç inspektorit, kush mund ta krijojë sistemin?

Gent Ibrahimi – Ju e keni fjalën për caktimin e inspektorëve në detyrë?

Fatmir Xhafaj – Jo, jo. Ju thoni: “sistem i menaxhimit të çështjeve”, çfarë kuptoni ju vetë me këtë.

Gent Ibrahimi – Forma e dosjes, informacioni që duhet të hyjë në dosje, gjëra të kësaj natyre.

Fatmir Xhafaj – Jo, kjo pastaj është gjë tjetër. Kjo duhet ndryshuar, sepse ky nuk është sistem menaxhimi. Ky është dokumentacion, sistemi i dokumentacionit e të tjera. Logjika është që ky do të vendoset të inspektojë; ka inspektime tematike, ka inspektime periodike që bëhen. Te inspektimet periodike, ky duhet të ndërtojë një sistem jo sipas bindjes së tij të brendshme, por duhet të inspektojë edhe sipas një rastësie. Për shembull, sot inspektohet ILDKPI-ja për një inspektim të përgjithshëm të dosjeve të zyrtarëve, por bën edhe një inspektim të thelluar dhe hedh shortin. Në qoftë se ne jemi 140 deputetë, 20 deputetëve një herë në vit, u bie një inspektim i thelluar; mund të të bjerë që përjashtohesh pastaj në 5 vjet dhe nuk të bie më kjo derisa të kalojnë të gjithë në një inspektim të thelluar. Ideja është që ai duhet të ketë inspektim tematik dhe inspektim...

Gent Ibrahimi – Jo, këtu kemi një ide tjetër. Këtu bëhet fjalë për mënyrën e organizimit të dosjes, qarkullimin e saj e kështu me radhë.

Fatmir Xhafaj – E kuptova. A mund t’i parashikojmë të dyja?

Gent Ibrahimi – Po, them se po.

Fatmir Xhafaj – A mund të ketë ai me të dy këshillat një lloj mirëkuptimi, sepse janë edhe këshillat, pra mund t’i kërkohen nga këshillat inspektime tematike, sepse u dalin probleme atyre.

Gent Ibrahimi – Kjo është rregulluar, sepse më lart thuhet: “... për inspektime tematike ai vihet në lëvizje me kërkesë të këshillit, të ministrit ose sipas programit të vet”, pra ka program vjetor inspektimesh.

Fatmir Xhafaj – Zgjidhim këtë çështjen tjetër: si inspekton ai? Për shembull, po të jap një rast: ka 25 vjet Apeli i Tiranës dhe është inspektuar vetëm një herë në vitin 2004, për kohëzgjatje, për fat të keq, kam qenë unë në atë kohë ministri i Drejtësisë. Ky ka qenë i vetmi “fat i keq” imi. Pra, në historinë e tij është inspektuar vetëm një herë, inspektim i përgjithshëm i Apelit, pastaj të gjitha inspektimet shkojnë në Laç, më e bukura është se tre

herë kanë shkuar në Përmet; dy gjyqtarë janë në Përmet, në Sarandë kanë shkuar nja dhjetë herë, sepse ka det, në Vlorë, në Durrës, të gjitha inspektimet tematike bëhen në linjën bregdetare. Ne e hapim me kujdes linjën e inspektimeve dhe shikoni në 25 vjet të Apelit, prandaj duhet të ketë një lloj sistemi që e bën publike e të tjera, kur inspekton. Nuk e di nëse jam i qartë në këtë që po kërkoj.

Gent Ibrahimi – Kam përshtypjen se po flasim për dy koncepte të ndryshme.

Fatmir Xhafaj – U kuptuam që flasim për dy koncepte të ndryshme, por për këtë konceptin tjetër, a është zonja Bernhard dakord, që të mos ia lëmë dëshirës së tij personale, subjektive?

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesja)* Unë mendoj se duhet të ketë një plan inspektimi vjetor, me pika objektive, të detajuara për qëllimin e inspektimit për çdo vit, për të garantuar që të gjitha gjykatat dhe prokuroritë do të inspektohen rregullisht dhe, së dyti ato, ku ka konflikte ose ku ka gjëra të çuditshme, të dyshimta që po ndodhin aty, do të inspektohen posaçërisht për së dyti, deri në detaje.

Gent Ibrahimi – Kemi thënë që inspekton në bazë të informacioneve, në bazë të kërkesave...

Fatmir Xhafaj – Jo, kjo është tjetër gjë, por ai ushtron detyrën; zëre se nuk i ka ardhur asnjë ankesë, çfarë do të bëjë ai? Do të bëjë inspektime periodike. Po të ketë një gjë që ta bëjë publik, ta paraqesë, në mënyrë që kur të vijë ai të raportojë në Kuvend, të pyetet: kush është plani yt i inspektimit në këto vjet? Si e ke ndërtuar, mbi çfarë kriteresh e të tjera?

Pra, neni 160 do të ripunohet dhe do të shihet mundësia nëse mund të bëjmë diçka për këtë që folëm.

Neni 161: “Këshilli i emërimeve në drejtësi”.

Vasilika Hysi – Pjesa e parë shpjegon se çfarë përcakton kreu.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Faleminderit!

Dakord me nenin 161.

Neni 162, dakord?

Vasilika Hysi – Po.

Neni 163.

Vasilika Hysi – Këtu kam një sugjerim.

Mendoj që këtu kemi përzier 3 probleme: selinë, kohën e takimeve dhe mbështetjen administrative.

Në nenin 170 ne e përcaktojmë se sa herë mblidhet Këshilli i Emërimeve. Kështu që unë sugjeroj që te Këshilli i Emërimeve duhet të hiqet paragrafi i parë se kur mblidhet, sepse

e kemi thënë në nenin 170 dhe të themi se ku e ka selinë dhe detyrimin që ka Gjykata Kushtetuese.

Fatmir Xhafaj – Mund të mos i vini këto. Të thuhet: “Organizimi i mbledhjeve të këshillit.” dhe kaq.

Dakord. Miratohet edhe ky ndryshim.

Neni 164.

Vasilika Hysi – Te neni 164 kam disa pyetje parimore për çdo paragraf.

Marrim paragrafin e parë, ku thuhet “Këshilli i Emërimeve përbëhet nga dy gjyqtarë e të tjerë” dhe në germën “P” thoni: “...një gjyqtar nga Gjykata Administrative e çdo niveli” nga Shkalla e Parë dhe nga Gjykata e Apelit apo do të ndiqet ajo praktikë që ...

Fatmir Xhafaj – Kam përshtypjen se Kushtetuta e ka nga Apeli.

Gent Ibrahimi – Nga të dyja shkallët. Normalisht për sa kohë që nuk është specifikuar...

Fatmir Xhafaj – Në Kushtetutë si është?

Gent Ibrahimi – Në Kushtetutë thuhet: “9 anëtarë të përzgjedhur me short nga radhët e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”. Kaq.

Vasilika Hysi – Në fakt, ne kemi pasur në Kushtetutë dhe sugjerimi ynë ishte ta hiqnim dhe ta vinim në ligj. Por me sa mbaj mend te pjesa e përgatitur...

Fatmir Xhafaj – Të lutem, a ke gjë për faktin që të jenë 2 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese? Jo. Faleminderit!

Një gjyqtar i Gjykatës së Lartë, dakord; një prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme, dakord, 2 gjyqtarë nga gjykatat e Apelit dhe kur themi nga Gjykata e Apelit mund të fusim edhe nga Gjykata Administrative; 2 prokurorë nga zyrat e prokurorisë pranë gjykatave të Apelit dhe një gjyqtar nga gjykatat administrative, pra 9 veta janë gjithsej?

Vasilika Hysi – Në germën “d” të nenin 149 të ndryshimeve kushtetuese nuk përmendet se nga duhet të jenë.

Fatmir Xhafaj – Nuk ka rëndësi tani.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, tani ...

(Diskutime pa mikrofon)

Gent Ibrahimi - Thuhet më poshtë që Presidenti i Republikës përzgjedh me short 2 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, 1 gjyqtar të Gjykatës së Lartë, 1 prokuror nga Prokuroria e Përgjithshme dhe 2 gjyqtarë dhe 2 prokurorë pranë gjykatave të apelit dhe 1 gjyqtar nga Gjykata Administrative.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Jo, është e përcaktuar plotësisht në Kushtetutë, kështu që këtu është vetëm replikimi i asaj,

Fatmir Xhafaj – Pra, një gjyqtar nga Gjykata Administrative dhe mbyllet këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka tre shkallë, dy shkallë ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, pra ai është seksion. Është e përcaktuar. Çfarë po pyet tani: gjykata dhe seksioni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord me ndryshimet e propozuara nga relatorja.

Vasilika Hysi – Jo, unë kam edhe një sugjerim në pikën 2 dhe e kam në përgjithësi edhe për Kushtetutën, duke kalkuluar të gjitha afatet, ju thoni: “Presidenti zgjedh anëtarin e këshillit me short nga data 1 deri në datën 4 dhjetor, po sikur data 1 dhe 2 të jenë e shtunë e diel? Po nëse 30 nëntori i bie festë, shtyhet, a nuk do të ishte më mirë në javën e parë të dhjetorit ose javën e parë të... ”

Fatmir Xhafaj – Më fal, si është në Kushtetutë?

Vasilika Hysi – Sapo e thashë që e kam edhe për Kushtetutën.

Po në rast se i bie ditë e diel, do të bëhet short ditë të diele.

Fatmir Xhafaj – Po nuk ka katër ditë të diela.

Vasilika Hysi – Midis datës 1 dhe 4, pra është data 2 dhe 3.

Fatmir Xhafaj – A është në Kushtetutë?

Gent Ibrahimi – Po është.

Fatmir Xhafaj – Dakord, do ta vini siç është në Kushtetutë.

Po ndryshuam tani Kushtetutën, mund ta ndryshoni.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, unë ta them...

Fatmir Xhafaj – Nuk mund të ndryshojë ligji Kushtetutën.

Vasilika Hysi – Nuk e ndryshoj Kushtetutën, por po them shqetësimet e mia për të gjitha nenet, sepse unë mora me laps dhe me matematikë dhe më del që ky proces nuk bëhet, nuk arrin dot të bëhet për shkak të detyrave që ka.

E para, thuhet: “Presidenti zgjedh anëtarët e këshillit me short nga data 1 deri në datën 4”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga data 1 deri në datë 4 e ke në ligj. Nëse Presidenti nuk arrin ta zgjedhë anëtarin e këshillit deri në datën 5, atëherë, thoni ju, e zgjedh Kryetari i Kuvendit brenda datës 10.

Tani, që të mos thotë njeri: më mori kompetencën Presidenti, Kryetari i Kuvendit, është mirë që këto të saktësohen, 4-ta 5-sa, sepse do të hyjmë pastaj te ora 12 e natës, jo e shtuna, jo e diela. E para.

E dyta, në paragrafin 4, ju keni thënë: “Institucionet e ngarkuara me përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi miratojnë rregullat e procedurës e të tjera dhe këto rezultate i bëjnë transparente”. A mundet që kaq shumë institucione për 4 ditë të bëjnë dosje, verifikimin, të bëjnë korrespondencën me Presidentin, më pas me Kryetarin e Kuvendit për 4 ditë? E kuptoni sa shumë hallka ka, po të bëjmë një listim se sa shumë gjëra do të bëhen?

Gent Ibrahimi – Kushti i vetëm është që këta të mos kenë masë disiplinore në fuqi. Në kaq konsiston puna verifikuese e Presidentit. Është një informacion që do ta kërkojë nga këshillat, do t’ia vërë në dispozicion që në muajin dhjetor, që në muajin paraardhës. Në nëntor kërkon informacionin se cilët nga gjyqtarët nuk kanë masa disiplinore, ata i fut që të gjithë në short dhe kështu i del llogaria.

Vasilika Hysi - ... Tjetër atëherë, sepse e lidh me dispozitat kalimtare.

Shorti do të hidhet midis të gjithë anëtarëve?

Gent Ibrahimi – Për të gjithë gjyqtarët mbi të cilët nuk ka një masë disiplinore në fuqi.

Vasilika Hysi – Pra, ata do të jenë...

Gent Ibrahimi – Po, mund të jenë 300.

Vasilika Hysi – Të gjithë personat që nuk kanë ndalesa, do të shkojnë te Presidenti?

Fatmir Xhafaj – Si do të shkojnë aty, në sallë, fizikisht?

Vasilika Hysi – Jo, emrat, shorti, pra goglat.

Gent Ibrahimi – Pa dyshim që kjo nuk ishte zgjidhja ideale, por kjo është një zgjidhje e imponuar, faktikisht, sepse ju e mbani mend që fillimisht kjo ka qenë me pozicion zyrtar.

(Diskutime pa mikrofon)

Agnes Bernhard - *(përkthen përkthyesja)* Më falni, dua t’ju tërheq vëmendjen, gjithashtu, për germën “d” të paragrafit 5, që do të lejonte shtimin e kritereve për kufizimin, numrin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët mund të zgjidhen për Këshillin e Emërimeve, sepse Kushtetuta thotë që kushtet e tjera për kualifikimin rregullohen nga ligji, pra ne mund të shtojmë në ligj kritere të tjera, përveç masave disiplinore që janë në fuqi.

Fatmir Xhafaj – A mund ta rishikoni nenin 165 në frymën e ndërhyrjes së zonjës Agnes?

Dakord për nenin 165, për t'u rishkruar në këtë koncept, për të reflektuar hapësirën që i lejon Kushtetuta.

Neni 166: "Organizimi i shortit për zgjedhjen e anëtarit zëvendësues".

Vasilika Hysi – Kemi bërë një riformulim të paragrafit të parë nga teknika legjislativë.

Fatmir Xhafaj – Dakord me rregullimin.

Neni 167: "Organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi".

Vasilika Hysi – Është përsëri riformulimi nga pikëpamja e teknikës legjislativë.

Fatmir Xhafaj - Dakord me riformulimin.

Neni 168: "Zëvendëskryetari".

Vasilika Hysi – Unë nuk kam gjë.

Të keni parasysh se si kryetari dhe nënkryetari vijnë nga Gjykata Kushtetuese 2.

Fatmir xhafaj – Pas vetingut do të vijë.

Vasilika Hysi – Jo, sepse nuk ka veting për këtë, fillojmë menjëherë.

Pra, "Anëtari më i vjetër në moshë, midis dy anëtarëve të zgjedhur nga Gjykata Kushtetuese bëhet kryetar, zëvendës do të jetë anëtari tjetër i Gjykatës Kushtetuese".

Gent Ibrahim – Logjika këtu është që ai bëhet kryetar për shkak të cilësive të tij zyrtare.

Fatmir Xhafaj – Mirë, dakord, por jo më i vjetri në moshë. Më i vjetri në detyrë, sepse më i vjetri në moshë mund të ketë 1 vit punë në Gjykatën Kushtetuese.

Gent Ibrahim – Kjo është për të evituar situatën kur janë të dy me të njëjtën eksperiencë.

Fatmir Xhafaj – Me të njëjtin dekret?

Gent Ibrahim – Po.

Fatmir Xhafaj – Do të merret numri i dekretit, a i që ka dekretin me numër të parë, do të merret ai. A mund ta marrim tjetrin nga Gjykata e Lartë?

Gent Ibrahim – Sidoqoftë, në një mbledhje ku është i ulur edhe një anëtar i Gjykatës Kushtetuese dhe një anëtar i Gjykatës së Lartë, protokollarisht nuk do të bënte sens që mbledhja të drejtohej nga Kryetari i Gjykatës së Lartë, për sa kohë në atë dhomë është anëtari i Gjykatës Kushtetuese.

Fatmir Xhafaj – Dakord, por kemi..

Vasilika Hysi – Por, po Gjykata Kushtetuese do të merret me shqyrtimin e ankimeve. Po t'i bëjmë një listë Gjykatës Kushtetuese, i kemi shtuar kaq shumë

kompetenca te rivlerësimi, tek ankimi i masave disiplinore; kemi hequr tribunalin. Unë u përpoqa dhe të bëja një listë supergjykatës, të njëjtët persona do të vendosnin për gjithçka.

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesja)* Në fakt, drafti ishte për Gjykatën e Lartë.

Fatmir Xhafaj – Anëtari i Gjykatës së Lartë të jetë edhe zëvendëskryetar, që të jetë kryetari nga Gjykata Kushtetuese më i vjetri në detyrë dhe anëtari i Gjykatës së Lartë të jetë zëvendëskryetar.

Vasilika Hysi – Kjo bie ndesh me Kushtetutën. Ne kemi thënë kryetari i Këshillit të Emërimeve është anëtari i Gjykatës së Lartë. Gjykata e Lartë krijon kushtet, pra nuk është Gjykata Kushtetuese në Kushtetutë.

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesja)* Është Gjykata e Lartë.

Gent Ibrahimi – Kushtetutën. Kjo është...

Fatmir Xhafaj – Po, patjetër. Po, pse e keni bërë këtë?

Gent Ibrahimi – Nuk e mbaj mend.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

U lodhe edhe ti.

Neni 169, dakord.

Neni 167 dhe neni 168 në frymën e Kushtetutës.

Neni 169 “Relatori”.

Vasilika Hysi – Lidhur me relatorin do të doja tri saktësime: “rekorde penale”, kam idenë se ju doni të dhëna për gjendjen gjyqësore.

Projektakti i verifikimit do të jetë vendim, nuk e di, dhe akti i verifikimit. Pra, duhet t’i saktësojmë, sepse është dokument shumë i rëndësishëm për vlerësimin që i bëhet kandidatëve dhe duhet të jenë me shkresa, me procesverbale apo si e keni menduar?

Gent Ibrahimi – Ky është një dokument zyrtar që përcaktohet për herë të parë në këtë ligj: krijohet një organ i ri, i cili ka për detyrë të bëjë verifikimin dhe renditjen e kandidatëve, do t’i vëmë një emër aktit që lëshon ai. Kemi zgjedhur këtë emër. Mund t’i kthehemi edhe emërtimit gjenerik dhe ndihmës, nuk ka asnjë problem: përgatitjen e projektvendimit. Si të dëshironi. Ne këtu po ia vëmë emrin këtij akti, ose akti i verifikimit dhe i ...

Fatmir Xhafaj – Akt verifikimi, pastaj le t’i vënë një emër ata.

Gent Ibrahimi – Ose vendim.

Fatmir Xhafaj – Po çfarë rëndësie ka kjo?

Dakord për nenin 169, me këto ndryshime.

Neni 170.

Vasilika Hysi – Kam disa diskutime.

Marrim paragrafin e parë.

“Këshilli i Emërimeve në drejtësi mblidhet sa herë që është e nevojshme”, mendoj të jetë këtu dhe ta hiqim nga neni 163, ku ishte.

Gent Ibrahimi – Po, e bëmë.

Vasilika Hysi – Por mendoj të jetë në fund të kësaj fjalie.

Sugjeroj që legjislacionin “Për organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale dhe enteve publike” ta saktësojmë, sepse është përmendur edhe ligj i enteve publike.

Kam një pyetje për paragrafin e dytë.

Kur ju thoni: “Këshilli i Emërimeve bën verifikimin e të shkuarës profesionale”, çfarë do të thotë “e shkuar profesionale”; është përvoja, vlerësimet, sepse kjo mund të sjellë debate.

Gjithashtu, pika 3 ...

Gent Ibrahimi – Është ajo *background check* e famshme.

Vasilika Hysi – Në anglisht nuk mund të ...

Gent Ibrahimi – Por që nuk është profesionale.

Vasilika Hysi - Po, edhe në paragrafin e tretë unë nuk e di çfarë keni dashur të thoni për verifikimin e meritave.

Gent Ibrahimi – Për këtë, kemi një formulim të ri, sepse neni aty është me disa fjalë në anglisht, prandaj kemi një formulim të ri gati.

Fatmir Xhafaj – A mund të bëjmë një riformulim për nenin 170? Dakord.

Neni 171: “Personeli administrativ”

Vasilika Hysi – Kam një pyetje për paragrafin e dytë. Ju thoni se një numër i arsyeshëm punonjësish administrativë, këtu keni parasysh edhe nëpunësit civilë, ata që janë me status të nëpunësit civil, edhe ata që janë me Kod Pune?

Gent Ibrahimi - Nuk është fjala për nëpunës, por për punonjës të Gjykatës së Lartë.

Vasilika Hysi – Po, pra. Këta punonjës do të kryejnë dy funksione ndërkohë, kur të mblidhet ky *ad hoc* që do të punojë, do të kryejë edhe funksionet e veta. Tani, kjo është kategori e nëpunësve civilë, kur thua “punonjës administrativë” apo do të kihet parasysh edhe stafi i shërbimeve mbështetëse?

Gent Ibrahimi - Stafi i Gjykatës së Lartë përbëhet nga nëpunës civilë gjyqësorë.

Vasilika Hysi – Por ka edhe ndihmësmagjistrat në bazë të ligjit.

Gent Ibrahimi – Njëri nga ata do të caktohet të merret. Ky është një term gjenerik që përdoret. Nuk besoj se është vendi për ta specifikuar si nëpunës gjyqësor apo ndihmësmagjistrat.

Vasilika Hysi – Por “punonjës administrativ”, nuk themi.

Gent Ibrahimi – Personel administrativ.

Kryetari i Këshillit që është Kryetari i Gjykatës së Lartë cakton një nga punonjësit e Gjykatës së Lartë ose disa, që të ndihmojnë në punën e Këshillit të Emërimeve.

Vasilika Hysi – Si mendoni, zoti kryetar?

Fatmir Xhafaj – Kjo mund të zgjidhet thjeshtë: “Sekretari i Përgjithshëm ngarkohet me këtë detyrë, ai i këshillit gjyqësor, pra sekretari i Përgjithshëm me stafin e vet të bëjnë detyrën”.

Gent Ibrahimi – Faktikisht, këtu po flasim për ..

Vasilika Hysi – Kemi thënë “personelin administrativ” më lartë, në rreshtin e parë.

Ta riformulojmë?

Fatmir Xhafaj – Këshilli i Emërimeve në drejtësi miraton rregulloren për administrimin e brendshëm të tij.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“Kryetari i këshillit cakton nga radhët e personelit”. Fshihet e gjitha kjo dhe i thuhet: “Shërbimet në funksion të kësaj kryhen sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Gjyqësor me ekipin e tij” dhe mbyllet, as staf, asgjë; një herë që do të mblidhet, dashka edhe staf!? Sekretari i Përgjithshëm merret me këtë punë.

Gent Ibrahimi – Duke qenë se selinë do t’ia lëmë te Gjykata e Lartë, ndoshta duhet t’ia lëmë edhe këtë përgjegjësinë për të ...

Fatmir Xhafaj – “Kancelari i Gjykatës së Lartë me stafin” dhe mbyllet. Çfarë do të bëjnë ata? Ata do të bëjnë punë administrative; do të mbledhin dosjet, do të mbledhin zarfet, do të mbledhin këto e ato. Mos ta ngarkojmë më shumë. Tani, të bëjë personel administrativ ai, që do të mblidhet një herë në vit.

Gent Ibrahimi – Pra , ta lëmë: “Kancelari i Gjykatës së Lartë”, atëherë.

Fatmir Xhafaj – Po, pra, “kancelari me stafin përkatës”.

Neni 172: “Regjistri zyrtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”

Vasilika Hysi – Kam një pyetje lidhur me germën “d”, ku thuhet: “Dokumentacioni i ardhur nga agjencitë shtetërore”. Është fjala për nga institucionet shtetërore që...?

E dyta, kur thoni: “Duhet të ruhet letërkëmbimi zyrtar, mes tyre edhe këshillit”, fjalën e keni të kandidatëve dhe të institucioneve, apo të dyve së bashku?

Gent Ibrahim – Midis këtyre institucioneve dhe këshillit.

Vasilika Hysi – Atëherë, mes institucioneve, sepse ...

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 172, me ndryshimet e bëra.

Vasilika Hysi – Po aktet përfundimtare? Kemi shtuar vetëm fjalët “renditja e kandidatëve për të saktësuar...

Fatmir Xhafaj – Po, sipas kësaj që është korrigjuar këtu.

Neni 173.

Vasilika Hysi – Po, kjo është.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 174.

Vasilika Hysi – Kam të njëjtin shqetësim si te inspektori ...

Fatmir Xhafaj - ...hiqeni nga rregullorja këtë.

Gent Ibrahim – Është thjesht dosje. Çfarë ka dosja brenda.

Fatmir Xhafaj – Te personeli administrativ, rregullore ku parashikohet kjo, kjo...

Gent Ibrahim – Dakord.

Fatmir Xhafaj – 174 shkrihet dhe shkon te neni 171.

Neni 175. Dakord. Vlerësimi i kushteve ligjore dhe renditja e kandidatëve, kapitulli 4.

Neni 176. Subjektet që vënë në lëvizje këshillin e emërimeve.

Vasilika Hysi – Lidhur me listën e plotë të kandidatëve që i dërgon këshillit të emërimeve duhet ta qartësojmë saktë. Cilën listë do të çojmë? Sepse në qoftë se ju kujtohet gjithë diskutimet e ligjit tani fillojnë referencat me nenet e tjera. Sa do të çojmë? Aq sa kërkon Kushtetuta?

Gent Ibrahim – Jo, çdo rast është i ndryshëm këtu.

Vasilika Hysi - E di që është i ndryshëm, por do të çojmë aq kandidatë sa përcakton Kushtetuta? Për shembull në rast se një institucion do të çojë vetëm 5 kandidatë, edhe këshilli i emërimeve do të bëjë vetëm renditjen e atyre dhe nuk merr asnjë kandidatë më poshtë?

Gent Ibrahim – Paragrafi i parë nuk e ka këtë problem.

Paragrafi i parë te ligji “Për Gjykatën Kushtetuese”, thuhet që Presidenti shpall listën e kandidatëve dhe të gjithë listën ia çon...

Vasilika Hysi – Të gjithë listën, pa përjashtim.

Në paragrafin 8 kam idenë se këtu duhet të bëjmë referencë në ligj, kur thuhet dokumentet e parashikuara në kreun... Dhe e fundit në paragrafin 9 duhet bërë përsëri referencë në ligj.

Fatmir Xhafaj – Dakord me këto ndryshime.

Neni 177.

Vasilika Hysi – Ju keni thënë këtu që do të dorëzohen dokumentet menjëherë pas dërgimit të listës së emrave, këshilli i pajis me formularë të deklarimit.

Fatmir Xhafaj – Hiqeni këtë në faqen zyrtare të Gjykatës Kushtetuese. Do t’i kaloni të gjitha te Gjykata e Lartë.

Gent Ibrahimi – Po.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Vasilika Hysi – Duhet kontrolluar kjo në fund.

Fatmir Xhafaj – Po, sigurisht.

Vasilika Hysi – Kam një pyetje për paragrafin 3. ILKDPI-ja, inspektori dërgon vetëm rezultatet e kontrollit apo jep edhe opinionin e tij pozitiv ose negativ?

Gent Ibrahimi – Ai bën verifikimin e pasurisë. Mund të thotë që pasuria është e justifikuar, që ka dyshime. Kjo mund të interpretohet.

Besoj se në këtë rast nuk është vendi për ta zgjeruar më shumë, sepse inspektorati do të veprojë në bazë të ligjit të tij dhe siç e udhëzon ligji i tij të veprojë kur bën verifikimin e deklaratave të të gjithë deputetëve dhe ministrave, ashtu do të veprojë edhe në këtë rast.

Vasilika Hysi – Në rregull.

Lidhur me “urdhrin e ndalimit” sugjeroj që duhet të jetë “vendimi për ndalimin e kandidatit”.

Gent Ibrahimi – Dakord.

Fatmir Xhafaj – Dakord neni 177 me ndryshimet.

Neni 178.

Vasilika Hysi – Vetëm fjala “rekorde penale” duhet të zëvendësohet në të gjithë tekstin.

Fatmir Xhafaj – “Rekorde penale” si thuhet?

Vasilika Hysi – Po nuk ka rekorde.

Gent Ibrahimi – Sugjerimi i zonjës Hysi është të dhëna.

Vasilika Hysi – Është më mirë të dhëna.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 179. Dakord me ndryshimin.

Neni 180.

Vasilika Hysi – Relevancën e përvojës ta zëvendësojmë...

Kam një pyetje për paragrafin 2, germën “b”. Ju thoni “rezultatet e vlerësimit profesional që ka bërë në të shkuarën, në qoftë se ka”. Po në qoftë se nuk ka, si do të vlerësohen kandidatët? Do të penalizohen?

Gent Ibrahimi – Jo, absolutisht. Në qoftë se kandidati vjen nga një sistem ku ekziston një regjim vlerësimi, atëherë do të duhet që ai t’i paraqesë rezultatet. Në qoftë se jo, nuk ka. Në qoftë se vjen nga shërbimi civil e ke. Në qoftë se vjen nga magistratura, e ke. Në çdo regjim serioz marrëdhëniesh pune ka një regjim vlerësimi. Nuk ka pse të penalizohet.

Vasilika Hysi – Lidhur me germën “c” do të heqim fjalën “organizativ”, sepse është dy herë. Në fund fare te germa “e” ju thoni duhet të vlerësohen rezultatet gjatë studimeve të ciklit të arsimit të lartë. Në arsimin e lartë ne kemi 3 cikle: të parë, të dytë dhe të tretë. Rezultatet e cilit cikël do të mbajmë parasysh?

Gent Ibrahimi – Unë do të thosha të gjitha, përderisa cikli i tretë është i domosdoshëm për të qenë...

Vasilika Hysi – I dyti, është i domosdoshëm. Masteri kemi vënë ne.

Gent Ibrahimi– I tretë është doktoratura.

Vasilika Hysi – Mos duhet ta shikojmë me kriteret që ka për të qenë anëtar i këshillit? T’i unifikojmë pak në të dyja nenet.

Gent Ibrahimi – Jo, anëtar i këshillit nuk duhet të kesh doktoraturë.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 180 me ndryshimin.

Vasilika Hysi – Edhe germa “b”, zoti kryetar, në nenin 3 duhet rregulluar.

Fatmir Xhafaj – Po, po, siç i keni vendosur këtu të gjitha.

Vasilika Hysi – Në pikën 5, i keni dhënë të drejtë këshillit që mund të vendosë të intervistojë? Në fakt, nuk shkon që këshilli të mos intervistojë ose ta bëjë selektive.

Unë do të sugjeroja që kandidatët duhen intervistuar, sepse ti nuk mund t’i thuash dikujt në bazë të letrave . CV-ja mund të jetë shumë e bukur në pamje, por kur vjen aty mund të jetë një person që nuk di të flasë e të artikulojë.

Fatmir Xhafaj – Jeni dakord?

Dakord.

Vasilika Hysi – E dyta, nuk mund të kemi ekspertë për të verifikuar aftësitë, por ne mund t’i themi që do t’i nënshtrohen një testimi të aftësive të të shkruarit shqip dhe gjuhës huaj, sidomos të gjuhës shqipe. Të mos e lëmë selektive nëse do këshilli.

Gent Ibrahim– Atëherë, këshilli interviston dhe angazhon ekspertë për verifikimin e aftësive.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 181. Dakord bashkë me ndryshimet.

Neni 182. Dakord me ndryshimet e kërkuara.

Neni 183. Rastet e përgjegjësisë. Dakord.

Neni 184. Shkeljet disiplinore. Dakord bashkë me ndryshimet e bëra.

Neni 185. Dakord me ndryshimet.

Neni 186.

Vasilika Hysi – Po heqja e licencës së avokatit?

Gent Ibrahim – Anëtari hetues është relatori. Ndoshta kjo fjalë është më e përshtatshme se “anëtari hetues”. Meqenëse jemi në kontekstin e hetimit të shkeljeve disiplinore të anëtarëve të këshillit ndoshta qëndron mirë fjala” hetues”. Është një sistem i brendshëm disiplinor, siç e ka Gjykata Kushtetuese.

Vasilika Hysi – Anëtarët e këshillit janë të gjithë gjyqtarë dhe prokurorë dhe në rast se ata shkelin ligjin, ata vetëm do të shkarkohen si magjistratë.

Gent Ibrahim – Është fjala vetëm për ato shkeljet e parashikuara në nenin 184.

Vasilika Hysi – Ju lutem, lexojini pak komentet te pikat 2 dhe 5.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 186 bashkë me vërejtjet e zonjës Hysi dhe reflektimet që u bënë.

Neni 187.

Vasilika Hysi – Te neni 187 kam një pyetje në lidhje me paragrafin 2. A shpërbëhet këshilli i emërimeve nga magjistratë të zgjedhur me short?

Gent Ibrahim – Po, është po ajo që...

Vasilika Hysi – Atëherë, do ta lëmë që do të shkarkojmë vetëm nga anëtarët si magjistratë dhe pjesa tjetër e fjalisë nuk qëndron më.

Gent Ibrahim – Po.

Fatmir Xhafaj – Dakord neni 187 me ndryshimet.

Vazhdojmë me pjesën e pestë. Shkolla e Magjistraturës.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, këtu është përfshirë Shkolla e Magjistraturës...

Fatmir Xhafaj – Neni 188. Dakord.

Neni 189 me ndryshimet e paraqitura.

Vasilika Hysi – Kam një sugjerim. Do të përdorim fjalën “magjistratë” apo edhe “gjyqtarë e prokurorë”, sepse është e njëjta gjë. Në kuptimin e magjistratës kemi thënë edhe gjyqtarë dhe prokurorë.

Gent Ibrahim – Këtu duhet të ndjekim zgjedhjen që kemi bërë te ligji “Për statusin”. Në qoftë se aty flasim për gjyqtarë dhe prokurorë...

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 190. Dakord me ndryshimet e paraqitura.

Neni 191. Dakord me ndryshimet e paraqitura.

Neni 192.

Vasilika Hysi – Në nenin 192 kemi vetëm germën “f”. Ligji “Për arsimin e lartë nuk ka më komision të vlerësimit të titujve akademikë”. Duhet vendosur se cili do ta zëvendësojë përfaqësuesin e ministrisë së arsimit dhe të sportit.

Fatmir Xhafaj – Është një, që është e përafërt me këtë.

Vasilika Hysi – Ishte një agjenci e vlerësimit të projekteve...

Fatmir Xhafaj – Jo, jo. Ka një kusht...

Gent Ibrahim – Mund ta lëmë edhe vetëm përfaqësuesi, sepse, në fund të fundit, nuk kemi pse lidhemi me këto institucionet ekzistuese, me drejtoritë ekzistuese.

Fatmir Xhafaj – Lidhet me arsimin e lartë.

Dakord.

Neni 193.

Vasilika Hysi - Kam një pyetje. Neni 35 i ligjit flet këtu për dërgimin e një raporti që bën Shkolla e Magjistraturës dhe ia çon këshillit. Mua më duket sikur i kemi dhënë shumë kompetencë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë që të vendosë regjistrimin dhe renditjen e kandidatëve të Shkollës së Magjistraturës.

Fatmir Xhafaj – Këshilli drejtues ka këto detyra: “bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor për zbatimin e procedurave për regjistrimin dhe për zgjedhjen e kandidatëve që do të ndjekin studimet”.

Vasilika Hysi – I çon dokumentet...

Fatmir Xhafaj – Ku e ke këtu?

Vasilika Hysi – Te germa “a”.

Fatmir Xhafaj – Këshilli drejtues ka këto detyra: “bashkëpunon me Këshillin e Lartë...”

Vasilika Hysi – Jo për regjistrimin. I çon vetëm çfarë ka dosja, jep një informacion-raport mbi kandidatët dhe sa e kanë plotësuar dokumentet.

Gent Ibrahim – Më falni, cili nen?

Vasilika Hysi – neni 193, paragrafi 1, germa “a”.

Gent Ibrahim – “...bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor për regjistrin dhe për zgjedhjen e kandidatëve.”

Vasilika Hysi – Jo, në nenin 35 të ligjit të statusit thuhet: “Dërgon një raport dhe dokumentet e vlerësimit paraprak të kandidatëve.”

Angnes Bernhard – (*përkthen përkthyesja*) Duhet të lexohet së bashku me parashikimet paralele në *status quo*. Në ligjin “Për statusin për gjyqtarët dhe prokurorët”, aty thuhet që shkolla bën vlerësimin bazuar në kriteret formale dhe është këshilli dhe ai vetëm mund të kundërshtojë diçka nëse di ndonjë gjë shtesë përveç kësaj, por i mbetet shkollës që e përcakton listën dhe e përshtat atë. Pra, duhet të përkohen të dyja bashkë.

Fatmir Xhafaj - Dakord për këtë pjesë.

Neni 194.

Vasilika Hysi – Kam një pyetje për germën “c”. Këtu janë vendosur disa kritere. Me numrin e pedagogëve që ka shkolla, a mund të ndodhë ndonjëherë të mos kemi asnjë kandidat për drejtor shkolle me këto kritere që janë vendosur?

Thotë: “15 vjet pedagog në Shkollën e Magjistraturës, të ketë gradë shkencore “doktor”...”

Të ketë jo më pak se 10 vjet mësimdhënie në Shkollën e Magjistraturës nga marrja e gradës “doktor”, ose jo më pak se 5 vjet mësimdhënie nga marrja e titullit “profesor”. Ku i kemi profesorët ne? Dhe jo më pak se 15 vjet mësimdhënie si pedagog...

Fatmir Xhafaj – 5 vjet profesor, 10 vjet janë doktor. Ose jo më pak se 15 vjet mësimdhënie si pedagog i brendshëm ose i jashtëm.

Vasilika Hysi – Unë po pyes. Mos biem në kolaps dhe nuk do të gjejmë kandidatë?

Fatmir Xhafaj – “Jo më pak se 15 vjet mësimdhënie si pedagog i brendshëm ose pedagog i jashtëm...”

Vasilika Hysi – Nga ana tjetër, janë vënë edhe dy kritere, se ke thënë kumulative. Pra, drejtori i shkollës duhet t’i ketë të tria kushtet a, b dhe c, po ta lexosh fjalinë e parë.

Fatmir Xhafaj – Po, të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik.

Vasilika Hysi – Të ketë punuar gjyqtar dhe prokuror. Pra, mund të jesh profesor, por nëse nuk ke punuar gjyqtar dhe prokuror për 10 vjet, ose nuk ke qenë jurist më pak se 15 vjet përvojë...

Fatmir Xhafaj – Shumë mirë, jurist. 15 vjet jurist. Ka mbaruar shkollën 25 vjet dhe 15 vjet është 40 vjeç.

Neni 194? Dakord.

Neni 195? Dakord.

Neni 196 me ndryshimin e bërë riformatimi? Dakord.

Neni 197? Dakord.

Neni 198? Dakord.

Neni 199? Dakord.

Neni 200? Dakord me ndryshimet.

Neni 201?

Vasilika Hysi – Në nenin 201 dua atë disavantazhin dhe të metat. Gjeni një fjalë, sepse kur thua “shpeshtësia...”

Fatmir Xhafaj – Me këto ndryshime që kanë dhënë këtu duhen reflektuar.

Neni 201. Dakord.

Neni 202. Masat disiplinore.

Këto nene kanë nevojë për një emërtim.

Vasilika Hysi – Po, e kemi thënë që në fillim.

Në nenin 202 kam një pyetje. Pse në rastet e tjera ankimimi bëhet direkt në Gjykatën Administrative të Apelit, ndërsa këtu bëhet në Shkallë të Parë?

Gent Ibrahim – Mendoj se arsyeja është, si të thuash shkalla hierarkike e institucionit në hierarkinë e përgjithshme të institucioneve shtetërore, në fund të fundit, Shkolla e Magjistraturës nuk është Këshilli i Lartë Gjyqësor, nuk është as Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 203.

Vasilika Hysi – Kam një pyetje lidhur me paragrafin 4, ku thuhet: “ankimi i bërë nuk pezullon zbatimin e masave disiplinore për vitin e parë dhe të dytë. Mos është fjala për kandidatët magjistratë, që vazhdojnë studimet në vitin e parë dhe të dytë? Në paragrafin 4 të nenit 203.

Fjalja e fundit: “Ankimimi i bërë nuk e pezullon zbatimin e masës disiplinore për vitin e parë dhe të dytë.”

Gent Ibrahim – Besoj se është për kandidatët e magjistratës.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, kam një pyetje në parim. Në ligjin “Për magjistrat”, dhe “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit” me shkelje disiplinore i kemi dhënë në mënyrë të detajuar në ligj, duke i ndarë: të lehta, shumë të lehtë dhe të rënda, shumë të rënda.

Në rastin e magistraturës nuk i kemi dhënë shkelje disiplinore në ligj, por kemi dhënë vetëm masa. A mund ta përcaktojmë, kjo masë për cilën shkelje jepet?

Është rregulli minimal që duhet të ketë një lidhje proporcionaliteti midis shkeljes dhe masës që do të jepet.

Gent Ibrahimi – Dakord. Duhet një nen me shkelje disiplinore.

Fatmir Xhafaj – Neni 204.

Vasilika Hysi – Kam një pyetje. Do të përdorim termin “procedura e konkurrimit apo procedura e pranimit”? Sepse ne themi që në ligjin “Për statusin e magistratit” është provimi i pranimit që kalon në disa faza.

Gent Ibrahimi – Besoj se ajo është gjuha që duhet përdorur “pranimi”.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 204 me ndryshimet.

Neni 205.

Vasilika Hysi – Për herë të parë këtu has termin “praktikë paraprofesionale”. Ndërkohë, në ligjin “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit” edhe në tekst kemi “praktikën profesionale” të vitit të tretë. Bëhet fjalë për të njëjtën praktikë apo do të ketë ndonjë praktikë tjetër?

Gent Ibrahimi – Në çdo rast, kur bëhet fjalë për koncepte që kanë të bëjnë me statusin, me rekrutimin, me avancimin në karrierë, terminologjia do të jetë ajo e ligjit “Për statusin...”

Vasilika Hysi – Do të përdorim termin që është përmendur në nenin 205, germa “c”, një vit praktikë profesionale që organizohet sipas nenit 38 të ligjit “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë.”

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 205 me ndryshimet? Dakord.

Neni 206.

Vasilika Hysi – Lidhur me nenin 206 nuk kam gjë, zoti kryetar.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 206, siç është propozuar? Dakord.

Neni 207? Dakord.

Neni 208 me ndryshimet që keni bërë këtu riformulime? Dakord.

Neni 209 me saktësimin e nenit.

Vasilika Hysi – A mund të bëjë një pyetje për nenin 208?

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

Vasilika Hysi – Nëse deri sot një kandidat ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës, këtu është hequr e drejta për t’iu drejtuar gjykatës. E kam fjalën për pikën 3.

Ju thoni që nuk ka të drejtë të ankohet. Ankohet te këshilli, por jo në gjykatë. Nuk e cenon kjo Kodin e Procedurës Administrative të drejtën e ankimimit?

Gent Ibrahim – Nuk bëhet fjalë për një akt pushteti dhe në këto kushte ankimet mund të zgjidhen brenda për brenda.

Vasilika Hysi – I heq të drejtën për të vazhduar shkollën.

Gent Ibrahim – Unë besoj se gjykata futet në lojë kur një pushtet në hallkën e tij të fundit shpreh vullnetin. Këtu mendoj se nuk jemi në këto kushte.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 209. Dakord.

Neni 210. Dakord me ndryshimet e bëra.

Vasilika Hysi – Kur thuhet “vlerësimi i gjithë komponentëve”, çfarë do të thotë? Se është hera e parë që e hasim këtë fjalë.

Gent Ibrahim – Besoj se është fjala për provimet dhe praktikën.

Vasilika Hysi – Mund ta saktësojmë më mirë?

Gent Ibrahim – Patjetër.

Vasilika Hysi – Kam edhe një pyetje tjetër lidhur me paragrafin 4. I referoheni nenit 167/4, por 167/4 mua më rezulton dispozitë kalimtare. Mos duhet të ketë ndonjë referim tjetër?

Fatmir Xhafaj – Dakord. Verifikojeni, pika 4 në nenin 210.

Dakord me këto ndryshime.

Neni 211. Rregullimet e terminologjisë.

Dakord.

Neni 212.

Vasilika Hysi – Kam dy pyetje.

Ju këtu ndryshoni skemën e vlerësimit. Në vlerësimin e studentit, të komponentëve të vitit të parë dhe të dytë, kishit shkëlqyeshëm, shumë mirë, mirë, mjaftueshëm, pamjaftueshëm.

Te vlerësimi i kandidatëve për magjistratë kishit shkëlqyeshëm, shumë mirë, mirë, pranueshëm, i paaftë. Cila është arsyeja që ka ndryshuar vlerësimi?

Gent Ibrahim – Anëtarët e grupit të punës që kanë hartuar këtë pjesë nuk janë këtu. Kështu që unë ...

Vasilika Hysi – A mund ta lëmë ta verifikojnë ata?

Fatmir Xhafaj – Dakord. Bëni një konsultë, por ta votojmë në parim. Nëse ka ndryshime ta reflektojmë, por pasi të keni marrë pëlqimin e zonjës Agnes.

Vasilika Hysi – Gjithashtu, për këtë pikë, zoti kryetar, po në këtë nen, në pikën 5, dua të riformulohet ose saktësohet edhe përmbajtja e tij.

Fatmir Xhafaj – Dakord. I gjithë neni 212 duhet konsultuar me ata që kanë punuar me projektin dhe zonja Hysi bashkë me zonjën Bernhard, të çekojnë versionin final të këtij neni.

Neni 213.

Vasilika Hysi - Në nenin 213 kam një pyetje. Kur themi “emërimi i magjistratëve” kemi parasysh edhe caktimin në pozicion? Sepse i jemi referuar nenit 40 deri në nenin 46, ku flitet edhe për emërim dhe caktim në pozicion. Ndërkohë, fjalia fillon “emërimi i magjistratëve të diplomuar”, dhe kjo lidhet, zonja Agnes edhe me ligjin “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit”.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 213 me ndryshimet.

Neni 214. Dakord me ndryshimet.

Vasilika Hysi – Në nenin 214 keni përdorur një shprehje te paragrafi 4...

Fatmir Xhafaj – Për rastet e veçanta dhe përjashtimore.

Vasilika Hysi – Çfarë do të thotë?

Gent Ibrahim – Janë dy epitete që duan të thonë të njëjtën gjë.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 215. Dakord me ndryshimet.

Neni 216. Dakord me ndryshimet.

Neni 217.

Vasilika Hysi - Në nenin 217 do të kaloj në fund kur thuhet çdo ligj...

Fatmir Xhafaj – Të jetë tranzitore.

Dakord te dispozitat tranzitore.

Vasilika Hysi – Tani janë dispozitat kalimtare.

Fatmir Xhafaj – Tani janë dispozitat kalimtare. Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Vasilika Hysi – Te dispozitat kalimtare pothuajse për çdo paragraf kam pyetje.

Ju keni thënë që brenda një muaji nga hyrja në fuqi e rivlerësimit bëhet gjyqtar... Pak më vonë në qoftë se ju kujtohet, zoti Majko mund të më ndihmojë, meqë ka ligjin e vetingut, ligji i vetingut, ose i rivlerësimit ka afate të tjera procedurale.

Zoti kryetar këtu do të kërkoja...

Fatmir Xhafaj – I gjithë ky kapitull të përputhet me të gjitha ligjet. Dakord.

Vasilika Hysi – A është e mundur të caktonit... Këtë nuk mund ta bëjë një person i vetëm.

Fatmir Xhafaj – Jo.

(Diskutim pa mikrofon.)

Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Keni ndonjë gjë tjetër?

Vasilika Hysi – Këtu thuhet që kandidati përjashtohet nga procesi zgjedhjes edhe kur ushtron ankimin? Nuk ka rëndësi, ai, nuk ka të drejtë të konkurrojë. Pse duhet të ankohet kur i digjet përfundimisht e drejta të konkurrojë?

Gent Ibrahimi – Për hir të nevojave të procesit të jashtëzakonshëm që është vetingu, ne e privojmë nga kjo e drejtë, por ai për hir të dinjitetit personal mund të kërkojë e t'i shkojë deri në fund.

Vasilika Hysi – Si do t'ia bëjmë në këtë rast nëse fiton gjyqin?

Fatmir Xhafaj – Do të fitojë, por nuk fiton të drejtën për të marrë pjesë në garë, sepse është shpallur fituesi. Është bërë maratona, doli i pari ai e fiton të drejtën moralisht.

Neni 212, dakord me këto ndryshime

Vasilika Hysi – Lidhur me afatet, a mundemi që brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të zgjidhen anëtarët jomagjistrastë të Këshillit të Lartë?

Fatmir Xhafaj – Jo.

Vasilika Hysi – Prandaj dua që t'i shikoni edhe ju me vëmendje këto. Është e pamundur. Ne nuk kemi ende vetingun në fuqi.

Fatmir Xhafaj – Do t'i përputhim me ligjin për vetingun.

Dakord. Duhet riparë dhe duhet hequr ministri. Gjenerali një zgjidhje tjetër.

Gent Ibrahimi – Më falni, ndoshta nuk po e kuptoj. Po flasim për pikën 6 të këtij neni?

Vasilika Hysi – Jo, njëherë është pika 5, që fillon brenda 30 ditëve zgjedhja...

Fatmir Xhafaj – E thamë që do ta shikojmë. E ndoqa shumë mirë. Te pika 6 ministri i Drejtësisë...

Gent Ibrahimi – Domethënë, unë aty kuptoj që ata gjyqtarë që kanë interes të bëhen anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, e shprehin interesin e tyre menjëherë u nënshtrohen procesit të vetingut, pra, në përfundim të procedurës së vetingut.

Vasilika Hysi – Genti, në paragrafin 5 ju thoni brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nuk e lidhni me hyrjen e ligjit të vetingut.

Gent Ibrahimi – Ajo është për avokatë, për noterë, nuk është për gjyqtarë.

Vasilika Hysi – Janë kandidatë, do të jenë gjyqtarë që do të kalojnë.. Po edhe ata do të vlerësohen për pasuri... Mund të marrësh edhe një njeri, që është avokat...

Gent Ibrahimi – Jo, nuk ka punë me vetingun avokati që vjen...

Vasilika Hysi – Nuk do ta kontrollosh nëse ka ose jo rekorde kriminale?

Gent Ibrahim – Ata po, sipas ligjit bazë.

Vasilika Hysi – Po kush do të bëjë këtë lloj kur ti ende nuk ke filluar të ngresh institucionet?

Gent Ibrahim – Normalisht, një avokat, një noter, një njeri nga shoqëria civile nuk i nënshtrohet vetingut. Kështu që pika 5 është në rregull. Mua edhe pika 6 më duket në rregull.

Fatmir Xhafaj – Juve ju duket në rregull, por ministri i Drejtësisë nuk mund ta thërrasë...

Gent Ibrahim – Përveç çështjes së ministrit, ajo është një zgjidhje ...

Fatmir Xhafaj – Gjenerali një zgjidhje tjetër dhe ta rishikojmë të gjithë.

Neni 219. Krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Dakord.

Neni 220.

(Vasilika Hysi flet pa mikrofon.)

Fatmir Xhafaj – Të krijojë brenda 6 muajve një infrastrukturë normale. Shumë mirë e kanë.

Vasilika Hysi – E dyta, në paragrafin 5, thuhet: “derisa ndërtohet sistemi elektronik ...

Fatmir Xhafaj – Më fal, pse e keni ... apo këtë që keni e replikoni edhe te Këshilli i Lartë i Prokurorisë?

Vasilika Hysi – Është kudo.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Vasilika Hysi – Paragrafi 5: “Derisa sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve të jetë plotësisht funksional, i lihet Këshillit të Lartë Gjyqësor të zgjidhë me mjete të tjera menaxhimin e rasteve”.

Nuk do t’i lëmë një afat se kur do të bëhet sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve? Ai mund të dojë 10 vjet, nuk e bën.

Fatmir Xhafaj – Po e ka sot menaxhimin elektronik të çështjeve. Do ta përmirësojë. Nuk është pa gjë sot, apo jo.

Vasilika Hysi – Jo, nuk është plotësisht funksional.

Fatmir Xhafaj – Është me dy sisteme.

Gent Ibrahim – Në qoftë se do të imagjinoja se çfarë do të bënin ata të nesërmen e konstituimit si organ, ata do të siguroheshin që këto sistemet e ndryshme që përdoren sot vazhdojnë të përdoren dhe aty ku nuk ka fare sisteme.

Fatmir Xhafaj – Neni 220. Dakord me ndryshimet dhe vërejtjet.

Neni 221. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Lartë...

Vasilika Hysi – Duhet të saktësohet referenca.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 222. Dakord.

Vasilika Hysi – Edhe neni 222 njësoj, saktësim reference.

Fatmir Xhafaj – Neni 223.

Vasilika Hysi – Kam një pyetje për paragrafin 1.

Flasim për nëpunësin civil dhe punonjësit aktual të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji ata menjëherë transferohen në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Gent Ibrahim – Është një lapsus. Duhet të jetë në zyrën e prokurorit të Përgjithshëm...

Fatmir Xhafaj – Dhe e inspektimit në zyrën e prokurorit të Përgjithshëm.

Gent Ibrahim – Po, për ata është fjala.

Vasilika Hysi - Tjetra, për buxhetin, zoti kryetar. Në paragrafin 2 dhe 3...

Fatmir Xhafaj – Edhe një herë. Komandohen sa kohë që ai pastaj bën aktet... Pra, komandohen në detyrën...

Vasilika Hysi – Duhet formuluar, sepse këta kanë thënë “përveç kur ekziston...” I kanë dhënë emërim direkt.

Fatmir Xhafaj – Jo, pra jo, e thamë tani. Nuk do të emërohen direkt. Do të vazhdojë normaliteti i punës edhe te Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe te Gjyqësori dhe nga zyra e prokurorit në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, komandohen në këto detyra të vazhdojë normalitetin e punës me këshillin e ri. Ata do të bëjnë vlerësimin e tyre. Nuk fillon çdo gjë nga pika zero dhe janë të komanduar deri në momentin që bëhet statusi, rregulloret, kriteret. Vlerësohen, qëndrojnë ose jo, u nënshtrohen vetingut, kështu me radhë. Në qoftë se nuk i plotësojnë kushtet, ikin.

Edhe këtë bëjeni brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Inspektorati i Lartë i Drejtësisë.

Vasilika Hysi – Te inspektori lidhur me afatin nuk jam në gjendje të vlerësoj, nëse është e mundur, thuhet “brenda një muaji nga hyrja në fuqi e ligjit të rivlerësimit”. Pra, pa filluar punë rivlerësimi, fillon aplikimi për inspektor.

Unë mendoj se nuk duhet të jetë lidhur me hyrjen në fuqi, por duhet të fillojë kur të fillojë rivlerësimi. Çfarë kuptimi ka të fillojë punë pa bërë rivlerësim?

Fatmir Xhafaj – Shprehim kërkesën për rivlerësim, një herë. Marrim certifikatën e rivlerësimit dhe pastaj çojmë...

Vasilika Hysi – Thuhet: “fillojnë procedurat e konkurrimit”.

Fatmir Xhafaj – Brenda një muaji nga hyrja në fuqi. Pra, në qoftë se ligji hyn në fuqi më 1 janar, ai deri më 31 janar duhet të ketë paraqitur interesin. Shkojnë marrin certifikatën dhe pastaj konkurrojnë. Kështu është kuptimi, apo e kam gabim.

Po, pra, paraqesin interes dhe i thotë: më rivlerëso, sepse dua të kandidoj. Këtë i thotë, apo e kam gabim?

Gent Ibrahim - Aty ka dy skenarë: i pari, kur i interesuari vjen nga radhët e magjistratëve dhe atij i duhet patjetër të kalojë vetingun, kurse i dyti kur është një jurist, që nuk është magjistrat, dhe e çon aplikimin te Këshilli i Emërimeve. Ndoshta ka të drejtë zonja Hysi, nuk mund të flitet për datën e hyrjes në fuqi, por për datën e konstituimit të organeve të vetingut. Po, menjëherë pas konstituimit të organeve të vetingut.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

A ka gjë tjetër këtu?

Vasilika Hysi – Në paragrafin e tretë thuhet: “Në rast se kandidati nuk pranohet nëpërmjet një vendimi të shkallës së parë”, ç’do të thotë “shkalla e parë” .

Fatmir Xhafaj – Ka dashur të thotë komisionit të kualifikimit.

Vasilika Hysi – Më poshtë thuhet: “Është paraqitur ankim ndaj vendimit” A mund ta qartësoni pikën 3?

Fatmir Xhafaj – Hiqeni këtë: “dhe kur ndaj vendimit”, ankimi nuk e pezullon procedurën, kjo duhet thënë.

Dakord me këto ndryshime.

Vasilika Hysi – Më falni, te pika 5 thuhet: “Detyrohet Këshilli i Emërimeve në Drejtësi të nisë pa vonesë procedurën dhe renditjen e kandidatëve brenda 10 ditëve”. A ka afate tani? Po me cilat ligje, me këtë ligjin që hyn në fuqi tani?

Fatmir Xhafaj – Lëreni evazive këtë. Mos lini afate, ta kuptojnë vetë ata.

Vasilika Hysi – Nuk e kuptoj nenin 5, ku thuhet: “E nis pa vonesë”. Pa vonesë, po nga cili moment?

Gent Ibrahim – Nga momenti i dorëzimit të kandidaturave.

Vasilika Hysi – Atëherë, pa u konsideruar komisioni i vetingut.

Gent Ibrahim- Për sa u takon kandidatëve jo magjistratë, po, menjëherë, nuk ka pse të presë për konstituimin.

Fatmir Xhafaj – Dakord, por nuk mundet ai të vërë kushte pabarazie. Më falni, ku i thua gjyqtarit: “do të kandidoj unë për inspektor”, nuk mund të më thuash: “e zura vendin tani, se e gjeta një”. Duhet riformatuar që t’u japë të njëjtin shans, t’u japë kohë gjyqtarëve dhe prokurorëve të njëjtë me këtë.

Dakord. “Krijimi i zyrës së inspektorit të lartë të drejtësisë”.

Vasilika Hysi – Të them të drejtën këtu kam disa pyetje. E para, nuk mund ta fillojmë fjalinë: “Ngarkohet Këshilli i Ministrave për marrjen e masave të menjëhershme”. Kjo duhet të jetë në fund të paragrafit. “Ngarkohet Këshilli i Ministrave për marrjen e masave për të siguruar buxhetin” dhe kjo duhet të jetë në fund. Por, nisur nga paragrafi 3 “pas emërimit të tij”, për kë është fjala? Kur do të emërohet inspektori, se nuk po e marr vesh?

Fatmir Xhafaj - Do të caktojmë një kufi 3-4 muaj pas fillimit të procesit të konstituimit të institucioneve të vetingut.

Vasilika Hysi – Dakord.

Gent Ibrahim – Mund të bëjmë një zgjidhje këtu, në rastin e magjistratëve që duan të kandidojnë për Këshillin e Lartë Gjyqësor, ne thamë që këta duhet ta shprehin interesin menjëherë, ndërkohë që nuk e kemi thënë këtu për ata magjistratë që duan të konkurrojnë për vendin e inspektorit të lartë. Mund ta themi këtu: “Ata magjistratë që duan të bëhen inspektorë, mund ta shprehin menjëherë interesin dhe të vetohen me urgjencë”.

Fatmir Xhafaj – Dakord, vetëm se duhet të lidhen me konstituimin e institucioneve të vetingut, me afatet, jo me hyrjen në fuqi të ligjit, por me konstituimin, 1-3 muaj, por brenda kësaj.

Dakord.

Vasilika Hysi – Lidhur me paragrafin 3, pas emërimit të këtij në bashkëpunimit me departamentin, inspektori cakton numrin minimal dhe bën marrjen në punë të nëpunësve. Pyetja ime është: nëpunësit do t’i marrë inspektori apo do të ndiqen procedurat e statusit të nëpunësit civil?

Gent Ibrahim - Në versionin që diskutuam para pak minutash, parashikohej një regjim i posaçëm për personelin e inspektorit, por ramë dakord bashkë që do ta kthejmë edhe atë si pjesë të shërbimit civil. Kështu që ai ndryshim duhet të reflektohet edhe këtu.

Vasilika Hysi - E dyta, pse e përcaktoni në ligj detyrimisht që duhet të delegohen 16 inspektorë në fazën fillestare? Nga krijimi i zyrës duhen 6 muaj për të bërë strukturën? Për të kaluar pastaj te... Kur quhet zyra e krijuar, është një pyetje tjetër.

Gent Ibrahim – Ka një rregullim për atë se kur quhet e krijuar zyra.

Vasilika Hysi – Te paragrafi 4, kur quhet zyra e krijuar, a mund ta thjeshtojmë pak gjuhën? Unë e kam lexuar, por nuk arrij ta kuptoj.

Gent Ibrahimi- Është “dita e parë e muajit pasardhës”, pra, në rast se inspektori emërohet në korrik, po themi, dita e parë e gushtit është dita kur fillon. Po, keni të drejtë që duhet thënë pak më qartë.

Vasilika Hysi - Lidhur me paragrafin 6, sipas mendimit tim, formulimi i bërë në këtë paragraf bie ndesh me parashikimin e pikës 5. Në një vend thuhet: “Mandati i inspektorit nuk mbaron”, në pikën 5 thuhet: Mandati i kryeinspektorit përfundon në ditën e krijimit të zyrës”, ndërsa në pikën 6 thuhet: “Në ditën e krijimit të zyrës së inspektorit aty ku është e mundur vazhdon mandati i tij”.

Gent Ibrahimi- Si inspektor.

Vasilika Hysi - Konsiderohet si inspektori i zyrës.

Gent Ibrahimi- Mbaron mandati i tij si kryeinspektor i KLD-së.

Vasilika Hysi – Nëse nuk zgjidhet.

Fatmir Xhafaj – Një minutë, çfarë është kjo?

Vasilika Hysi – Është mandati i kryeinspektorit.

Fatmir Xhafaj – I kujt?

Vasilika Hysi – Pikat 5 dhe 6.

Gent Ibrahimi– Kryeinspektori aktual i KLD-së, në momentin kur krijohet Inspektorati i Lartë, nuk është më.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, “Në ditën e krijimit të zyrës, inspektori pushon së zhvilluari veprimtarinë e inspektimit pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme si dhe përfundon mandati i personave respektivë”.

Gent Ibrahimi- Të KLD-së.

Fatmir Xhafaj – Të të gjithëve, edhe të Ministrisë së Drejtësisë.

Vasilika Hysi – Po ndërkohë në pikën 6 thuhet: “Në ditën e krijimit të zyrës së inspektoriatit, kryeinspektori, aty ku është e mundur edhe inspektorët, konsiderohen si inspektorë të zyrës së Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë”.

Fatmir Xhafaj – Po, pra, ju lutem.

Vasilika Hysi- Tani ose mbaron...

Fatmir Xhafaj - Që ushtrojnë detyrën...

Vasilika Hysi- Tani ose mbaron ose konsiderohet se vazhdojnë.

Gent Ibrahimi – Mbaron mandati si kryeinspektor i KLD-së dhe...

Vasilika Hysi– Dhe automatikisht do të kalojë inspektor?

Gent Ibrahim - ...bëhet inspektor në Inspektoratin e Lartë.

Vasilika Hysi – Pa kaluar vetingun?

Fatmir Xhafaj – Jo, më falni, një minutë, ai do të krijojë zyrën e re, do të fillojë rekrutimet e reja, le të shkojë të aplikojë. Të gjithë ata duhet të shkojnë të aplikojnë.

Gent Ibrahim- Mund të përdorim logjikën e komandimit edhe këtu, se ai do të fillojë punë.

Fatmir Xhafaj – Nuk do të rrimë të gjejmë vend për kryeinspektorin. Inspektorët e tyre mund të komandohen provizorisht deri në miratimin kryeinspektori. Kur të fillojë punë, ai do t'i kërkojë Këshillit që të komandohen këta 1, 2, 3, e të tjerë deri në kryerjen e procesit emëruar. Ta lidhim me procesin e emërimit, do t'i nënshtrohen sipas ligjit për statusin e nëpunësit, ligjit për vetingun dhe ligjeve të tjera në fuqi.

Vasilika Hysi– Unë, zoti Ibrahim, kam një shqetësim, kur kemi diskutuar me zonjën Agnes ligjin për statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit ne thamë që aktualisht jo të gjithë inspektorët kanë statusin e magjistratit. Me këtë dispozitë kalimtare, te pika 6 ju thoni: “Të gjithë inspektorët, pavarësisht se nuk kanë statusin e magjistratit, ditën, që krijohet zyra, konsiderohen magjistratë me dispozitat e këtij ligji”. Pra, si mund ta bësh direkt magjistrat?

Gent Ibrahim- Jo, magjistrat, është inspektor.

Vasilika Hysi – Po me statusin e gjyqtarit dhe të prokurorit, është referimi, “në përputhje me dispozitat e ligjit për gjyqtarin dhe prokurorin”.

Fatmir Xhafaj - Pra, në përputhje, nëse i plotësojnë ato, është ideja. Duhet dhënë me këtë kuptim, nëse i plotësojnë këto kritere.

Gent Ibrahim– Pra, duhet shtuar: “të atij ligji dhe këtij ligji”.

Fatmir Xhafaj – Pra, do të plotësojnë kriteret. Po nuk plotësuan kriteret e këtij nuk..

Vasilika Hysi – Duhet ta shikojmë më me vëmendje!

Fatmir Xhafaj – Po, patjetër, se ne për t'i parë gjërat me vëmendje jemi këtu.

A kemi gjë tjetër te nenin 225?

Vasilika Hysi – Po. Ne në paragrafin 7 kemi vënë një fjali: “Në ditën e krijimit të zyrës së inspektorit, të gjitha dosjet disiplinore i kalojnë, çdo akte tjetër në kuptim të këtij ligji i kalojnë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”.

Por në ditën e krijimit të zyrës së inspektorit, e vendose, që janë në mes?

Fatmir Xhafaj – Po normal.

Vasilika Hysi - Kur themi: “të këtij ligji për statusin”, edhe “të ligjit për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit” apo duhet hequr fjala “për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit”?

Pra, në kuptimin e këtij ligji, se i jemi referuar edhe këtij ligji, edhe ligjit për statusin.

Gent Ibrahimi– Besoj se është fjala për të dyja ligjet, sepse të dyja ligjet e trajtojnë problemin e ankimit dhe mënyrën e shqyrtimit të ankimit.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 225 me ndryshimet e sugjeruara.

Neni 226. Është e njëjta logjikë, apo jo?

Vasilika Hysi – Po, edhe te neni 226 ka nevojë për sqarime. Këtu thuhet: “Një ditë pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, zgjidhet Këshilli i Përkohshëm i Emërimeve në sistemin e drejtësisë” pa veting, pa gjë. Pra, që në paragrafin 1: “Brenda një dite pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, prokurori harton listën e prokurorëve që do të shkojnë në Këshillin e Emërimeve”. Këshilli i Lartë i Drejtësisë harton listën kush do të shkojë në Këshillin e Emërimeve, Gjykata Kushtetuese çon emrat kush do të shkojë në Këshillin e Emërimeve. Kjo listë i shkon Avokatit të Popullit.

Fatmir Xhafaj – Po pse Avokatit të Popullit?

Vasilika Hysi – Është krijuar Këshilli i Përkohshëm i Emërimeve që nuk e kemi në Kushtetutë, por këtu e kemi. Listat dhe relacionet, a është e mundur që brenda një dite nga hyrja në fuqi e ndryshimeve kushtetuese, pa hyrë në fuqi ky ligji ...

Fatmir Xhafaj – Pse ju është dashur një ditë? Çfarë do të bëni ju në një ditë?

Agnes Bernhard – (*përkthen përkthyesja*) Neni 229, paragrafi 5 i Kushtetutës parashikon emërimin e Këshillit dhe parashikon 5 ditë, prandaj janë mjaft strikte, edhe dispozitat kalimtare. Brenda 5 ditëve hapat duhet të kryhen në afate kohore mjaft të ngushta, përndryshe do t’ju duhet që të rishikoni afatin e vendosur në nenin 229 197, paragrafi 12.

Fatmir Xhafaj – Çfarë do të bëjë, u mbyt në punë?

Gent Ibrahimi- Përderisa do të krijohet një këshill i përkohshëm emërimesh brenda 5 ditëve, do të duhet që listat e atyre që janë të përshtatshëm për t’u zgjedhur në këshill të bëhen gati menjëherë, në mos 1 ditë, 2 ditë, por jo më shumë.

Fatmir Xhafaj – Për mendimin tim, nuk ka ndonjë gjë nëse do të bëjë listën në një ditë, mua më duket e arsyeshme, nuk ka ndonjë çudi të madhe. Ju lutem, “të mos e bëjmë qimen tra” për një gjë kaq të vogël. Jo, nuk kërkon relacion. Ligji kërkon nëse një prokuror nuk përmbush kriteret. Pra, ai do të thotë: “janë 400 prokurorë, por 10 nuk i përmbushin kriteret”.

Gent Ibrahimi- Për ta hequr merakun e zonjës Hysi, mund të themi: “Harton një listë me emrat e prokurorëve që plotësojnë kushtet”.

Fatmir Xhafaj – Jo, jo, le ta bëjë një relacion, siç e ka ligji, madje ta bëjë me detaje. Nuk do ta gjejë gjë, i di, se aty punon.

Kritere formale janë, nuk do të bëjë kritere të vlerësimit me meritë që të thuash se i duhet kohë të vrasë mendjen. Problemi është ekipi që do të merret me të.

Pse duhet: “ai/ajo duhet të paraqesë që nuk do të jetë anëtar i Këshillit të Emërimeve”? Pse e keni vënë këtë te pika 5?

Gent Ibrahimi- Thjesht, duke pasur parasysh se këta me vetëdijen që do t’i nënshtrohen të parët procesit të vetingut, mund të mos duan.

Fatmir Xhafaj – Mirë, por duhet të saktësohet, kjo duhet thënë më qartë që nuk dëshirojnë. Dhe jo “brenda një dite pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese”. Se nuk mund të lihet një ditë për të gjithë gjyqtarët.

Gent Ibrahimi- Ndoshta mund të lihet “pas dorëzimit të listës”. Pra, mund të thotë: unë jam në listë por nuk dua.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Vasilika Hysi – Nuk realizohet brenda një dite, se 8 orë pune janë të shkretat. Brenda një dite do të dorëzohet, do të bëhet verifikimi, do t’i çohet lista Avokatit, brenda kësaj dite Avokati do të marrë vendim. Kjo është shumë formale, dhe institucioni më i rëndësishëm nuk mundet që për 8 orë pune të bëjë verifikimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, relacionin për secilin prej tyre, listën dhe t’ia çosh avokatit të bëjë përzgjedhjen.

Fatmir Xhafaj- Po nuk thotë ende këtu.

Gent Ibrahimi – Do të bëjmë një racionalizëm të këtij neni duke pasur parasysh afatet, për sa kohë kemi një afat.

Fatmir Xhafaj – Dakord. “Një përfaqësues i Presidentit, Avokatit të Popullit dhe Kryetarit të Kuvendit eliminojnë kandidatët e papërshtatshëm”. Si eliminojnë kandidatët e papërshtatshëm? Ç’do të thotë kjo?

Gent Ibrahimi- Të papërshtatshëm.

Fatmir Xhafaj – Po për çfarë, mbi ç’bazë?

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesja)* Ligji parashikon kriteret për të qenë anëtar i Këshillit të Emërimit të Drejtësisë. Nëse ne vendosim kritere të tjera, kjo duhet të verifikohet dhe pastaj ata që nuk kanë nevojë për këto kritere, nuk i përmbushin këto kritere, duhet të eliminohen nga.

Gent Ibrahimi- Kjo është praktikisht, verifikimi i atyre kritereve që parashikon Kushtetuta për anëtarët e këshillave.

Fatmir Xhafaj – A mund ta ndajmë këtu Avokatin e Popullit dhe ta lëmë në rolin e monitoruesit? Avokati i Popullit ta monitorojë si proces, jam dakord, por përzgjedhësi duhet të jetë një nga... A ta mendojmë pak këtë, ju lutem, këshillin që do ta bëjë këshillin përgjegjës, ku avokati të jetë supevizor?

Vasilika Hysi – Zoti Ibrahim, në paragrafin 5 keni thënë: “Në rast se më shumë se 50% e kandidatëve, që përmbushin kriteret e parashikuara në ligj, paraqesin një deklaratë se nuk duan të marrin pjesë...”, megjithatë ju i detyroni të marrin pjesë. Cila është arsyeja?

Gent Ibrahim - Duke iu druajtur një situatë ku pjesa më e madhe e tyre do të ngurojnë të kandidojnë nga merakë se do t’i nënshtrohen një vetingu special më të fortë se kolegët e tjerë. Në fakt, këta do t’i nënshtrohen të parët vetingut.

Fatmir Xhafaj – Aty mund të jenë edhe 10, nuk ka rëndësi, pse keni..?.

Vasilika Hysi - Ju thoni se në këtë këshill të përkohshëm anëtarët i nënshtrohen vetingut, ndërkohë që ligji i vetingut nuk hyn një ditë pas hyrjes në fuqi të ligjit në Fletoren Zyrtare dhe ndërkohë që pak më parë thatë se këshilli i parë nuk do t’i nënshtrohet vetingut. Dua të di, nëse është menduar që ky këshill që do të fillojë të bëjë emërimet e të gjitha vakancave aktuale, do t’i nënshtrohet vetingut apo jo?

Fatmir Xhafaj – Po, do t’i nënshtrohet, por në një hap të dytë. Ata që do të zgjidhen në Këshillin e Emërimeve, do t’i nënshtrohen vetingut në një hap të dytë.

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesja)* Ata nuk vlerësohen përpara se të bëhen anëtarë, megjithatë, ata rivlerësohen me prioritet. Kjo mund të përcaktojë.

Fatmir Xhafaj – “... i nënshtrohen rivlerësimit me përparësi”. Gjithsesi mbetet e rihapur për të parë datat, saktësimet. Ta rishohim këtë gjë!

Neni 227, “Krijimi i Këshillit të Përhershëm të Emërimeve në Drejtësi”.

Vasilika Hysi – Edhe për këtë unë kam një sugjerim parimor.

Fatmir Xhafaj- Pse duhet në dispozita transitore? Ky është këshill i përhershëm, është atje ku e ka vendin. Ç’punë ka me dispozitat transitore?

Gent Ibrahim –Po, e drejtë.

Vasilika Hysi – Ne kemi vënë kritere, procedura për zgjedhjen e këshillave të emërimit në drejtësi, të këshillit, se është një këshill, vetëm ai do të zgjidhet çdo vit me short, pse themi: “Procedurat e parashikuara nga ligji për zgjedhjen e këtij këshilli do të zbatohen aq sa është e mundur”?

Fatmir Xhafaj – Hiqet komplet neni 227. Nuk ka një këshill të përhershëm. Krijimi i këshillit të përhershëm është çdo vit. A është çdo vit, me short, apo jo? Pse e keni vënë këshill i përhershëm, atëherë? I përkohshmi është te neni 226.

Vasilika Hysi – Kush do ta zgjedhë tani, Këshilli i Lartë i Drejtësisë aktuali, po flitet tani për transitorin..

Fatmir Xhafaj – Kur nuk zgjedh gjë Këshilli..

Vasilika Hysi – Jo, zoti kryetar, e kanë lënë që ky këshill që është tani, lexojeni pak paragrafin e parë, ju lutem, prandaj thashë duhet riformuluar komplet dispozita, titulli është: “Këshilli i përhershëm”, por më poshtë thuhet: “Me rastin e krijimit të tyre përgjigjet Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe jo Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe jo Prokurori i Përgjithshëm”. Për kë flitet? A flitet për këtë këshill?

Fatmir Xhafaj – A keni krijuar Këshillin e Përkohshëm për Emërimet në Drejtësi? Pse duhet ky këtu?

Gent Ibrahim – Në këtë moment nuk po arrijmë edhe ne të gjejmë arsyen pse e kemi bërë një nen të tillë.

Fatmir Xhafaj – Dakord, po e lëmë me pikëpyetje, të hapur, që ta verifikojmë.

Vasilika Hysi – Kam edhe diçka.

Fatmir Xhafaj – Po e lëmë të hapur pra.

Vasilika Hysi – Jo, e kam për kushtet, se kanë vënë kushte të tjera këta.

Fatmir Xhafaj – Pikërisht pra, kur të arsyetojnë këta, do të na thonë pse janë këto kushtet, mos të bëjmë debat, kur të vijë, do ta shohim, se mund të mos qëndrojnë fare kjo. Për mua nuk qëndron.

Agnes Bernhard – *(përkthen përkthyesja)* Ky këshill paraparak në vitin e parë mund të jetë funksional vetëm për pak muaj. Nëse ligji hyn në fuqi në shtator, atëherë Këshilli i Emërimeve në Drejtësi mund të operojë për 3-4 muaj, është përkohësisht. Paragrafi 2 thotë: “Në përcaktimin e ardhshëm të Këshillit të Emërimeve, lista e kandidatëve të mundshëm do të limitohet, nëse ka tashmë gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët i janë nënshtruar vetingut”. Atëherë lista do të limitohet, do të kufizohet vetëm me ata që janë kontrolluar.

Fatmir Xhafaj – Se i ngatërruam edhe këta, pastaj do t’u jap të drejtë kolegëve të PD-së që thonë se e kemi ngatërruar me duart tona. Tani krijojmë një këshill të përkohshëm deri në momentin e konstituimit të institucioneve të reja në sistem. Në momentin e konstituimit, 3 muaj prapa, krijohet Këshilli i ri i Emërimeve në Drejtësi deri në përfundim të vitit kalendarik dhe këtu e mbyllim këtë gjë me një dispozitë transitore. Nuk mundet të krijojmë një këshill në shtator, pastaj në janar, kush e ka kaluar procesin e vetingut të qëndrojnë, ai tjetri jo, ky të vazhdojë të qëndrojë deri në momentin e krijimit të këshillit. Gjithsesi, mbetet e hapur.

Neni 228 “Shkolla e Magjistraturës”.

Vasilika Hysi – Ne kemi thënë se konstituimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe i Këshillit të Lartë të Prokurorisë bëhet brenda 8 muajve, ndërkohë që këtu thuhet: “brenda 30 ditëve nga konstituimi i tyre”. Po tani ..

Fatmir Xhafaj - Do të jetë Këshilli Drejtues që është në fuqi. Patjetër që do të jetë, se pa Këshill Drejtues do të rrijë?

Vasilika Hysi – Pyetja ime ka të bëjë me këtë: konkursi për këtë vit do të bëhet në muajin shtator?

Fatmir Xhafaj – Kush ka thënë që do të bëhet në shtator?

Vasilika Hysi – E kanë shënuar në dispozitë, paragrafi 4, nenit 228.

Fatmir Xhafaj – Pse e keni thënë këtu në muajin shtator?

Dakord, e sqarojmë edhe këtë.

Neni 229. Dakord.

A kemi gjë tjetër?

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, kemi dy konkurse që duhen sqaruar. Një konkurs u bëka në shtator, një në prill.

Fatmir Xhafaj – Po, pra, do ta sqarojmë.

Dakord.

Besoj se mbyllëm një punë shumë voluminoze.

Besoj se edhe ju jeni dakord që falënderimet e para t’ia jap relatores, zonjës Hysi, që me shumë dashuri na e mori shpirtin të gjithëve, por e bëri në emër të një interesi të lartë publik, kështu që është e justifikuar.

Faleminderit, zonja Bernhard, faleminderit zoti Ibrahim, faleminderit zonjave të sekretariatit teknik dhe të gjithë tyreve që kanë punuar dhe kanë kontribuar intensivisht për këtë ligj voluminoz, por më shumë se numri, është më e rëndësishme përmbajtja.

E di që do të keni një punë të lodhshme këto ditë, edhe ju vajzat e sekretariatit teknik, por zoti Ibrahim, zonja Agnes do t’ua lehtësojnë sado pak punën, ndërkohë unë dhe zonja Hysi do të kontribuojmë, gjithashtu, për detyrat që u lanë dhe të sqarohen dhe të saktësohen.

Faleminderit!

E mbyllim këtu këtë pikë të rendit të ditës. Do të vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës me projektligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas rendit të ditës, do të jetë radha e këtij projektligji për të vazhduar shqyrtimin. Them për të vazhduar shqyrtimin, sepse në seancën e mëparshme është kryer një prezantim

në parim rreth projektligjit nga zonja Anastasi, dhe zoti Devill, të cilët janë dy bashkëdrejtuesit e këtij grupi që ka bërë një punë të konsiderueshme, duke sjellë një projektligj, i cili është risi në shumitet si koncept.

Ky projektligj është rezultat i vlerësimit të eksperiencave pozitive që ka pasur dhe ka në këtë fushë; i kontributit të ekspertëve të nivelit të lartë që janë angazhuar, por edhe ekspertizës shumë të mirë të Brukselit, dhe natyrisht edhe i një ekspertize shumë profesionale që ka bërë Komisioni i Venecias në dy opinionet e tij. Duhet theksuar fakti se në opinionin final të tij Komisioni i Venecias i ka dhënë një mbështetje të konsiderueshme, mjaft pozitive zgjidhjeve që ishin dhënë në aneks, e cila përbën edhe bazën lidhur me vlerësimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, nene ose dokument kushtetues, i cili përbën edhe bazën mbi të cilën është ndërtuar edhe ky projektligj.

Kolegët kanë bërë pyetje lidhur me përmbajtjen e projektit dhe kanë marrë përgjigjet e nevojshme rreth tij. Sot është momenti për të dëgjuar vlerësimin e relatorit rreth projektit.

Po, zoti Majko.

Pandeli Majko – Faleminderit!

Lidhur me qëllimin dhe objektivat e projektligjit Kuvendi i Shqipërisë synon të ndërmarrë një reformë të gjerë në sistemin e drejtësisë. Arsytet që diktuan nevojën për të ndërmarrë këtë reformë janë parashtruar më hollësisht në dokumentin analizë të sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Në këtë dokument spikat nevoja për të adresuar problemet që kanë lindur nga shkalla e lartë e korrupsionit në sistemin e drejtësisë. Ekzistenca dhe niveli i korrupsionit në këtë sistem drejtësie nuk është vetëm një çështje e perceptimit të publikut, por edhe një fakt i pranuar nga vetë gjyqtarët. Arsytet e tjera lidhen me cilësinë e punës së gjyqtarëve dhe të prokurorëve, si dhe me mosfunksionimin efektiv të mekanizmave ekzistues, për kontrollin në rastet e shkeljeve të ligjit gjatë ushtrimit të detyrës, për vlerësimin e punës së tyre e të tjera.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë propozon projektligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve” si pjesë integrale e paketës së ndryshimeve kushtetuese, i cili ka për qëllim reformimin e sistemit të drejtësisë dhe kthimin e besimit qytetarëve në zbatimin e ligjit në vend. Qëllimi i këtij projektligji është përcaktimi i rregullave të posaçme, për rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe të prokurorëve, si dhe subjekteve të tjera që do të rivlerësohen, sipas nenit 179/b të projektligjit “Për ndryshimet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”. Ky proces do të shërbejë për të vlerësuar përgatitjen e tyre profesionale, integritetin moral, si dhe për të qartësuar shkallën e pavarësisë në punën e tyre nga ndikimi i krimit të organizuar, korrupsionit dhe pushtetit

politik. Projektligji rregullon parimet e organizimit dhe procedurat për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe garanton që i gjithë procesi i rivlerësimit të kryhet me efektivitet pa cenuar standardet e procesit të rregullt ligjor.

Qëllimi i tij është që rezultatet e këtij rivlerësimi të shërbejnë për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur që funksionon me eficiencë dhe me besueshmëri, dhe që pasqyron standardet e ndershmërisë, integritetit, profesionalizmit dhe transparencës në të. Në këtë projektligj vendoset ngritja e një sistemi tërësor, për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve me qëllim uljen e ndikimit të krimit të organizuar, politizimit dhe elementëve të tjerë korruptivë në dhënien e drejtësisë, si dhe për rritjen e cilësisë profesionale të gjyqtarëve dhe të prokurorëve.

Lidhur me raportin e projektligjit me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, theksoj se ky projektligj hartohet në bazë e për zbatim të ndryshimeve kushtetuese dhe konkretisht në bazë të nenit 179/b të këtij akti, si dhe pjesës së aneksit “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe i prokurorëve”. Projektligji respekton parimin e kushtetutshmërisë dhe me standardet që vendosin aktet ndërkombëtare në lidhje me këtë fushë. Projektligji reflekton rekomandimet e opinionëve të Komisionit të Venecias për këtë çështje, të pasqyruara në aneksin e amendamenteve kushtetuese. Paketa kushtetuese mbi bazë dhe për zbatim të së cilës hartohet ky projektligj iu dërgua për një mendim të specializuar Komisionit të Venecias, i cili u shpreh me opinionin e ndërmjetëm dhe opinionin final në siglat përkatëse në relacion.

Në lidhje me masat e marra për procesin e rivlerësimit, Komisioni i Venecias është shprehur se “Është i mendimit që këto masa jo vetëm që janë të justifikuara, por janë të nevojshme që Shqipëria të mbrohet nga korrupsioni, i cili nëse nuk trajtohet mund të shkatërrojë plotësisht sistemin gjyqësor. E gjithë skema është më e qartë dhe jep garanci më të mira për individët që mund të preken nga vlerësimi. Projektligji është në përputhje të plotë me dokumentet e strategjisë së reformës në sistemin e drejtësisë dhe analizën e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, të cilat janë miratuar nga Komisioni i Posaçëm për Reformën në Drejtësi. Në këto dokumente janë parashtruar konkluzionet, objektivat dhe detyrat për konsolidimin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së gjyqtarëve dhe të prokurorëve në sistemin e drejtësisë. Projektligji është harmonizuar me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe referohet në disa ligje që rregullojnë çështje në fusha të ngjashme. Ai është romanizuar edhe me projektligje të tjera që janë hartuar dhe do të miratohen në mbështetje të paketës kushtetuese.”

Lidhur me përparësitë që vendos dhe efektet e pritshme të projektligjit. Aktualisht, sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve ka rezultuar i paaftë për të identifikuar

dhe nxjerrë jashtë sistemit të elementëve të korruptuar ose të papërgatitur profesionalisht, për këtë arsye vlerësimi profesional i gjyqtarëve dhe i prokurorëve bëhet një kusht i domosdoshëm për realizimin e objektivave që kërkojnë ndryshimet kushtetuese dhe dokumentet analitike të reformës në drejtësi.

Ky projektligj ngre institucionet që do të kryejnë rivlerësimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe parashikon procedurat e posaçme për vlerësimin e tyre. Nga natyra e tij ai është një projektligj i posaçëm me fuqi të përkohshme deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve, të prokurorëve, si dhe të subjekteve të tjera të parashikuara nga Kushtetuta. Nga zbatimi i këtij ligji do të forcohet dhe do të rritet profesionalizmi dhe ndershmëria në sistemin e drejtësisë, si dhe do të reduktohet korrupsioni në radhët e tij. Për kryerjen e procesit të rivlerësimit krijohet një komision i pavarur i kualifikimit, më poshtë do ta quaj thjesht komisioni, që do të bëjë vlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe të prokurorëve, pavarësisht nivelit dhe juridiksionit. Ai do të ketë mandat të kufizuar për 5 vjet. Anëtarët e komisionit do të jenë juristë, të cilët kanë përvojë të gjatë të paktën 15 vjet, si: gjyqtarë, prokurorë, avokat ose profesorë të së drejtës, si dhe që gëzojnë reputacion të lartë.

Vendimet e komisionit mund të ankimohen nga subjekti i rivlerësimit ose komisioneri publik. Ankimi do të shqyrtohet nga Kolegji i Posaçëm i Kualifikimit pranë Gjykatës Kushtetutës, më poshtë do ta quaj thjesht Kolegji i Apelit. I gjithë procesi i rivlerësimit do të kryhet nën mbikëqyrjen e vëzhguesve ndërkombëtarë me qëllim rritjen e besueshmërisë ndaj procesit. Vëzhguesit ndërkombëtarë që do të kenë akses në dosjet e gjyqtarëve dhe të prokurorëve do të mbikëqyrin të gjithë procesin vendimmarrës, do ta asistojnë procesin në të gjitha shkallët dhe nivelet me qëllim garantimin e procesit dhe parandalimin e korrupsionit. Brenda Komisionit dhe Kolegjit të Apelit anëtarët e tij do të kenë një trajtim të veçantë dhe do t'u garantohet një mbrojtje e posaçme. Procesit i rivlerësimit do të përfshijë kontrollin tërësor të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në tre komponentë: pasuritë e gjyqtarëve, të prokurorëve dhe të subjekteve të tjera, zbulimin ose identifikimin e lidhjeve të tyre me krimin e organizuar, vlerësimin e punës së kryer, si dhe aftësitë e tyre profesionale. Nëse rezultati përfundimtar i njërit prej komponentëve ose vlerësimi tërësor i të tre komponentëve rezulton i pamjaftueshëm, Komisioni ose Kolegji i Apelit do të vendosë detyrimin e subjektit që të rivlerësohet, të ndjekë programin e posaçëm për riaftësim pranë Shkollës së Magjistraturës për 1 vit dhe nëse subjekti merr vlerësimin negativ, këto organe vendosin deri në largimin e tij nga detyra.

Ky projektligj do të kryejë për herë të parë një vlerësim tërësor të gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe pritshmëritë janë rritja e përgjegjësisë profesionale dhe etike e të gjitha

subjekteve që do të rivlerësohen, e për rrjedhojë përmirësimi i cilësisë së sistemit të drejtësisë në vend. Lidhur me vlerësimin e shkallës së përafrimit me *acquis communautaire*, projektligji nuk a përafrim me *acquis communautaire*.

Projektligji përbëhet nga kreu i parë. Ky kre përcakton dispozita të përgjithshme që përfshijnë objektin, qëllimin dhe përkufizimin e termave të përdorura në projektligj, si dhe parimet bazë të procesit të rivlerësimit. Në këtë kre përcaktohen tre komponentët e procesit të rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

Kreu i dytë dhe i tretë, rregullojnë mënyrën e krijimit të organeve përgjegjëse në procesin e rivlerësimit në përputhje me parashikimin në aneksin e Kushtetutës. Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të organeve bëhet nëpërmjet një procedure të hapur dhe transparente, e cila administrohet nga Avokati i Popullit. Ky i fundit kontrollon përmbushjen e kërkesave formale dhe ligjore të aplikuesve dhe krijon një listë emërore. Krahas Avokatit të Popullit kjo listë verifikohet edhe nga operacioni ndërkombëtar i monitorimit që ka të drejtë të përditësojë listën emërore. Listën përfundimtare Avokati i Popullit ia paraqet Kuvendit.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në përputhje me dispozitat kushtetuese, duke parashikuar edhe një mekanizëm zhbllokues në rast se Kuvendi nuk arrin shumicën e kërkuar për votimin e kandidatëve. Në këtë rast zgjedhja kryhet me anën e shortit manual publik, i cili organizohet nga Presidenti i Republikës. Procedura e mësipërme garanton jo vetëm paanshmërinë dhe besueshmërinë në përzgjedhjen e anëtarëve, por edhe një nivel të lartë profesionalizmi. Projektligji rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve të rivlerësimit, Komisionin e Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjin e Posaçëm të Kualifikimit. Komisionerët publikë kanë një rol të rëndësishëm për të siguruar mbrojtjen e interesave të publikut në të gjithë procesin, si dhe parimin e kontradiktoritetit në të. Operacioni ndërkombëtar i monitorimit monitoron dhe ndihmon me gjetjet e tij organet e rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit.

Ndryshimet kushtetuese kanë parashikuar që komisioni do të shqyrtojë në trupa gjykuese të përbëra nga tre anëtarë. Trupi gjykues do të drejtohet nga kryetari, i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve të tij për një periudhë 1-vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje. Kryetari i trupit gjykues kryen drejtimin e mbledhjes, caktimin e shortit dhe koordinimin e punës në tërësi. Për çdo çështje që shqyrtohet zgjidhet një relator, i cili është pjesë e trupit gjykues. Ai përgatit dosjen për subjektin e rivlerësimit, sipas secilit komponent, heton për çështjen duke mbledhur provat e nevojshme dhe në përfundim përgatit një relacion, duke propozuar masa konkrete disiplinore për subjektin e rivlerësimit.

Kolegji i Apelimit është organi që do të shqyrtojë ankimet ndaj vendimeve të komisionit. Ai vendoset pranë Gjykatës Kushtetuese, i përbërë nga 7 gjyqtarë dhe gjykon me trupa gjyqësore të përbëra nga 5 anëtarë. Në zbatim të dispozitave kushtetuese Kolegji i Apelimit do të shërbejë për një periudhë 9-vjeçare dhe do të kryejë edhe detyrën e organit disiplinor për anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu, ky kolegji do të shqyrtojë ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë. Komisionerët publikë kanë një rol të rëndësishëm për të siguruar mbrojtjen e interesave të publikut në të gjithë procesin, si dhe parimin e kontradiktoritetit në të.

Operacioni ndërkombëtar i monitorimit, monitoron dhe ndihmon organet e rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit. Projektligji parashikon rastet e zëvendësimit të anëtarit, i cili ka përfunduar mandatin ose është shkarkuar, si dhe ka sanksionuar kryerjen e kësaj procedure sipas të njëjtave rregullave dhe, sikurse procedura e emërimit. Anëtarët e institucioneve gjatë ushtrimit të detyrës udhëhiqen nga parimi i paanshmërisë dhe konfidencialitetit, ata shmangin çdo situatë konflikti, interesi gjatë procesit të vlerësimit.

Gjithashtu, anëtarët e institucioneve dhe personeli janë subjekt i deklarimit të pasurive sipas ligjit “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”. Telekomunikimet dhe të dhënat e tyre financiare do të jenë subjekt i monitorimit nga autoritetet përgjegjëse, sipas procedurave të posaçme që parashikon ky ligj. Anëtarëve të institucioneve, familjarëve të tyre, personelit dhe vëzhguesve ndërkombëtarë projektligji ju garanton edhe një mbrojtje të posaçme, sipas legjislacionit në fuqi.

Në projektligj parashikohet përgjegjësia disiplinore e anëtarëve të institucioneve si një element i rëndësishëm në llogaridhënien e tyre. Rastet e shkarkimit të anëtarëve janë përcaktuar në Kushtetutë dhe në ligjin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Në ndryshim nga rregulli i përgjithshëm për fillimin e procedurës disiplinore për anëtarët e institucioneve, hetimi disiplinor mund të fillojë nga çdo komisioner, për anëtarët e komisionit nga çdo gjyqtar për gjyqtarët dhe nga vëzhgues si për komisionerët dhe për gjyqtarët. Projektligji ka parashikuar se trupi gjykues do të ndihmohet nga njësi e shërbimit ligjor që konsiston në këshilltar ligjorë dhe ekonomikë. Ai cakton shprehimisht detyrat dhe procedurat e rekrutimit dhe mënyrën e rregullimit të marrëdhënieve të punësimit. Në personel bën pjesë edhe një punonjës si person i autorizuar për të komunikuar me publikun dhe me median.

Gjithashtu, një rol të rëndësishëm në administrimin e personelit të institucioneve do të ketë sekretari i Përgjithshëm, që përzgjidhet nga radhët e juristëve me një nivel të lartë profesionalizmi dhe integriteti nëpërmjet një procedure të hapur dhe transparente.

Kreu i katërt. Ky kre parashikon rregullat mbi bazën e të cilave do të kryhet rivlerësimi pasuror. Objekti i rivlerësimit pasuror përfshin deklarin dhe kontrollin e pasurive të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, përmbushjes së detyrimeve financiare duke përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Rivlerësimi sipas këtij komponenti pasuror, do të fillojë menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij ligji. Të gjitha subjektet e rivlerësimit duhet të dorëzojnë përpara 30 ditëve pranë ILDKP-së formularin e deklarin të pasurive, sipas parashikimeve në aneksin e këtij projektligji. Subjektet e rivlerësimit janë të detyruara që krahas formularit të deklarin të pasurive të dorëzojnë të gjitha dokumentet që provojnë ligjshmërinë e pasurive të tyre. Këtë detyrim e mbartin edhe personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit në rast se konfirmojnë marrëdhënien me to. Autoriteti përgjegjës për përpunimin e të dhënave të formularëve të deklarin të pasurive do të jetë ILDKP, i cili do të nisë menjëherë kontrollin dhe verifikimin e të dhënave të deklaruara nga subjekti në përputhje me ligjin e posaçëm dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundim të këtij procesi nga ILDKP-ja do të përpilohet një raport në të cilin vlerësohet saktësia apo pavërtetësia e deklarin, si dhe nëse ekzistojnë kushte të konfliktit të interesit.

Kreu i pestë. Ky kre sanksionon rregullat mbi bazën e të cilave do të kryhet kontrolli i figurës. Ky kontroll do të konsistojë në verifikimin e deklarimeve të dhëna nga subjektet e rivlerësimit me qëllim identifikimin e kontakteve të papërshtatshme nëse ekzistojnë të tilla, midis subjektit me persona të përfshirë në krimin e organizuar për periudhën e parashikuar në nenin “dh” të aneks Kushtetutës së ndryshuar.

Autoriteti përgjegjës për përpunimin e të dhënave të formularit për kontrollin e figurës do të jetë Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), që do të veprojë në bashkëpunim me Komisionin dhe Kolegjin e Apelimit. Gjithashtu, krijohet edhe grup pune së bashku me përfaqësuesit e Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm pranë Ministrisë së Brendshme. Projektligji sanksionon në mënyrë të detajuar standardin mbi bazën e të cilit do të bëhet kontrolli i figurës. Në përfundim të këtij procesi DSIK-ja, duhet të përpilojë një raport-dokument publik në të cilin konstaton vërtetësinë ose jo të të dhënave, si dhe nëse subjekti i kontrolluar ka pasur ose jo kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Kreu i gjashtë. Ky kre sanksionon rregullat mbi bazën e të cilave do të kryhet vlerësimi i aftësive profesionale. Për këtë do të kryhet vlerësimi i veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit në përputhje me standardet e përcaktuara në këtë projektligj dhe në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve”. Projektligji ka parashikuar në mënyrë specifike burimet e rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas kategorive të caktuara të subjekteve të rivlerësimit duke u rivlerësuar në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”. Procesi i rivlerësimit të aftësive profesionale, do të përfshijë si periudhë vlerësimi tre vitet e fundit të ushtrimit të detyrës. Inspektorët rishikojnë dokumentet ligjore të hartuara nga subjekti i vlerësimit gjatë periudhës, objekti i rivlerësimit dhe bazuar në gjetjet përkatëse ata përgatisin një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar dhe ky raport i paraqitet komisionit. Ndërsa për prokurorin e Përgjithshëm si burim vlerësimi do të shërbejë performanca e tre vjetëve të fundit në përmbushjen e detyrave të përcaktuara në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”.

Për sa u përket subjekteve që nuk u janë nënshtruar asnjëherë vlerësimit të aftësive profesionale ose që nuk janë magjistratë, pjesë e vlerësimit krahas dokumenteve ligjore që ata kanë prodhuar, do të jetë edhe kalimi me sukses i provimit të kalimit në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale organet e vlerësimit profesional hartojnë një raport që ia drejtojnë komisionit. Mbështetur në këtë raport, edhe nga burimet e tjera relatori i çështjes pranë komisioni konstaton nëse subjekti i rivlerësimit është i aftë, me mangësi ose i papërshtatshëm.

Kreu i tetë. Ky kre rregullon procesin e rivlerësimit. Procesi i rivlerësimit është një procedurë disiplinore e procesit gjyqësor administrativ, konkretisht referuar në nenin “ë” dhe në nenin “f” të aneksit të Kushtetutës, i ndryshuar, të cilat gjejnë zbatim në këtë kapitull. Procesi i rivlerësimit kalon në dy shkallë gjykimi. Shkalla e parë e shqyrtimit është Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse shkalla e dytë është Kolegji i Posaçëm i Apelit. Në këtë proces rregullohet ushtrimi i veprimtarisë së vëzhguesit ndërkombëtar si një strukturë që ndihmon këto institucione në arritjen e një vendimmarrje të drejtë dhe të paanshme ndaj subjektit të rivlerësimit. Në këtë kuptim, anëtarët e Komisionit të Kolegjit të Apelit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë kanë të drejta të barabarta gjatë fazës së hetimit administrativ, për të mbledhur dhe administruar prova që vërtetojnë veprimet, faktet ose një situatë subjektive të nevojshme për realizimin e hetimeve. Për këtë qëllim atyre u është dhënë e drejta për akses të plotë në të gjitha institucionet private dhe publike, vendase ose të huaja për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve të bëra nga subjektet e rivlerësimit. Në rastin kur institucioni shtetëror privat brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës për dhënien e

informacionit, refuzon për të bashkëpunuar ose vonon dhënien e përgjigjes, apo shfaq sjellje të papërshtatshme për të dhënë informacionin e kërkuar, institucionet kanë të drejtë të raportojnë pranë zyrës së prokurorisë si vepër penale, sipas nenit 248 të Kodit Penal.

Në procesin e të provuarit që i është kushtuar rregullim-denoncimit të fakteve nga publiku, që mund të përbëjnë prova për një komponentët e rivlerësimit, çdo person ka të drejtë të sinjalizojë institucionet, për fakte apo prova konkrete me kusht që t'i ruhet anonimati. Komisioni ose Kolegji i Apelit nëse konstatojnë që veprimi apo praktika e raportuar përmban shkaqe mund të fillojë hetimin kryesisht për të. Në tërësinë e provave, gjetja e dhënë nga vëzhguesit ndërkombëtarë përbën një provë thelbësore, refuzimi i së cilës i detyron organet të japin një vendim me shkrim mbi shkaqet e refuzimit. Projektligji parashikon afate për zhvillimin e procesit të rivlerësimit në përputhje me kushtet sociale në interes të subjekteve të rivlerësimit. Afatet kohore për dorëzimin e formularit të deklaramit të pasurisë dhe të kontrollit të figurës janë caktuar të fillojnë brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij projektligji. Strukturat përkatëse në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave nga dokumentet zyrtare duhet të procedojnë pa vonesë për t'ia dërguar komisionit, i cili është hallka e parë e shqyrtimit të tyre. Për sa i takon mënyrës se si subjektet e rivlerësimit do të njoftohen në vijimësi të procesit, është vendosur njoftimi nëpërmjet adresës elektronike si mënyra primare e njoftimit, ndërkohë që nuk janë përjashtuar edhe mënyra të tjera alternative që parashikon Kodi i Procedurave Administrative.

Projektligji, në përputhje me parashikimet kushtetuese, ka përcaktuar se barrën e provës, e cila nënkupton detyrimin për të provuar ligjshmërinë e deklaramit, e ka subjekti i rivlerësimit. Në disa raste subjekti i rivlerësimit mund të ketë interes në vonimin e procedurave të rivlerësimit. Për të shmangur këto praktika të gabuara ligji i lejon organet që në marrjen e vendimit të mbajnë parasysh gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit. Subjektit të rivlerësimit i jepet e drejta të dëgjohet lidhur me përfundimet e konstatuara nga relatori i çështjes. Për këtë zhvillohet seanca dëgjimore në prani të publikut. Në përfundim të tyre komisioni jep vendimin për subjektin e rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të japë dorëheqjen deri përpara se të jepet vendimi përfundimtar në seancën dëgjimore. Në këtë rast ndaj subjektit pushohet procedura e rivlerësimit dhe në përputhje me këtë projektligj dhe nenin "g" të aneksit të Kushtetutës subjektit i akordohet pension i veçantë. Subjektet që japin dorëheqjen nuk kanë të drejtë të emërohen për një periudhë të përcaktuar në asnjë prej organeve të sistemit të drejtësisë, siç parashikohet në këtë ligj. Këto subjekte nuk kanë pengesa për t'u punësuar në administratën publike për sa kohë ligjet e posaçme nuk kanë kufizime. Nenet e këtij kreu përcaktojnë në

mënyrë të detajuar shkaqet për marrjen e masave disiplinore. Në çdo rast komisioni është i detyruar të arsyetojë vendimet e tij lidhur me shkaqet e dhënies ose jo të masës disiplinore. Në rast se subjekti i vlerësimit ka ushtruar ankim ndaj vendimit të komisionit për shkarkim nga puna ai pezullohet nga detyra, që do të thotë, se ai nuk ka të drejtë të gjykojë çështje, por mund të ketë akses në zyrën e tij, përfshirë në adresën elektronike zyrtare me qëllim që të njoftohet mbi ecurinë e procesit të rivlerësimit.

Kreu i tetë. Ky kre parashikon rregulla mbi shqyrtimin e ankimit ndaj vendimit të komisionit. Projektligji parashikon se mjetet dhe afatet e ankimit të këtyre vendimeve do të jenë të njëjta me ato që parashikohen në ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj. Të drejtën për të ushtruar ankim ndaj vendimit të komisionit e kanë subjekti i rivlerësimit dhe komisioneri publik. Afati brenda të cilit palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankim është 15 ditë nga marrja në dijeni për vendimin, por në rast se humbet ky afat për shkaqe të arsyeshme dhe legjitime, palët kanë të drejtë të kërkojnë rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit brenda 15 ditëve nga dita që vihen në dijeni të shkakut të humbjes të së drejtës, por jo më vonë se afati i parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës. Për sa u përket kërkesave që duhet të plotësojë ankimi dhe akteve që i bashkëlidhen atij, projektligji referon në dispozitat përkatëse të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Gjithashtu, këtu përcaktohen edhe detyrimet e subjektit të rivlerësimit apo të komisionerit publik në momentin e depozitimit të ankimit, si dhe veprime, të cilat ai është i detyruar t'i kryejë. Trupi gjykues i Kolegjit të Apelit shqyrton mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi dhe në seancë gjyqësore në prani të palëve kur e sheh të nevojshme në përputhje me rregullimet e këtij ligji. Përrjashtim nga ky rregull përbën kur ankimi është ushtruar në komisionin jopublik, në këtë rast trupi gjykues e shqyrton në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për sa u përket rregullave për zhvillimin e seancës gjyqësore, projektligji referon në dispozitat përkatëse të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, për aq sa ato janë të pajtueshme me këtë ligj.

Në përfundim të vendimit të komisionit të ndryshimit e vendimit të komisionit ose prishjen e vendimit të komisionit, vendimi dhe shkarkimi nga detyra i dhënë nga Kolegji i Apelit është vendim i formës së prerë. Subjekti i rivlerësimit, sipas nenit “f” të aneks Kushtetutës gëzon të drejtën për t'iu drejtuar GJEDNJ-së apo Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut.

Kreu nëntë. Ky kre përmban përcaktimet tranzitore, të cilat lidhen me fillimin e funksionimit të organeve të rivlerësimit. Është parashikuar që fillimisht komisioni të ketë zyra pranë Ministrisë së Drejtësisë, Komisioneri Publik pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese. Fondet për funksionimin e këtyre institucioneve do të mbulohen nga buxheti i shtetit dhe secili nga institucionet do të paraqesë çdo vit kërkesë pranë Ministrisë së Financave. Kontrolli financiar do të kryhet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Janë përcaktuar dispozita kalimtare lidhur me procedurën e vlerësimit të aftësive profesionale duke parashikuar modalitetet e kalimit të raporteve të vlerësimit të kryera nga institucionet ekzistuese, pranë institucioneve të krijuara me këtë ligj.

Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e projektligjit. Për zbatimin e këtij projektligji do të krijohen institucionet e reja si vijon: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Komisioneri Publik, Kolegji i Posaçëm i Apelit. Gjithashtu, për zbatim të projektligjit ngarkohen institucionet ekzistuese si vijon: Kuvendi, Presidenti i Republikës, Inspektorati i Lartë i Deklarimit, Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Avokati i Popullit, Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, Shërbimi Informativ Shtetëror e të tjera. Projektligji detyron institucionet private dhe publike si bankat, noterët, Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Ministrinë e Drejtësisë, organet ekzistuese të sistemit të drejtësisë e të tjerë, që të bashkëpunojnë me institucionet e rivlerësimit për mbledhjen e të dhënave dhe shërbimeve të nevojshme në zbatim të projektligjit.

Personat dhe institucionet që kanë kontribuar për hartimin e projektligjit. Projektligji u hartua nga ekspertët e nivelit të lartë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi. Grupi i punës për hartimin e këtij ligji e filloi punën në shkurt të vitit 2016, dokumenti bazë i punës së grupit, ka qenë drafti i hartuar nga ekspertët e EURALIUS-it dhe OPDATI-it. Projekti i parë i hartuar nga ekspertët është paraqitur përpara grupit të punës së përbërë nga përfaqësuesit e institucioneve dhe ekspertëve të opozitës. Përfaqësuesit e institucioneve, ekspertët e opozitës, si dhe ekspertët e tjerë kanë dhënë ndihmesën e tyre për plotësimin dhe përmirësimin e projektit. Projektligji është hartuar në gjuhën angleze dhe shqipe.

Përmbajtja e ligjit në veçanti nga ligjet e tjera, është monitoruar drejtpërdrejtë nga Komisioni Europian, përfaqësues të *Digi Near* dhe *Digi Justice*. Për këtë arsye përfaqësues të misionit EURALIUS kanë zhvilluar seanca të përbashkëta pune me përfaqësuesit e Komisionit Europian për sa i takon pjesës që lidhet me misionin ndërkombëtar të monitorimit, si dhe angazhimin e tij në faza të ndryshme të procesit të rivlerësimit. Aspekte të

caktuara të ligjit janë konsultuar në mënyrë të vazhdueshme edhe me ekspertët e Komisionit të Venecias. Ky konsultim ka nisur që në hartimin e draftit të parë të ligjit dhe më tej ka vazhduar me diskutime gjatë qëndrimit të tyre në Tiranë në nëntor 2015, në janar 2016 dhe në seancat plenare të komisionit.

Anëtarët e grupit të *think tank*-ut, duke përfshirë përfaqësuesit e opozitës, kanë dhënë kontributin e tyre brenda afatit të kërkuar dhe për të gjitha çështjet e kërkuara. Sekretariati teknik ka përfshirë kontributet e anëtarëve në tekst, se anëtarët e grupit kanë paraqitur komentet që janë pasqyruar në draft. Gjithashtu, një ekspert nga Komisioni Europian që vizitoi Shqipërinë në datat 7-9 qershor ka drejtuar dhe komentuar draftin e ripunuar. Një ndihmesë të rëndësishme ka ofruar edhe tryeza e konsultimit e zhvilluar në datën 1 korrik 2016, mbi të cilën janë përmirësuar disa dispozita lidhur me procesin e rivlerësimit.

Lidhur me raportin e vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, projektligji parashikohet të sjellë efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, duke marrë parasysh institucionet që do të krijohen në funksion të këtij ligji është e nevojshme hartimi i një raporti të vlerësimit të të ardhurave nga ana e Ministrisë së Financave, në përputhje me nevojën infrastrukturore dhe burimeve njerëzore që kërkon zbatimi i këtij ligji.

Ky ishte relacioni që unë kisha përgatitur për Komisionin e nderuar të Reformës së Drejtësisë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Majko, për vlerësimin tuaj!

Ishte një parashtrësë e detajuar e gjithë përmbajtjes së projektligjit, e cila është jo thjesht dhe vetëm rezultat i ligjit, por dhe fakti i shqyrtimit që kemi bërë në seancën e mëparshme, të paraqitjes së ligjit, pyetjeve që janë bërë nga ju dhe nga kolegët deputetë, qëndrimeve që janë mbajtur në atë seancë, natyrisht edhe votimit përkatës. Kështu që besoj se biem dakord të gjithë të kalojmë në shqyrtimin nen për nen të projektligjit.

Edhe në vlerësimin tim, besoj se do të jetë pak më lehtë, në sensin e të shkruarit. Në vlerësimin tim personal është një projektligj i shkruar mirë dhe dua t'i komplementoj të gjithë ata që kanë punuar, edhe ata që punuan drejtpërsëdrejti në anglisht, edhe ata që punuan drejtpërsëdrejti shqip duke e kthyer në anglisht. Pa dyshim, duke qenë se është një ligj i rëndësishëm, sikurse e thashë edhe një ligj delikat edhe për shkak të mungesës të një pasurie modelesh, jo thjesht në vendin tonë, në rajon, por edhe më gjerë, por edhe faktit që ndërthuren shumë çështje sensitive që kanë të bëjnë me statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, që kanë të bëjnë me proceset e vlerësimeve të tyre, që kanë të bëjnë me të

drejtat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, por edhe me të dhënat sensitive që administrohen apo përdoren në raste të tilla. Pra, janë një mori çështjesh delikate që e bëjnë të rëndësishëm shqyrtimin e këtij projekti që është një nga projektet kyç do të thosha unë, më të mirëpritur nga të gjithë në gjithë tërësinë e projektligjeve të reformës në drejtësi.

Natyrisht, është një projektligj që do të shoqërohet jo me pak debate në momentin e zbatimit të tij, dhe sa më i qartë të jetë, sa më i detajuar të jetë aq më i mirë, aq më i lehtë do të jetë për ligjzbatuesit dhe nuk do të ngurojmë në asnjë rast. Ky është një ligj ku lejohen detajet dhe mendoj që është një gjë pozitive për ta bërë këtë gjë, sepse ato mund të na ndihmojnë, ndryshe nga ligjet e tjera ku vetë ligji mund të kërkojë kohën e nevojshme për të krijuar praktika të shëndetshme apo për të pasur akte nënligjore, ky është një ligj që i ngërthen të dyja edhe për shkak të kohës së kufizuar që ka dhe faktit që fokusohet vetëm në këto institucione që janë këtu gjithë përgjegjësia e procesit.

Po më e mira është të fillojmë dhe duke ecur do të shohim se çfarë problemesh kanë nevojë që të trajtohen. Fillimisht dua të sqaroj edhe diçka tjetër, nenet që kanë të bëjnë me formatimin e institucioneve ne do t'i marrim të mirëqena me projektin kushtetues që është dorëzuar në Kuvend. Nëse do të ketë ndryshime në projektin kushtetues ato do t'i reflektojnë, prandaj do t'i miratojmë si të tilla, këtë e theksoj, për t'u mbajtur në vëmendje nga kolegët deputetë, për të evituar çdo lloj keqkuptimi, por njëkohësisht edhe për efekt për t'u regjistruar, për të nënvizuar idenë që ne jemi të hapur për ndryshimet e mëpastajme.

Do t'i lutesha sekretariatit teknik që të jetë i vëmendshëm për të ndjekur çështjet që do të ngelen për t'u reflektuar apo të hapura për t'u diskutuar nëse do të ketë të tilla.

Atëherë fillojmë me nenin 1, "Qëllimi".

Kemi gjë?

Pandeli Majko – Jo, nuk kemi.

Fatmir Xhafaj – Po.

Vasilika Hysi – Vetëm një fjalë. Të shtohet fjala: "Sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës".

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Po nga pikëpamja e terminologjisë, profesorëshë? Dakord.

Neni 2, "Objekti i ligjit".

A kemi gjë? Nga pikëpamja teknike pse e keni ndarë 1, 2, 3 dhe 4.

Vasilika Hysi – E kanë të gjitha ligjet e reja këtë.

Fatmir Xhafaj – Pse e keni ndarë ky ligj përcakton 1, 2, 3...?

Aurela Anastasi – Po ngaqë janë subjekte të ndryshme, parimet veç, metodologjia, procedurat dhe standardet veç, organizim dhe funksionim veç.

Praktikisht...

Fatmir Xhafaj – Mund ta çoni në katër rolin e operacionit ndërkombëtar?

Aurela Anastasi – Po, edhe mund ta çojmë.

Fatmir Xhafaj – Nëse rrinë...

Aurela Anastasi – Nëse do ta vëmë më shumë në dukje, absolutisht që duhet ta çojmë.

(Diskutime pa mikrofon)

Nëse ne e konsiderojmë njësoj si të tjerat...

Fatmir Xhafaj – Mendoj që do të duhet ta përcaktojmë në mënyrë që ta kuptojnë...

Aurela Anastasi – Ta vëmë në dukje. Dakord.

Fatmir Xhafaj – Neni 3 “Përkufizime”.

Zonja Hysi, keni gjë?

Vasilika Hysi – Po.

Fatmir Xhafaj – Isha i bindur për këtë gjë. Mbas jush e kam radhën vetë.

Vasilika Hysi – Gjëja e parë një herë për t’i renditur sipas alfabetit.

E dyta, lidhur me “personin e lidhur”, në pikën 7. Duhet thënë: “Personi i lidhur është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin, komisionarin publik i përbërë nga bashkëshorti/bashkëshortja, bashkëjetuesi/bashkëjetuesja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër i përmendur në certifikatë”, duke hequr pjesën “duke përfshirë”, si dhe te pika 10 ku thuhet “të ardhurat e ligjshme”. Kam një pyetje. Ligji i vitit 1998 “Mbi të ardhurat”, me aq sa unë di, ka ndryshuar. Atëherë, nëse ka ndryshuar të themi: “Ligji mbi të ardhurat, ligji në fuqi në momentin që bëhet vlerësimi”. Pra, që të mos citojmë të gjitha ligjet e tjera që mund ta kenë ndryshuar këtë ligj në paragrafin e katërt të legjislacionit në fuqi “Mbi të ardhurat”.

Gjithashtu, te marrëdhëniet e biznesit. Në dijeninë time ligjin “Për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit” ne e kemi ndryshuar dhe për të shmangur këtë mund të themi: “Edhe në dispozitat për ligjin “Për parandalimin dhe pastrimin e parave, financimin e terrorizmit”, që është në fuqi”, që ta shmangim.

Kam një pyetje tashmë për pikën 12. Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, nuk është i Kodit Penal. Pra, neni 75/a është i Kodit të Procedurës Penale? Ne e kemi ndryshuar, sepse kemi futur edhe veprat e reja penale të korrupsionit etj.

Një pyetje kam: trafikimi është pjesë e krimit të organizuar? Pse duhet ta citojmë më vete, kemi ndonjë qëllim?

Gjithashtu, do të doja të thosha se në pikën 13, ju keni përfshirë kultivimin e drogës. Në fakt, neni 283, paragrafi i parë i Kodit Penal, përfshin shitjen, mbajtjen, pra ka shumë elemente edhe të personave, të cilët kanë doza të vogla, por jo për përdorim vetjak. Në këtë rast, edhe këta persona do të citohen? Nëse ka një arsye thjesht për të parë lidhjet, jam dakord.

Nga ana tjetër, “kontakt i papërshtatshëm” është cituar qoftë takim, telefonatë, apo çfarëdolloj mënyre tjetër e qëllimshme, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës, pavarësisht nëse vendos marrëdhënie biznesi, do të thosha në kuptim të pikës 11 të këtij neni. Duhet saktësuar që bëhet fjalë për pikën 11 të këtij neni.

Gjithashtu, te Organi i Vlerësimit të Aftësive Profesionale, ju përmendni ligjin “Për organizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”. Ne këtë ligj do ta shfuqizojmë, sepse te ligjet që sapo mbaruam, thamë që ky ligj shfuqizohet. Duhet ta zgjidhim për periudhën tranzitore.

Gjithashtu, ligjin për ILDKPI-në, paragrafi 18, ILDKPI-ja, e kemi ndryshuar. Ndaj, për të shmangur çdo lloj ndryshimi që është bërë dhe do t’i bëhet këtij ligji, sepse e keni pjesë të paketës së ndryshimeve, unë do të sugjeroja që t’i referohemi ILDKPI-së, inspektoratit që rregullohet me ligjin mbi deklarimin kontrollit të pasurive që është në fuqi. Gjithmonë duhet ta shmangim.

Ndërkohë, do të doja edhe një herë të kthehesha te neni 23 “Trust”. Në dijeninë time, nga sa më kujtohet, ne këtë ligj e kemi ndryshuar në vitin 2010 “Për parandalimin e pastrimit të parave të financimit të terrorizmit”, ndaj edhe këtu duhet të shmangim nenet ose duhet të themi “i ndryshuar”, por do të ndodhë që sa herë të ndryshojmë ligjin, t’i kthehemi edhe ligjit bazë. Pyetja ime për pikën 23 është: për çfarë legjislacioni ndërkombëtar e keni fjalën? “Trusti” rregullohet te ligji ynë apo te legjislacioni ndërkombëtar sepse thoni “ose”? Mund të themi “si” “dhe” “ose”. Këto ishin.

Aurela Anastasi - Faleminderit për sugjerimet!

Ka qenë pikë debati, jo vetëm midis grupit tonë të punës, por edhe me ekspertë të grupeve të tjera të punës për ligjet, se çfarë qëndrimi do të mbajmë ndaj legjislacionit referues. Nëse duhet ta referojmë sa më saktë dhe ta shtojmë atë “i ndryshuar”, me qëllim që ligji të jetë i mirëreferuar, në këtë mënyrë do të ndihmonte çdo lexues, sepse lexuesi nuk di çfarë legjislacioni është në fuqi. Ndoshta ai që e zbaton po, por një tjetër që punon me këtë ligj në mënyrë të lidhur në funksion të një detyre të tij, ai ndihmohet shumë, dhe, për të qenë

sa më i kuptueshëm nga qytetarët në kuadrin e të drejtave të pjesëmarrjes, do të thosha se ndihmohet shumë nga referimi me numër dhe datë të ligjit.

Nga ana tjetër, lind problemi që ligji mund të ndryshojë jo vetëm sot, por mund të ndryshojë edhe në të ardhmen. Kështu që duhet të gjejmë një formulë të ndërmjetme ose të vëmë një titull të saktë që është në fuqi në çastin e kryerjes së rivlerësimit.

Në lidhje me pikën 16, kur i referohemi ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, do të thosha se, pavarësisht faktit se ky ligj do të shfuqizohet, ne kemi nene që rregullojnë marrëdhëniet midis institucioneve të vjetra dhe atyre të reja. Ne kemi ende referenca te ky ligj, ndaj edhe duhet ta ruajmë këtë lloj reference. Mendojmë se shqetësimi që ju ngritët, është shumë i drejtë, por a nuk mundet ta përfshijë/ekuivalentojë këtë terminologjia e fundit ose institucionet që mund t’i zëvendësojnë ato në vlerësimin profesional?

Këtu mund të shtojmë edhe referencat e reja, sepse kjo i mungon kësaj pike. Jemi referuar vetëm për ligjet e vjetra dhe nuk kemi bërë referenca te ligjet e reja.

Këto kisha, faleminderit!

Vasilika Hysi – Një pyetje kam për zotin Ranier, lidhur me pikën 14.

Ju falënderoj shumë, zoti Majko...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo për nenin 13, kultivimi i drogës. Është futur edhe neni 283 i Kodit Penal “Kultivimi i drogës nuk është patjetër krim i organizuar, por mund të jetë edhe një person që mbjell tre-katër rrënjë”. Dua që të mbeten rekord këtu. Edhe këta persona duhet të quhen si të përfshirë te krimi i organizuar? Sepse ky nuk është krim i organizuar: një zonjë, një nënë në fshat mbjell dy-tre rrënjë në bahçe apo në vazo, ose një person që i mbjell për përdorim vetjak. Këtu nuk kemi krim të organizuar.

Dispozita te ne, zonja Anastasi, është shumë e gjerë, është prodhimi, shitja, mbajtja etj. Paragrafi i dytë dhe i tretë është pjesë e krimit të organizimit dhe financimit, por e para është e përgjithshme dhe ne nuk e kemi ndryshuar ende, megjithëse ka pasur shumë kërkesa ose kritika për ta riformuluar.

Ranier Deville – *(Pa mikrofon)*

Aurela Anastasi – Natyrisht, ne do ta saktësojmë, sepse duam të qëndrojmë te krimi i organizuar dhe jo në rastet kur këto vepra penale janë kryer në mënyrë individuale nga persona.

Ranier Deville –*(përkthen përkthyesja)* Termi “Besim/Trust”, është një institut ligjor, i cili vjen fillimisht nga sistemi ligjor anglo-amerikan dhe përshkruan një numër

situatash ligjore, pra, është një term ligjor i ardhur nga këto vende. Nëse ju keni asete/prona jashtë, që i referohen sistemit britanik, ajo çfarë njerëzit do të kenë, do të jetë “besim”, që është një legjislacion i vjetër dhe ka lloje të ndryshme të tij, pra nuk është vetëm ai që jepet në legjislacionin shqiptar, por do të kontrollojmë gjithashtu edhe jashtë kufijve të Shqipërisë për të gjetur origjinën e këtij termi.

Fatmir Xhafaj – S’kanë gjetur dot fjalë shqip, besoj.

Vasilika Hysi – *Trust* është lënë?

Aulona Hazbiu – Është kontrolluar, dhe ky është termi “*Trust*”, i cili është referuar këtu dhe është marrë një përkufizim ligji aty.

Fatmir Xhafaj – Është te ligji përkatës?

Aulona Hazbiu – Po, dhe është kontrolluar kjo gjë.

Fatmir Xhafaj – Te neni 12 thoni: “Krimi i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni janë të gjitha vepra penale” sipas nenit 75/“a” të Kodit Penal. Përse e keni futur edhe ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar...”? Ai nuk e bën ndryshimin e kompetencës vendore. E ka Kodi Penal, dhe ai këtij kodi i referohet.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

S’ka rëndësi, rivlerësimi është për gjyqtarët dhe prokurorët dhe normalisht që i referohet vetëm nenit 75, nuk ka pse t’i referohet atij ligji.

Së dyti, “kontakt i papërshtatshëm”, është një takim, telefonatë, telekomunikim, vakt?

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Kur thua takim, thua edhe kur ha bukë, edhe kur pi kafe, edhe kur bën një....

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ranier Deville –*(përkthen përkthyesja)* Lidhet me të dhënat e mundshme që mund të kemi. Një gjykatës, i cili është në gjykatë në mëngjes, dhe një person i akuzuar në bankën e të akuzuarit për krim të organizuar, më vonë dalin, hanë drekë bashkë dhe....

Fatmir Xhafaj – Se ku bëhet takimi nuk ka rëndësi. Bëhet duke ngrënë, duke shëtitur. Ai mund të shëtisë në bulevard me personin, çfarë do t’i thoni – Ishe shëtitje? Takim është në thelb.

A kemi gjë tjetër për nenin 3? Dakord me ndryshimet.

Miratohet!

Neni 4.

Vasilika Hysi – Në pikën 3 ju thoni: “Procesi i rivlerësimit fillon menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij ligji”, pra, 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. Kur çështja është

gati për t'u shqyrtuar, institucionet e rivlerësimit vendosin brenda një afati sa më të shpejtë të mundshëm, pra edhe para...

Kam idenë se flasim për dy çështje të ndryshme.

Fatmir Xhafaj- Mos duhet thënë më mirë që procesi i rivlerësimit fillon menjëherë me konstituimin e institucioneve përkatëse? Sepse sipas ligjit, institucioneve mund t'u duhet tre muaj më mbrapa...

Na i sqaroni, nuk ka problem.

Ranier Deville –(përkthen përkthyesja) Procesi fillon me hyrjen në fuqi të ligjit, sepse duhen plotësuar tre anekset. Ne duam që ta bëjmë këtë gjë sa më shpejt që të jetë e mundur dhe nuk presim deri sa të konstituhet...

Fatmir Xhafaj- Prokurorëve ndërkohë iu shpërndahen anekset, apo jo? Kjo është logjika. Keni shumë të drejtë.

Ranier Deville –(përkthen përkthyesja)Janë anekse të ligjit.

Fatmir Xhafaj – Ndjekim 4 çështjet për rivlerësimin të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe prokurorin e Përgjithshëm, të cilët do të trajtohen paraprakisht nga institucionet e rivlerësimit. Do të thoni me prioritet?

Aurela Anastasi – Me përparësi.

Nuk e kemi përdorur atë fjalë, dhe unë mendoj që nuk mund ta përdorim. Me “përparësi” ose me “prioritet”, do të thotë t'i krijosh privilegje ose trajtim të diferencuar, që mund të merret edhe si diskriminim ndaj të tjerëve, kështu që “përparësi” do të thotë “më përpara në kohë se të tjerët”, që do të thotë “paraprakisht në raport me të tjerët”, ose do të themi “përparësi në kohë”, por jo “përparësi”.

Vasilika Hysi – Shumë mirë, ke të drejtë.

Aurela Anastasi – Ose do të themi “paraprakisht”. Ne zgjodhëm “paraprakisht” meqenëse juve ju pëlqen më shumë “përparësi në kohë”...

Fatmir Xhafaj - Nuk është çështje pëlqimi.

Aurela Anastasi – “Paraprakisht” do të thotë paraprakisht në raport me të tjerët me përparësi në kohë.

Vasilika Hysi – Jo, “paraprakisht”, mund të bëhet edhe shikim paraprak dhe t'i rikthehemi prapë.

Fatmir Xhafaj - Fjala “paraprake” ka kuptimin në shqip dhe kanotacion tjetër.

Aurela Anastasi – Dakord, e lëmë me “përparësi në kohë”. Ky do të ishte vlerësimi paraprak po të ishin dy vlerësime, por nuk ka dy.

Fatmir Xhafaj - Ky është koncepti i gjuhësisë, ju jeni profesoreshë. Unë tërhiqem.

Aurela Anastasi – Atëherë ne do të themi “ me përparësi në kohë”.

Vasilika Hysi - Ju thoni te pika 6 që institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe në ligjin për organizimin. Do të ndjekim edhe këtu rregullin që ky ligj ka ndryshuar dhe do të ndryshojë përsëri, sepse e keni në pjesën e paketës së ndryshimeve ligjore për të qenë korrektë?

Aurela Anastasi – Faleminderit për pyetjen!

Ne këtë standard e përcaktuam që te neni për përkufizimet dhe do ta ndjekim gjatë gjithë ligjit deri në nenin e fundit.

Fatmir Xhafaj - Dakord. Faleminderit!

Mbaruam me pikën e katërt me ndryshimet.

Neni 5. “Institucionet e rivlerësimit”.

Vasilika Hysi - Lidhur me germën “a”, shkelje disiplinore ndaj anëtarëve, është vetëm një shkallë dhe nuk ka ankimim. Pra neni 5, germa “a”, pika 2.

Aurela Anastasi - Këtu është mbajtur parasysh që të përcaktohet vetëm kompetenca që i shtohet kolegjit të apelimit.

Sa i përket procesit, është e sqaruar në Kushtetutë, në pikën 7 të nenit 179, kështu që e kemi aty të plotësuar. Nuk është qëllimi ynë ta përcaktojmë të gjithë procesin këtu, por kemi për qëllim të përcaktojmë vetëm atë çfarë kryen kolegji i apelimit.

Fatmir Xhafaj - Shkelje disiplinore “ndaj anëtarëve” apo “shkelje disiplinore të anëtarëve”?

Aurela Anastasi - Ne i jemi referuar Kushtetutës, dhe, në qoftë se duhet ta rregullojmë, këtë ndryshim duhet ta bëjmë edhe në Kushtetutë.

Fatmir Xhafaj – Mbajeni shënim po kaluam Kushtetutën. Po, zoti Ranier.

Ranier Deville – *(përkthen përkthyesja)* Problemi me apelimin vjen nga vendimi politik që nuk ekziston më gjykata për...ju keni gjyqin disiplinor. I referohemi...

Fatmir Xhafaj - Kemi gjë tjetër për nenin 5? Dakord me ndryshimet.

Neni 6 “Kriteret e zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit”.

Vasilika Hysi – Kam një pyetje lidhur me germën “d”. Ju thoni që ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për një kundërvajtje penale me dashje. Pra, për kryerjen e një krimi ju pranoni që mund të jetë kryer “me dashje ose nga pakujdesia”, ndërsa për kundërvajtjet penale, unë e kam kuptuar “vetëm me dashje”. E kam kuptuar qartë?

Aurela Anastasi – Po, besoj që është ajo.

Vasilika Hysi - Duhet ta saktësojmë, sepse del që edhe krimi, edhe kundërvajtja, do të jenë “vetëm me dashje”, pra, edhe po të jetë kryer një krim nga pakujdesia, nuk ka...

Aurela Anastasi - Këtë saktësimin e bën lidhëza “si, dhe” dhe ndahet nga sentenca më përpara “si dhe për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje”.

Vasilika Hysi – Ndërsa krimi duhet thënë “pavarësisht me dashje ose nga pakujdesia”...

Aurela Anastasi - Ta theksojmë edhe këtë?

Vasilika Hysi – Po, sepse të dalin vetëm “me dashje” të dyja.

Aurela Anastasi - Ne “me dashje” i jemi referuar vetëm kundërvajtjes, ndërsa “krimi është krim” në të gjitha rastet.

Vasilika Hysi – Jam shumë dakord me logjikën tuaj.

Në germën “ç” të pikës 2 ju thoni: “përvojë profesionale jashtë shtetit”. Cili është kuptimi?

Ranier Deville –(përkthen përkthyesja)Në këtë nen, ne selektojmë kriteret, të cilat mund të merren në konsideratë dhe kemi situatën në gjuhën shqipe që disa nga kandidatët kanë studiuar jashtë dhe kanë eksperiencë ndërkombëtare dhe e gjithë veprimtaria shkon së bashku me eksperiencën jashtë shtetit, kështu që të studiuarit jashtë shtetit është një kriter që duhet marrë në konsideratë. S’do të thotë që duhet pasur domosdoshmëri, por, nëse ekziston si kriter, atëherë është diçka esenciale që i duhet dhënë prioritet.

Vasilika Hysi – Mua më rezulton “përvojë profesionale”, punësim, jo shkollim, sepse të kesh shkollë jashtë nuk është përvojë profesionale, është edukimi. Përvojë profesionale, do të thotë të kesh punuar jashtë. Jam dakord me zotin Ranier, që mund të duhen të dyja dhe të vlerësohen si vlerë e shtuar, edhe një diplomë e nivelit jashtë, aq më tepër po të ketë punuar në ndonjë mision ndërkombëtar, në ndonjë organizatë ndërkombëtare në fushën e drejtësisë. pra, në vlerësimin tim, janë dy gjëra të ndryshme.

Aurela Anastasi –Ne mund të themi “përvojë studimesh” dhe “përvojë profesionale”.

Vasilika Hysi –Te ligji që kemi kaluar dje te organet e posaçme, kemi thënë “të ketë kryer studimet jashtë”, të ketë një diplomë të dytë nga universitetet e huaja, madje e kemi lënë “universitet në përgjithësi”. Do të sugjeroja që këshilltarët ta unifikojnë si terminologji.

Fatmir Xhafaj - Te pika 2, germa “d”, notat mesatare jo më pak se 8. Po ata që e kanë mbaruar jashtë?

Aurela Anastasi – Në fakt, për hir të së vërtetës, ne kemi pasur parasysh vetëm ata që kanë përfunduar studimet brenda vendit. Ndërsa për ata që kanë përfunduar jashtë, nuk

kemi vënë të tilla kritere. Nuk kemi vënë kufizim në mesatare. Normalisht, ekziston një skemë nga Ministria e Arsimit për të ekuivalentuar notat e tyre, sepse një mesatare 8 jashtë, vlen shumë më shumë sesa një mesatare 8 brenda vendit. Por ne e menduam që për ata të mos ketë kufizime në mesatare, dhe kufizimi i përcaktuar në mesatare për studimet brenda vendit është marrë e referuar nga mjaft legjislacione, përfshirë legjislacionin tonë për masterin në arsimin e lartë, me mesataren 8 hapen rrugët për Shkollën e Magjistraturës, dhe vetëm shkolla e avokatisë nuk ka mesatare.

Fatmir Xhafaj – Jam dakord, vetëm dua të di cila është ideja?..... (*nderprerje*)

Pse? Sepse mbartin një mentalitet tjetër ose më saktë atë mentalitet që së paku supozohet që është shumë dhe logjika të kërkon që për shkak të kulturës që marrin, formimin, praktikës, etj... Për këtë arsye do të preferoja të kemi një kriter preferencial për këta njerëz, që të kenë diplomë jashtë, të mund të ketë punuar në ndonjë zyrë avokatie jashtë, dhe që mund të jetë duke punuar jashtë. Një njeri që ka 5-6 vjet që punon në një zyrë avokatie në Gjermani, në Itali, ka një kulturë tjetër pune, nuk është mësuar me kulturën e bakshishit, nuk është mësuar me kulturën e ryshfetit, pra ka disa cilësi që janë të avantazuara që ne do të duhet t'i preferonim. Në fund të fundit, të vëmë disa kritere preferenciale, të cilat nuk bien në kundërshtim me Kushtetutën. Kushtet ligjore janë kushte, por në këtë rast të jenë preferenciale. Sidomos kur të vijë çështja të krijimi i administratës, aty duhet të jetë absolutisht preferenciale.

Faleminderit!

Miratohet me ndryshimet e sugjeruara.

Neni 7 “Procedura e zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit”.

Unë mendoj ta kalojmë kështu siç është, sepse do të ndryshojë, ne do ta shohim nga e para. Nëse jo, ne përsëri do t'i kthehemi, sepse një ndryshim do ta ketë. Dakord?

Miratohet!

Kalojmë te neni 8 “Zgjedhja e kandidatëve nga Kuvendi”.

Vasilika Hysi – Unë kam vetëm një pyetje. Këtu është lënë të votohet me 94, dhe thuhet që “lista miratohet o e tëra, ose asnjëra”.

Fatmir Xhafaj – Është vendosur siç është në Kushtetutë, nuk e ndryshojnë dot këta.

Vasilika Hysi – E konsoliduar? Kështu e kemi lënë, gjithë listën pa përjashtim? Unë dua 10 kandidatë, nuk dua një.

Aurela Anastasi – Mund të jap një sqarim: procedura e Kuvendit ka dy faza, miratimi i listës tërësore dhe pastaj zgjedhja e kandidatëve nga kjo listë.

Fatmir Xhafaj – Miratimi i listës tërësore është te neni 7.

Aurela Anastasi –Kjo është te neni 8.

Fatmir Xhafaj – Po më falni, te neni 8!

Aurela Anastasi – Presupozohet që nuk mund të kalojmë në zgjedhjen e kandidatëve pa miratuar gjithë listën tërësore dhe është shumë delikat ky moment, pasi hedhja poshtë e listës tërësore do të thotë mbarim i procesit.

Fatmir Xhafaj – Dhe rifillon nga e para?

Aurela Anastasi – Mund të rifillojë nga e para, por që mbaron këtu. Kthehesh edhe një herë nga Avokati i Popullit e të tjera si këto.

Vasilika Hysi - Pikërisht këtë kisha merak dhe frikë. Në një listë tërësore që mund të kesh 10-15 emra,

Aurela Anastasi – Edhe më shumë, 21 duhet të jetë minimumi, por duhet të kesh më shumë që të kesh konkurrencë.

Vasilika Hysi – Po marr një listë me 30 emra. Mund të jenë 29 të mirë, pse të digjet e gjithë lista për një emër?

Fatmir Xhafaj – Mund ta kurseni energjinë e shpirtit për këtë gjë, sepse është diçka që do të ndryshojë, sido që të jetë. Është e qartë, në qoftë se ka një nen që do të ndryshojë, do të jetë ky.

Dakord. Edhe neni 9 ka të njëjtin fat. Faleminderit shumë!

Neni 10 është gjithashtu i lidhur me këtë.

Neni 11 “Kryetari i Komisionit dhe i Kolegjit të Apelimit”.

...Po në moshë është, se këtu nuk mund të vësh në detyrë, sepse këta kanë një stad. Shyqyr që këta nuk janë caktuar që thonë që e kanë caktuar filanin, kunatin tënd apo timin. Kemi shpëtuar kësaj radhe nga kunetërit, nuk do të na thonë gjë. Sa me fat jemi!

Dakord. Faleminderit!

Neni 12. Kemi gjë?

Neni 13 “Organizimi i komisionit”.

Thamë që do të lejojmë disa detaje në këtë ligj. Sa më shumë detaje të ketë ky ligj, aq më mirë është. Dakord.

Neni 14 “Organizimi i Kolegjit të Apelimit”.

Dakord.

Neni 15. Keni gjë?

Kam diçka në lidhje me paragrafin e dytë. Këtu thuhet shumë mirë që “e zëvendëson kandidati që vjen më pas në radhë, por, nëse nuk plotësohet vendi për pamundësi, njoftohet

Kuvendi brenda 6 ditëve dhe procedura e zëvendësimit të tij bëhet duke filluar përsëri procesin nga fillimi”, nëse e kam kuptuar korrekt. Dhe ky proces nga fillimi sipas një llogaritje që unë bëra, shkon gati 6,7,8 muaj.

Fatmir Xhafaj - Mos e ke me javë?

Vasilika Hysi – Jo, i mbledha ditët e muajit dhe shkon periudhë e gjatë.

Fatmir Xhafaj- Në ndryshimet që do të bëjmë, është bërë një propozim dhe uroj që të mbetet kështu që, në qoftë se janë zgjedhur 21 veta, i 22, i 23, që është në listë, automatikisht kalon në detyrë.

Vasilika Hysi – Do të kemi kaq shumë njerëz për ta bërë këtë?

Aurela Anastasi Faleminderit! Edhe unë mendoj që në ndryshimet që do të bëjmë, ne do të themi që Kuvendi bën edhe një renditje të listës sipas përzgjedhjes së tyre. Pas 21 të parëve, të tjerët vijnë sipas përzgjedhjes. Ju përket atyre dispozita.

Fatmir Xhafaj- Duhet ta mbani në vëmendje, megjithëse kjo formulë do të kalojë edhe në analizën e EURALIUS-it, kështu që EURALIUS-it le ta vendosë këtë gjë lidhur me këtë ligj.

Vazhdojmë me nenin 16 “Rastet dhe procedurat për shkarkimin e anëtarëve”. Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ta ka njohur opinionin final i Komisionit të Venecias, ta ka thënë se është veprim procedural dhe ONM-së i është njohur e drejta për të pasur disa të drejta procedurale në proces. E ke në opinionin final të Komisionit të Venecias, edhe në memon që më kanë bërë mua për këtë gjë, më kanë sqaruar mirë. Besoj se e keni kuptuar edhe ju.

Vasilika Hysi – Mund të bëj një saktësim te neni 16? Te neni 16, germa “a”, kur flasim për caktimin e një mase disiplinore, do ta themi në përputhje me ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”? Ta saktësojmë se nuk ka ligj për statusin.

Aurela Anastasi -Neni 16, e keni fjalën pika 1/a?

Vasilika Hysi – Te pika 6.

Aurela Anastasi – Atëherë, ne ligjin për statusin e kemi një akronim dhe e kemi thënë këtë në përkufizimet dhe atje titulli është i plotë. Ngaqë ky i referohet disa herë, për të krijuar një farë komoditeti, e themi të shkurtuar.

Fatmir Xhafaj - Cilat janë shkaqet për shkarkimin e gjyqtarëve? Ku i keni në ligj?

Aurela Anastasi – Në fakt shkaqet janë përcaktuar në Kushtetutë dhe ne nuk duam t'i përsërisim në ligj. Nenet e Kushtetutës jemi përpjekur deri në një farë mase, aq sa kemi mundur, të mos i përsërisim.

Fatmir Xhafaj - Por duhet thënë “siç parashikohen”. Sepse duhet të ketë shkaqe shumë të forta, duhet të jenë në filtër këta njerëz dhe administrata e tyre, në qoftë se këta takohen me gjyqtarët dhe prokurorët që kanë proceset e vlerësimit, kanë konfliktin e interesave, lidhjet nepotike, të gjitha këto duhet të jenë shumë të qarta për ta. Këto shkaqet thamë që do t'i pasqyrojmë.

Faleminderit!

Dakord, neni 16 me ndryshimet dhe eventualisht, nëse do të ketë 16/1, për efekt të renditjes së shkaqeve, do ta pranoni.

Neni 17 “Organizimi dhe administrata e institucionit të rivlerësimit”.

Këtu kam një merak, çështjen e pagave. Nuk do të vendosim një kriter? Do t'ju këshilloja të vendosim një kriter, sepse, kur të vijë momenti që ta bëjë Kuvendi këtë gjë mund të... mund të vendosim një kriter “paga të barabarta”, me këtë apo do kenë plus bonusit për shkak të vështirësive etj.? Për shembull, komisionerët me kë do të jenë të barabartë, me gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese apo me...

Dakord , por duhet t'i caktoni që të ketë një linjë ose do të ndiqni logjikën e parashikimit kushtetues. Dhe kjo duhet të jetë e mjaftueshme.

Aurela Anastasi – Dakord, vetëm nëse ju dëshironi që ne ta referojmë prapë, do ta bëjmë.

Fatmir Xhafaj - Jo, në Kushtetutë nuk i keni disa bonuse që përfitojnë ata për shkak të vështirësisë e të tjera. Më fal një minutë. Ne kemi vënë në statusin e gjyqtarëve disa bonuse për gjyqtarët, sepse ai do të lërë Italinë, Gjermaninë, Amerikën që të vij të punojë këtu. Së pari, pagën duhet ta ketë të konsiderueshme, por duhet të ketë edhe disa bonuse për ato që ka lënë dhe që po vjen t'i shërbejë vendit të tij.

Aurela Anastasi - Unë mendoj që pasi të kalojmë nenin 28, të marrim një vendim të përbashkët për këtë.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Aurela Anastasi - Duhet ta shikojmë edhe nenin 28 që të arrijmë në një konkluzion më të saktë.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Aurela Anastasi - Faleminderit!

Vasilika Hysi – Unë kam një pyetje për paragrafin e tretë. Ju thoni që marrëdhëniet e punësimit të punonjësve të institucioneve të rivlerësimit, rregullohen sipas ligjit dhe Kodit të Punës. Të gjithë janë me status në marrëdhënie me Kodin e Punës, apo ka ndonjë status tjetër të veçantë? Kur flisni për administratën, keni parasysh të gjithë administratën dhe të gjithë stafin mbështetës, apo brenda administratës do të keni këshilltarë, ndihmës, specialistë, juristë, sepse pastaj nuk mund t'i jepni me status dhe Kod Pune? Pse? Në vazhdim të asaj që tha kryetari Xhafaj, te ligjet që sapo kaluam, ligji “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit”, por edhe te qeverisja e sistemit gjyqësor, ne i kemi dhënë status administratës së gjykatave të shkallës së parë, i kemi quajtur nëpunës civil gjyqësor, dhe kanë garanci shumë më të madhe, por ndoshta ju keni arsye të tjera që mund ta keni lënë.

Së dyti, kanë trajtim të ndryshëm në nivel page. Pagat me Kod Pune janë më të ulëtat në administratën publike. Në qoftë se ju do e lini që klasifikimin e pagave ta bëj Kuvendi, kjo nuk është kompetencë e tij, sepse klasifikimin e pagave të institucioneve e bën Këshilli i Ministrave me vendim. Pra, janë disa çështje që duhen trajtuar.

Fatmir Xhafaj – Këta duhen barazuar me një funksion në administratën publike, kurse bonusi të jetë plus, siç kemi vepruar te neni 28 që kemi vënë pagën e gjykatësit kushtetues plus bonusin.

Po.

Aurela Anastasi - Faleminderit! Dua të bëj një sqarim të vogël. E vërteta është që ne e kemi diskutuar këtë çështje, por të mos harrojmë që këto janë organe të përkohshme. Ata që do punojnë te komisioni...

Fatmir Xhafaj - Kë quani organ të përkohshëm ju, dhe sa është përkohshmëria?

Aurela Anastasi – Administratën pranë komisionerëve publikë dhe pranë kolegjit.

Fatmir Xhafaj - Sa është përkohshmëria?

Aurela Anastasi - Pesë ose nëntë vjet.

Fatmir Xhafaj - Më fal, por pesë apo nëntë vjet, përballë një presioni dhe një përgjegjësie morale të jashtëzakonshëm që do të kenë, nuk meritojnë që të paguhet diçka më shumë si dhe të kenë një status specifik?

Aurela Anastasi – Padyshim.

Fatmir Xhafaj – Për mua, besoj se do ta shikojmë edhe te dispozitat kalimtare, pas përfundimit me sukses të kësaj detyre, ata duhet të emërohen automatikisht në funksione të njëjta në shërbimin civil, në mënyrë që ai që do të vij të ketë interes dhe të shërbejë me përkushtim.

Aurela Anastasi – Atëherë, unë dua të sqaroj diçka për këto çështje që ju ngritët me shumë të drejtë. Ne kemi dy probleme.

Problemi i parë është nëse do të kemi këtu punonjës me status, edhe nëse ne nuk jua japim dot statusin, sepse mund të jenë të përkohshëm. Nuk e di nëse duhet ta kalojnë punonjësit tanë provimet e statusit? Unë mendoj që jo, prandaj ne duhet t'i ndajmë mirë disa gjëra. Nga ana tjetër, në qoftë se këtu aplikojnë njerëz të cilët e kanë statusin, ata do të pranohen dhe do ta kenë kontratën sipas statusit. Kështu që, unë ju falënderoj dhe mendoj se ne duhet t'i parashikojmë mirë këto.

Problemi i dytë është ai i bonuseve. Pavarësisht nga statusi, unë mendoj se bonusi dhe përfitimi i tij duhet riparë, por nuk e di se çfarë mendimi ka zoti Rainer.

Fatmir Xhafaj - Nuk duhet të vijmë të njëjtët që janë në administratën ekzistuese, por duhet të rekrutohen, dhe kur të hyjnë aty dhe t'i kalojnë të gjitha, duhet të marrin statusin e tyre në mënyrë që të kenë mundësi për më vonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, do t'jua japim me ligj. Nëse dikush që sot është asistent apo avokat në një zyrë në Gjermani apo diku tjetër, vjen të punoj në administratë dhe bën një detyrë kaq të vështirë, ai duhet që ta marrë statusin e nëpunësit civil, në mënyrë që pas kësaj të jetë i lirë të emërohet diku dhe të mos dalë në rrugë pasi ka bërë gjithë këtë punë me përgjegjësi. Ka ndihmuar komisionerin që të bëj dosjen, sepse komisionerët 12 vetë janë, por volumin e punës do ta bëjnë këta. Ku do të shkojë ai, do dalë në rrugë sepse bëri pesë vjet punë? Jo, përfundoi me sukses detyrën, i bëri shtetit një shërbim të madh, dhe automatikisht duhet të shkoj diku, sepse u investua për këtë njeri në të gjithë këtë proces. Pra, unë besoj se ky është statusi që këta duhet të kenë. Dakord?

Rainer Deville – *(përkthen përkthyesja)* Kemi dy mundësi të ndryshme që mund t'i rekrutojmë njerëzit. Njëri opsion që mund të rekrutojmë njerëz, të cilët punojnë brenda sistemit është instrumenti i ri i komandimit që vetëm transferohen në këtë mision, dhe kur mbaron misioni ata kanë avantazh vlerësimit e karrierës së tyre. Ky është sistemi që kemi diskutuar te ligji “Për statusin”. Gjithashtu, për njerëzit që duhet t'i rekrutojmë sa më shpejtë duhet të shikojmë edhe alternativën tjetër. Në rast se nuk kemi mundësi që t'i bëjmë pjesë të punës civile, të shërbimit civil, ata duhen rekrutuar menjëherë dhe prandaj kjo bëhet me një kontratë pune, e cila do të japë efektet e saj financiare në buxhet dhe kjo është diçka më praktike. Sa kohë investojmë për t'i bërë këto institucione operative dhe të tria shtyllat fillojnë menjëherë, deklarimi i pronave nga ILDKPI-ja...

Pra, duhet t'i rekrutojmë këta njerëz sa më shpejtë që të jetë e mundur, dhe gjëja më e mirë që mund të bëjmë është që të shikojmë tregun, të ndërtojnë kontratat e punës dhe të gjithë ata që janë atje, gjatë kohës që janë aty mund ta përdorin kohën për të hyrë në sistem, për t'u komanduar dhe për t'u bërë shërbyes civil, por nëse insistojnë që të gjithë, atëherë kjo mund të na ngrejë shumë pengesa për ta filluar menjëherë procesin. Pra, të pretendojmë që të kemi shërbyes civil, punonjësit civil, që në fillim kjo do të na ngrejë shumë pengesa.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Besoj se jemi të qartë që diçka duhet rregulluar me statusin e tyre, kjo për t'u dhënë atyre incentiva për të rihyrë në këtë shërbim, sepse duhet të ketë disa incentiva, profesorëshë, që ai të lërë një punë të mirë diku dhe të vij këtu për disa arsye. Për çfarë duhet të vij? Të vij se mos shpëton ndonjë gjyqtar dhe merr ndonjë bakshish? Nuk do të vijnë nga ata, sepse do të jetë presion shumë i madh mbi këta njerëz. Të mos harrojmë që është fjala për të hequr disa njerëz të cilët i kanë xhepat plotë dhe përveç kriterit moral duhet të jetë edhe kriteri që ai duhet të jetë i qetë në familjen e vetë.

Dakord. Miratohet neni 17 me këto ndryshime.

Neni 18 “Buxheti i institucioneve të rivlerësimit”.

Përpara se të bëni pyetje, ky nen duhet riformular. Nuk ka rëndësi të thuhet “komisioni që mbulon çështjen ekonomike pranë Kuvendit”, sepse të gjitha këto kalojnë te Komisioni i Ligjeve. Buxheti është i unifikuar dhe atë e përgatit qeveria sepse ai nuk mund të vij drejtpërdrejtë në Kuvend. Këtu duhet thënë, që buxheti fillestar do të shkojë në qeveri, si dhe duhet parashikuar edhe një buxhet fillestar në muajin mars për shembull, kurse buxheti i përvitshëm do të jetë buxheti që paraqitet në qeveri. Do ndiqni logjikën e institucioneve të tjera të sistemit të drejtësisë, KLGJ-ja, KLP-ja e të tjera.

Aurela Anastasi - Në formulimin e këtij neni kemi ndjekur logjikën e KLSH-së, meqenëse është institucion i pavarur.

Fatmir Xhafaj - Ka një arsye që te KLSH-ja është ai formulim.

Edhe KLSH-ja vetë, në dijeninë time është zë i buxhetit të shtetit, por ka një konflikt interesi midis KLSH-së, sepse ajo e kontrollon buxhetin e shtetit dhe prandaj kjo pjesë i është lënë Kuvendit.

Aurela Anastasi – Pikërisht edhe ne këtë shfrytëzuam, që edhe këto institucione të kenë një status të mbështetur mirë në lidhje me pavarësinë e tyre financiare.

Fatmir Xhafaj - Dakord, por nuk të lë Kushtetuta. Gjithsesi ne jemi të hupur që ta shikojmë këtë gjë. Dakord?

Aurela Anastasi - Dakord.

Fatmir Xhafaj – Jam dakord që ta diskutojmë me...

Unë nuk e di që buxheti...

Neni 18 duhet riparë në raport me Kushtetutën aktuale dhe me ligjin organik për rregullat e buxhetit të shtetit, dhe nëse ka hapësirë dhe ndonjë model për këtë që propozoni ju, ne jemi dakord. Matilda, neni 18 ngelet i hapur. Dakord?

Neni 19 “Sekretari i Përgjithshëm”.

Vasilika Hysi - Faleminderit! Unë kam një pyetje. Pse duhen dy sekretarë të përgjithshëm dhe në cilat institucione do të punojnë?

Aurela Anastasi – Më falni! Njëri është Sekretar i Përgjithshëm i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe tjetri është i Kolegjit të Apelimit dhe i kemi vendosur të dy me qëllim që të mos kemi dy nene.

Vasilika Hysi – Dakord. Kjo ishte pyetja e parë.

Pyetja e dytë. Ju thoni se vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga Komisioni *at hoc* i krijuar në institucionin përkatës. Pra, do të ketë një institucion *at hoc* në secilin prej tyre? Më pas, ju thoni se Sekretari i Përgjithshëm mund të jetë shtetas shqiptar. Pse thuhet “mund të jetë”, dhe jo “të jetë”, apo mund të jetë edhe i huaj?

Fatmir Xhafaj – Jo.

Vasilika Hysi - E pra, fjala “mund” duhet të hiqet. Sekretari i Përgjithshëm duhet të plotësojë kushtin që të jetë shtetas shqiptar, apo mund të ketë edhe një shtetësi tjetër, sepse kemi shumë me shtetësi të tjera?

Fatmir Xhafaj – Nuk ka problem.

Vasilika Hysi - Për shembull, për inspektorin ne kemi thënë që duhet të merret vetëm shtetas...

Fatmir Xhafaj – T’i nuk ke thënë që të jetë vetëm shtetas shqiptar.

Vasilika Hysi - E pra, për këtë po pyes.

Fatmir Xhafaj – Nuk e përjashton edhe pse në Kushtetutë është që të jetë shtetas shqiptar, sepse ka deputetë dhe ministra me dy shtetësi.

Vasilika Hysi – Te ligji “Për organet” e kemi shënuar vetëm shtetas shqiptar dhe ashtu është lënë.

Fatmir Xhafaj – Kemi bërë gabim në qoftë se e kemi shënuar ashtu, por varet, sepse mund të jetë një detyrë specifike që të mos jetë kryetar partie ose deputet me dy shtetësi.

Vasilika Hysi - Pyetja tjetër është për saktësim ose për të qenë e sigurt. Do rregullojmë germen “c” të pikës tre, për veprën penale që të ketë kryer një krim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kur thoni që ka përfunduar studimet e larta për drejtësi ose shkencë ekonomike, për çfarë niveli studimi e keni fjalën?

Fatmir Xhafaj – Përcaktojani.

Vasilika Hysi - E fundit fare, që me të drejtë thotë zoti Majko, është që duhet të zotërojë shumë mirë gjuhën angleze, por kjo gjuhë duhet e mbrojtur apo do të vërtetohet gjatë intervistimit?

Aurela Anastasi - Faleminderit për të gjitha sugjerimet!

Në fakt, nëse duhet vërtetë që të parashikojmë në mënyrë të detajuar se si do t'i kontrollojmë njohurinë e gjuhës angleze, unë mendoj se duhet të jemi të hapur, sepse varet shumë nga mosha e personave. Janë disa persona të cilët kanë eksperiencë të gjatë, por nuk kanë mbrojtur një provim të gjuhës angleze në nivel ndërkombëtar, jo pranë Universitetit të Tiranës, por ata kanë kohë që bashkëpunojnë me misionet e huaja, e kanë të njohur këtë gjuhë, si edhe mund të kenë përfunduar studimet master jashtë vendit dhe nuk kanë nevojë që të kenë mbrojtur. Kështu që, ne do të gjejmë një formulim të hapur.

Fatmir Xhafaj - Dakord për nenin 19 me ndryshimet që iu bënë.

Neni 20 “Detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm”.

Dakord.

Neni 21 “Njësia e shërbimit ligjor”.

Edhe këtu nuk duhet përdorur termi “mund të jetë shtetas shqiptar”, prandaj kijeni parasysh dhe ndryshojeni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të reflektohen të gjitha këto që u thanë pak më lart. Kur vini rregullin që të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë, pse nuk vini edhe çështjen e integritetit? Të plotësojë kushtet e ligjit për integritetin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është më i ngushtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, mirë kanë bërë.

Më fal, por këshilltari ekonomik është shtetas shqiptar, përmbush kriteret e mëposhtme, si dhe ka përfunduar studimet e larta në drejtësi dhe shkencë ekonomike. Tani, edhe këshilltar ekonomik dhe i diplomuar në drejtësi mua më duket sikur nuk rrinë bashkë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po mirë pra, bazën do ta ketë ai, sepse merret këshilltar për ekonominë, financat dhe kontabilitetin.

Aurela Anastasi - Ju jeni i mendimit, që duhet të jetë i diplomuar vetëm në shkencë ekonomike?

Fatmir Xhafaj – Po, sepse këshilltar ekonomik është, kurse këshilltari ligjor duhet të jetë i diplomuar në drejtësi.

Rainer Deville – (*përkthen përkthyesja*) Mund të jetë kështu, por jo domosdoshmërisht, sepse mund ta ngushtojmë artificialisht. Për shembull, mund të ketë avokatë, të cilët kanë ndjekur të Drejtën Tregtare dhe nuk duhet ta përjashtoni. E heqim fjalën “duhet”, por le ta lëmë të hapur.

Fatmir Xhafaj – Atëherë, diplomohet për të Drejtën Tregtare, kurse drejtësinë e ka plus. Këshilltar ekonomik nuk është, përsëri këshilltar ligjor është, si edhe ai që ka mbaruar të Drejtën Tregtare, nuk është tregtar meqë ka fjalën “tregtare” pas.

Aurela Anastasi - Më falni! Unë dua t’ju kujtoj që ka persona të cilët kanë studiuar në një degë të caktuar dhe më pas kanë bërë master ose kurse të gjata trajnimi në kontabilitet dhe ekonomik. Ndoshta vetëm kështu mund ta...

Fatmir Xhafaj – Profesoreshë, jam dakord që ta vendosim arsimin mbi baza të preferuara.

Aurela Anastasi – Dakord. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Ideja është që ta zgjidhim këtë gjë, sepse kemi edhe *business law*. ..., por për çfarë ju duhet, sepse këta duhet të kenë vjetërsi. Dakord.

Neni 22 “Detyrat e këshilltarit”. Dakord besoj, sepse i keni parë vetë me kujdes.

Neni 23 “ Marrëdhënia me median” .

Vasilika Hysi – Kam unë një riformulim.

Fatmir Xhafaj - Të lutem, sepse këtë e ka zoti Rainer.

Vasilika Hysi – Jo, dua vetëm që të riformulohet pjesa ku thuhet që “institucionet e vlerësimit kanë punonjës përgjegjës për marrëdhëniet me mediat”, i cili është ndërmjetës midis trupave gjyqësore dhe medias. Ne duhet të themi se “institucioni i rivlerësimit ka një punonjës përgjegjës për marrëdhëniet e komunikimit me mediat”.

Fatmir Xhafaj – Për marrëdhënien e komunikimit publik.

Vasilika Hysi – Po.

Fatmir Xhafaj - E mbyllim pastaj, mund të jetë media vendase, ndërkombëtare, midis tyre dhe këtij. Dakord. Miratohet edhe neni 23, por me ndryshime.

Neni 24 “Mbrojtja e anëtarëve të institucioneve të vlerësimit, personelit vendas dhe ndërkombëtar”. Besoj se është në rregull.

Vasilika Hysi - Unë jam dakord që duhet të kenë mbrojtje, por nuk di që ne të kemi ndonjë ligj për mbrojtjen e veçantë për të gjithë gjyqtarët.

Fatmir Xhafaj – Kur kërkohet pra.

Vasilika Hysi - Jo, sepse thuhet sipas legjislacionit për mbrojtjen e veçantë për të gjithë gjyqtarët.

Fatmir Xhafaj – Po mirë pra, por nuk ka gjithsecili mbrojtje personale, por kur kanë nevojë për mbrojtje.

Vasilika Hysi - Duhet të themi se ka një ligj të veçantë për mbrojtjen e tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, e kam fjalën për fundin fjalisë, për mbrojtjen e veçantë për të gjithë gjyqtarët.

Fatmir Xhafaj – Me fuqi për mbrojtjen e veçantë që ofrohet për gjyqtarët.

Aurela Anastasi - Ne mund të themi për gjyqtarët. Kemi dashur të mos bëjmë dallime, sepse gjyqtarët e lartë mund të kenë status të veçantë.

Fatmir Xhafaj – Për gjyqtarët dhe pastaj përcaktohet me marrëveshje me policinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vasilika Hysi - Më fal, por ka një përsëritje të paragrafit të parë dhe të dytë. Ju thoni se anëtarët e institucionit të vlerësimit, personeli i komisionit dhe i kolegjit të apelit, si dhe personeli mbështetës, gëzojnë mbrojtje sipas ligjit në fuqi “Për mbrojtjen e veçantë për të gjithë gjyqtarët”.

Aurela Anastasi - Për ta sqaruar. Anëtarët e institucioneve të vlerësimit janë persona të zgjedhur, kurse në personel bëjnë pjesë personat që emërohen në bazë të Kodit të Punës, dhe kjo ka ndryshim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Urdhëro? Dakord.

Sugjerimi juaj është që t’i bashkojmë të dy paragrafët në një të vetëm?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kuptoj.

Fatmir Xhafaj – Jam dakord që neni 24 të ketë vetëm një paragraf. Faleminderit! Miratohet me ndryshimet e bëra.

Neni 25 “Deklarimi i pasurisë”.

Dakord.

Neni 26 “Garantimi i paanësisë”.

Dakord.

Vasilika Hysi - Në paragrafin e parë fjalia e dytë, ju thoni që “çdo vendim i marrë në situatë konflikti interesi përveç pasojave ligjore përbën edhe shkelje disiplinore”, por po pate shkelje disiplinore, ke edhe pasoja ligjore.

Fatmir Xhafaj – Jo gjithmonë.

Vasilika Hysi - Përveç pasojave ligjore. Po cila është kjo pasojë? Po shkelja disiplinore nuk ka pasoja? Sepse të gjitha shkeljet disiplinore ne i kemi me pasoja. I kemi vërejtje konfidenciale, vërejtje publike, ulje page, pezullim, shkarkim.

Aurela Anastasi - Dakord, e kemi pasur fjalën për pasoja ligjore në vendimmarrje dhe pastaj për shkelje disiplinore të personit.

Fatmir Xhafaj - Dakord me ndryshimet.

Neni 27 “Kushtet për garantimin e besueshmërisë dhe konfidencialitetit”.

Dakord.

Neni 28 “Paga e anëtarëve të institucioneve”.

Ata përfitojnë një pagë mujore shtesë për shkak të vështirësisë. Hiqeni termin “në vlerën”, sepse mund të jetë shumë herë më e lartë se kjo dhe unë mendoj që ta bëjmë me grada, mjafton që për shkak të vështirësive ai të përfitojë një pagesë mujore shtesë, e cila negociohet midis Kuvendit dhe Komisionit të Ligjeve.

Vasilika Hysi - Lidhur me pikën e tretë të këtij neni, këtyre anëtarëve, ne u kemi lënë shumë pak përfitime në raport me përfitimet që marrin gjyqtarët që ditën e parë që fillojnë në shkallë të parë.

Fatmir Xhafaj - Prandaj duhet që ta shikoni të gjithë këtë, dhe nuk duhet thënë “paga e anëtarëve”, por pagat dhe përfitimet ose shpërblimet.

Të riformulohet i gjithë neni 28.

Vasilika Hysi - Dua të shtoj edhe diçka në vazhdim të asaj.

Fatmir Xhafaj – Po.

Vasilika Hysi - Gjithashtu, duhet të vendosim se çfarë lloj përfitimesh do të kenë. Do kenë vetëm pagën dhe përqindjen për shkak të ushtrimit të detyrës, do kenë pension suplementar, do kenë mbrojtjen e jetës...

Zonja Anastasi, aktualisht te ligji “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit”, gjyqtarët kanë parashikuar pagë, plus 18 përfitime të tjera. Pra, ata kanë nëntëmbëdhjetë privilegje.

Fatmir Xhafaj - Nuk është e thënë që t’i kenë të gjitha.

Vasilika Hysi - Nuk është e thënë, por të paktën këtu duhet t’i kemi të qarta.

E fundi fare që kam është, se pse duhet thënë në ligj që pensioni pas përfundimit të mandatit paguhet çdo muaj deri në fund të jetës së tij? Pra kanë një pension të përjetshëm, dhe këtu flasim për pensionin suplementar...

Fatmir Xhafaj - Atëherë, neni 28 do të riformulohet i gjithi? U kuptuam?

Aurela Anastasi – U kuptuam, por duam të themi që ligjin “Për statusin” e kemi bërë referencë. E gjithë filozofia e hartimit të këtij projektligji ka qenë që të mos i përsërisim ato që referojmë.

Fatmir Xhafaj – Profesoreshë, këtu keni vetëm pagën bruto, kurse përfitimet shtesë nuk janë.

Aurela Anastasi - Paga bruto sipas dispozitave të ligjit “Për statusin”.

Fatmir Xhafaj - Atëherë thuaje që përfiton sipas ligjit “Për statusin”.

Aurela Anastasi – Dakord. Përfiton sipas ligjit “Për statusin”.

Fatmir Xhafaj – Shikojeni dhe riformuloheni së bashku me zyshën.

Aurela Anastasi - Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Neni 28 miratohet me ndryshimet për ta riformuluar mbi bazën e atyre që u reflektuan.

Neni 29 “Objekti i vlerësimit të pasurisë”.

Dakord. Faleminderit!

Neni 30 “Fillimi i procedurës së vlerësimit të pasurisë”.

Dakord.

Neni 31 “Deklarimi i pasurisë”.

Dakord.

Neni 32 “Procedura e vlerësimit të pasurisë”.

Dakord.

Neni 33 “Objekti i kontrollit të figurës”.

Kjo nuk është vetëm verifikim i deklarimeve të subjektit, por ka të bëjë edhe me rastet që dalin herë pas here, sepse verifikimi i figurës nuk mbyllet vetëm me dhënien e një deklarimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po pra. Nuk është vetëm për... sepse është nëntë vjet.

Aurela Anastasi – Dhe në bazë edhe të fakteve të tjera. Do e gjejmë një mënyrë.

Fatmir Xhafaj – Dakord me ndryshimet për nenin 33.

Neni 34 miratohet pa bërë ndryshime.

Neni 35 “Struktura përgjegjëse për kontrollin e figurës”.

Është pak e sforcuar kjo.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk është thjesht informacion.

DSIK -ja është kryesisht për informacionin e klasifikuar, kurse kjo është për figurën.

Pandeli Majko - DSIK-ja bën verifikimin e personit dhe jep garancinë që ky person mund të kalojë në duart e tij informacion të klasifikuar.

Vasilika Hysi – Mund të bëj një pyetje?

Pandeli Majko - Domethënë është një institucion i specializuar.

Vasilika Hysi - Në pikën 2, keni parashikuar detyrimin që Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar duhet të bashkëpunojë me Shërbimin Informativ Shtetëror dhe me Shërbimin e Kontrollit të Çështjeve të Brendshme, me SHKB-në e dikurshme, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të krijojë një grup pune. Këto struktura mund të caktojnë personel për të mbështetur grupin e punës për një periudhë jo më pak se një vit, por kush do ta japë informacionin në fund?

Rainer Deville – *(përkthen përkthyesja)* Kushdo që e ka informacionin dhe prandaj e kombinojmë, sepse nuk e dimë se cili institucion do ta ketë dhe çfarë lloj informacioni është. Pra, duam të mbledhim informacion nga secili prej këtyre tre institucioneve, sepse mund të ndodhë që në shumicën e rasteve këto struktura nuk kanë informacione, ka vetëm njëra ose ndoshta të tria, këto do të kthejnë përgjigjen dhe mund të thonë që nuk kemi asgjë, prandaj nuk përjashtojmë asnjë.

Vasilika Hysi – Këtë informacion që do të mbledhë grupi i punës, kush do ia përcjellë Komisionit *at hoc* të vlerësimit? Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar?

Rainer Deville – *(përkthen përkthyesja)* Për këtë gjë përgjegjës është Autoriteti i Sigurisë Kombëtare, kurse në nenin 35 thuhet që institucionet te tjera japin vetëm të dhëna ose sjellin informacione shtesë.

Fatmir Xhafaj – Drejtoria përgjegjëse është autoriteti i sigurisë? Dakord. Vrisni edhe një herë mendjen se mos gjeni ndonjë zgjidhje më të mirë, sepse mua nuk më vjen ndër mend tani për tani ndonjë zgjidhje tjetër. Duhet të shikoni se me çfarë merret DSIK-ja, sepse e nuk ka këtë funksion.

Aurela Anastasi – Një shpjegim të vogël ne e kemi konsultuar dhe ka qenë objekt i një diskutimi të gjatë. Madje, ky nen është formuluar ndër të fundit, gjithashtu, është konsultuar edhe me grupet e interesit dhe ata kanë pranuar që të krijojnë mundësi dhe përshtatje për të zbatuar këtë ligj.

Rainer Deville – (*përkthen përkthyesja*) Problemi për institucionet e tjera si për shembull, Shërbimi i Informacionit Shtetëror, është se ata nuk kanë bazë ligjore për të kontribuar, por vetëm nëse ndodh që ta krijojmë ne këtë bazë ligjore. Prandaj, ne krijuam këtë strukturë të grupit të punës që do të jetë baza ligjore që ata të kontribuojnë dhe kjo ishte arsyeja pse e quajtëm kështu. Për ata nuk ishte e mjaftueshme që të thoshim “se do të dërgojmë një letër”. Ky ishte feed back-u nga institucioni që donte të merrte përsipër më shumë këtë detyrë.

Për neni 36 jemi dakord.

Vasilika Hysi - Kam një pyetje për germën “c” të nenit 36. Ju thoni “vlerësim i përgjithshëm nëse individ mund të vihet nën presion nga strukturat kriminale”. Si mund ta vlerësoni me vlerësim të përgjithshëm nëse individ mund të vihet nën presion, sepse mua kjo më duket subjektive? Germa “e”. “Verifikim nëse rezulton i dënuar për një ose më shumë vepra penale (që është e saktë), ka sjellje të keqe si dhe ka tendenca kriminale”, ndërkohë që tendencat i kemi përmendur edhe më lart. Gjithashtu, në germën “a” krahas verifikimit të identitetit dhe gjeneraliteteve, unë mendoj se personi mund të ketë mbajtur edhe mbiemra të tjerë që nuk i ka ndërruar në gjendjen civile, sepse një person mund të ketë përdorur tri ose katër emra, shkurtime, pseudonime, por nuk ka bërë ndryshim të gjeneralitetit sipas ligjit “Për gjendjen civile”. Prandaj duhet të themi se duhet bërë verifikim i saktë, siç e kemi te ligji “Për pastërtinë e figurave”, i identitetit, gjeneraliteteve dhe të të gjithë emrave që ai mund të ketë përdorur në jetën e vetë, pa qenë nevoja t’i ndryshojë në gjendjen civile.

Po verifikimi i statusit të shtetësisë pse na duhet, sepse atë e kemi në gjendjen civile, te gjeneralitetet, ku kemi hequr kombësinë, por shtetësinë e kemi lënë? Unë dua të di se si do ta vlerësojmë sjelljen e keqe dhe një sqarim për germën “c”, se si do të arrijmë ta vlerësojmë nëse individ vihet nën presion?

Aurela Anastasi - Natyrisht që kanë punuar edhe ekspertë të tjerë, por mënyra se si unë e kuptoj, ka të bëjë dhe është e lidhur me kontaktet e papërshtatshme me persona të ndryshëm. Në qoftë se nga vlerësimi rezulton se ky subjekt i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme, kjo natyrisht ndikon edhe në mënyrën se si do të punojë. Kontaktet e papërshtatshme, përveç pasojave të tjera mund të kenë edhe pasojën që dikush ka akses të ndikojë tek ti dhe të bëjë presion për çështje të ndryshme që mund të kesh pasur në të shkuarën. Kjo është ideja që duhet lidhur me kontaktet e papërshtatshme. Në qoftë se komisioni do të shikojë që nga verifikimi i kontakteve të papërshtatshme ekziston rreziku që ky person nesër ose pasnesër të mos jetë i pavarur në marrjen e vendimeve, sepse dikush i bën presion, atëherë komisioni mund të marrë vendim mbi këtë bazë. Kjo është ideja.

Vasilika Hysi - Unë jam dakord, zonja Anastasi, por e ke rregulluar te germa “b”, ku thua: “kontrolli i rekordeve në nivel kombëtar në funksion të aktivitetit, të tendencave kriminale të hetimit ose të kontakteve me krimin e organizuar dhe i ke marrë tendencat kriminale përsëri në germën “e” dhe përfshihen në grupe. Pra, germat “b”, “c” dhe “e” kanë të njëjtën terminologji pak a shumë, por jo komplet fjalë për fjalë “tendenca kriminale”.

Aurela Anastasi –Po, ato mbase duhet të riformulohen, por unë mendoj që duhet thënë gjithashtu, “edhe presioni që ushtrohet si rezultat i tendencave kriminale”. E rimarrim, e formulojmë...

Fatmir Xhafaj – Edhe këtë termin “Ka sjellje të keqe” te germa “e” hiqeni. Ka kush e ndan sjelljen e keqe, ai është gjyqtar, prokuror. “Tendenca kriminale dhe përshtatje në krimin e organizuar”, po pse po të jetë në krim urban ai?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“Përfshirje në krimin e organizuar”, nuk është e thënë vetëm në krimin e organizuar, edhe në aktivitete kriminale, sepse ai mund të jetë i përfshirë edhe në një krim ordiner, në botën e këtyre njerëzve që vjedhin. Ç’rëndësi ka, është patjetër me 75/a-në këtu?

Rainer Deville – *(përkthen përkthyesja)* – Problemi me të cilin ne jemi përballur në realitet me këtë verifikim të kaluar....

...e kimit të organizuar, sepse përndryshe do të kishim ushtrimin e drejtpërdrejtë të ndjekjes penale, por atë që mund të kemi si evidencë në një sërë rastesh, është që kemi vetëm tregues. Pra, a mund të kemi mjaftueshëm evidencë, që në fund ne të bëjmë një gjykim. Këta tregues, për shembull, mund të kemi që transportojnë para, fluturojnë për në Vjenë, bëjnë shkëmbimin në euro dhe kthehen me to, ndoshta nuk mund t’i kenë deklaruar ato 10 mijë eurot, apo marrin një makinë dhe ajo drejtohet nga persona, të cilët nuk i njohin fare, ose një makinë që mund të transportojë drogë. Pra, keni tregues të tillë. Nuk është subjektive, por është një vlerësim që duhet të bëhet dhe, sigurisht, vlerësimi i *background-it* është një nga instrumentet më të vështira që kemi dhe ne duhet të kërkojmë një sërë treguesish. Por, nëse ju keni, gjithashtu, një fotografi, ku kemi këta njerëz, apo ceremoni martese në jug, në Sarandë apo Lazarat, në mes të një fushe, ku kultivohet drogë dhe ju të thoni që nuk i dinim këta plantacione, ju mund t’i koleksiononi këto gjëra, megjithëse duken të ngjashme germat “b”, “c” dhe “ç”, ne jemi përpjekur të japim një lloj udhëzimi. Ne i kemi parë në praktikë dhe jemi përpjekur të koleksionojmë, të mbledhim dhe nuk dimë se çfarë lloj evidence duhet të marrim. Mund të jetë e nevojshme të kemi një panoramë të madhe, e cila përbëhet nga pjesë të vogla, dhe në qoftë se i bashkoni këto 10 pjesë së bashku me pjesët e tjera, ju mund të keni një panoramë dhe mund të thoni, që nëse i vendosa të gjitha këto pjesët e puzzle-it, atëherë

pamja që kam unë në fund, mund të më justifikojë të gjitha vlerësimet dhe në fund kjo nuk është ajo që ju doni të shikoni si gjyqtar, pra barra e provës kthehet. Ky ishte instrumenti kushtetues. Tani varet nga ju që ta shpjegoni. Në qoftë se kjo është vetëm aksidentalisht, sigurisht që gjykatësi ka mundësi për t'ju dhënë evidenca të reja, por kjo është puna për të pasur dhe evidenca të tjera. Këtë jemi përpjekur që të bëjmë ne në nenin 36, të përshkruajmë më tepër mënyrat se si të bëjmë kërkime, se sa të kemi fakte precize, sepse do të kemi vetëm disa tregues, jo vetëm krimin e organizuar.

Fatmir Xhafaj – Është ftuar zonja Anastasi?

Faleminderit!

Neni 37, “Standardet e kontrollit të figurës”.

Unë kam një shqetësim për germën “b” “Subjekti i vlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një telefonatë më një person të përfshirë në krimin e organizuar”. “Një telefonatë” nuk më bind si term, sepse për këtë telefonatë nuk mund ta dijë fare fëmija i gjyqtarit që bashkëjeton me të, nëna e të tjerët, që janë në rrethin e personave të lidhur, prandaj unë them që termi më i përshtatshëm të jetë “komunikim”.

Unë them të mos e ngushtojmë, ndërsa me këtë termin tjetër si për shembull “ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar”, janë në rregull.

Neni 37, dakord me ndryshimet.

Neni 38, dakord me ndryshimet.

Kreu 6, “Vlerësimi i aftësisë profesionale”.

Neni 39, “Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale”, dakord.

Neni 40, “Fillimi procedurës për vlerësimin e aftësisë profesionale”, dakord.

Neni 41, dakord.

Vasilika Hysi – Kam një referencë të ligji “Për prokurorinë”. Ne kemi një ligj të ri?

Te neni 41, pika 1 thuhet “anëtarët e tjerë vlerësohen bazuar në burimet e paraqitura”. Çfarë do të thotë “burimet e paraqitura” në ligjin për statusin?

Kam edhe një pyetje tjetër lidhur me atë pikë ku thuhet “Prokurori i Përgjithshëm” nëse ka plotësuar kriteret e parashkruar në nenin 8 të këtij ligji”, ne këtë ligj e shfuqizojmë tani.

Aurela Anastasi – E para, “burimet për rivlerësimin”, është një terminologji që i është referuar ligjit “Për statusin”, janë të përcaktuara aty burimet për rivlerësimin dhe ne e kemi marrë atë terminologji.

E dyta, edhe në referimin e ligjeve të vjetra që priten të shfuqizohen, është i njëjti shkak, e njëjta arsye që shpjeguar pak më sipër, sepse do të shikojmë një nen në fund, në

dispozita tranzitore, që janë marrëdhëniet midis institucioneve të vjetra dhe institucioneve të reja. Ne do të bëjmë kalimin dhe për të bërë këtë kalim neve na duhen edhe ligjet e vjetra, edhe ato të reja. Kjo është arsyeja.

Rainer Deville – (*përkthen përkthyesja*) Në qoftë se kthehem mbrapsht në tre vjetët e fundit, për të vlerësuar njerëzit sipas standardit që ishte në fuqi tre vitet e fundit, sepse nuk mund të kërkosh një standard të ri, kur ai person është vlerësuar vite më përpara, nuk mund të pretendosh që të kesh pasur këtë standard si tani.

Fatmir Xhafaj – Dakord me ndryshimet e nenit 41.

Neni 42, “Procedura”, dakord.

Neni 43, “Raporti i vlerësimit”, dakord.

Kreu 7, “Procedura e rivlerësimit”.

Neni 44, “Parimet”, dakord.

Neni 45, “Njoftimi”, dakord.

Neni 46, “Të drejtat e subjektit të rivlerësimit”, dakord.

Neni 47, “Bashkëpunimi gjatë procesit të hetimit”, dakord.

Neni 48, “Mjetet për kërkimin e provës”, dakord.

Rainer Deville – (*përkthen përkthyesja*) Vetëm për protokoll dhe referencë. Paragrafi i parë, shkronja “a” thotë: “neni 3 pika 21”, duhet të jetë “neni 3 pika 20”.

Fatmir Xhafaj – Rregullojeni këtë. Dakord me ndryshimet.

Aurela Anastasi – Më falni, doja të lexoja një *riwording*. Vasilika mund ta shikojë, te pika 6, paragrafi “e”, “përmban një pretendim në favor të subjektit të rivlerësimit, që mund të konsiderohet sikur fakti i pretenduar është i vërtetë”. Kemi bërë një *riwording* për t’u kuptuar më mirë kjo. Pra, “kërkohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili mund të konsiderohet i vërtetë, por nuk ndikon në marrjen e vendimit”.

Fatmir Xhafaj – Dakord, me nenin 48 me ndryshimet e paraqitura.

Neni 49, “Aksesi në informacion”, dakord.

Neni 50, “Përfundimet e bazuara në fakte”, dakord.

Neni 51, “Barra e provës”, dakord.

Neni 52, “Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve”, dakord.

Neni 53, “Bashkëpunëtori i drejtësisë”, dakord.

Neni 54, “Seanca dëgjimore”, dakord.

Neni 55, “Dorëheqja”, dakord.

Neni 56, “Vendimi i komisionit”, dakord.

Neni 57, “Masat disiplinore”, dakord.

Neni 58, “Konfirmimi në detyrë”, dakord.

Neni 59, “Pezullimi nga detyra dhe detyrimi për te ndjekur programin e trajnimit”, dakord.

Neni 60, “Shkarkimi nga detyra”, dakord.

Kreu 8, “Apelimi”.

Neni 61, “Të drejtat dhe subjektet e rivlerësimit pas dhënies së vendimit të komisionit”, dakord.

Neni 62 “Paraqitja e ankimit”, dakord.

Neni 63 “Njoftimi i ankimit”, dakord.

Neni 64 “Procesi gjyqësor”, dakord.

Neni 65 “Vendimi i kolegjit të apelimit”, dakord.

Neni 66 “Rivendosja në afate e së drejtës së ankimit”, dakord.

Kreu 9 “Dispozita të fundit”.

Neni 6 të jetë te neni 7 “Subsidiariteti”, dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Ju këtu thoni “nëse strukturat përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji”. Cilat janë këto struktura përgjegjëse?

Në radhë të parë, i bie që Kuvendi të ngrejë institucione.

E dyta, strukturë përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji mund të jetë ILDKPI-ja, mund të jetë Departamenti i Sigurisë së Informacionit, dhe ju thoni që, nëse asnjë nga këto institucione nuk ushtron detyrat brenda një afati të arsyeshëm për fillimin e veprimtarisë, atëherë avokati duhet të mbështesë dhe financojë krijimin e tyre.

Fatmir Xhafaj – Çfarë kuptoni me këtë?

Rainer Deville – *(përkthen përkthyesja)* Donim të bënim një parashikim, që garanton ngritjen e strukturave të vlerësimit dhe, nëse ka ndonjë pengesë që del diku, nuk ka zyrë, pra, nuk ka mundësi për të bërë edhe një telefonatë. Ne duam të garantojmë institucionet që mund të kalojnë aty, ose të garantohet procesi i vetingut, kjo është vetëm masë sigurie.

Fatmir Xhafaj – Kjo mund të na krijojë shumë probleme.

Vasilika Hysi – Mund të jap një argument? Zoti Rajner, Avokati i Popullit është institucion kushtetues. Kompetencat e Avokatit të Popullit përcaktohen në Kushtetutë dhe Avokati i Popullit nuk ka asnjë kompetencë që të mbështesë, aq më tepër të financojë, sepse ai nuk është buxheti i shtetit që të financojë aktivitete të tilla. Përndryshe, duhet të ndryshojmë nenet 68, 69, 70.

Fatmir Xhafaj – Mund të bjerë ky pretendim. Unë them ta lëmë të hapur dhe, nëse ka një zgjidhje që ta sqarojmë më mirë, jam dakord, por, kështu siç është nuk qëndron. Shumë faleminderit!

Rainer Deville – *(përkthen përkthyesja)* Në qoftë se në sistemin tuaj në Shqipëri e shikoni si problem dhe nuk po na ndihmon, atëherë më mirë ta heqim, por nëse besoni se ajo krijon probleme, hiqeni, nuk ka problem.

Fatmir Xhafaj – Me kujdes, me qetësi, sepse edhe qëllimi i tyre është pozitiv. Këtu thuhet “për sa kohë nuk është bërë godina”, le t’ia ofrojë këtë gjë. Ndoshta do një riformulim tjetër, ky është koncepti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Jo. Brenda sa kohësh duhet Këshilli i Ministrave t’i krijojë kushtet këtyre? Infrastruktura e zyrës së Avokatit të Popullit mund të shërbejë, kjo është logjika e tyre, që infrastrukturën e institucionit të Avokatit të Popullit ta vëjë në funksion për të ndërtuar procesin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do kohë sa të përshtatet gjykata.

Rainer Deville – *(përkthen përkthyesja)* Ndoshta, mjafton që në këtë parashikim të themi se për ndërtimin e institucioneve të vlerësimit, Avokati i Popullit mund të jetë i detyruar që ta mbështesë këtë strukturë. Pra, mund të jetë një mbështetje e përgjithshme.

Fatmir Xhafaj – Ta lëmë të hapur, me qëllim që ju së bashku me relatorin të bëni një riformulim më të qartë për këtë gjë.

Neni 68 “Selia e institucioneve të rivlerësimit pranë ndërtesës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda”. Çfarë do të thotë kjo?

Rainer Deville – *(përkthen përkthyesja)* Kjo pati një arsye shumë praktike, sepse Bashkimi Europian e ka ngritur këtë ndërtesë sipas standardeve dhe menduam që mund të kenë kapacitete, sepse, për shembull, mund të shkojë keq buxheti i gjyqësorit dhe i kemi dhënë një ndihmë këtu.

Fatmir Xhafaj – Të mos merremi me këtë gjë.

Vasilika Hysi – Jo, se janë të lidhura.

Fatmir Xhafaj – Pse nuk i vëmë detyrë qeverisë që brenda një afati të caktuar, brenda kaq muajsh, të gjejë mjediset e përshtatshme? Se si i gjen qeveria pastaj është detyrë e Këshillit të Ministrave kjo. Qeveria mund t’i mbledhë në një godinë të gjitha këto institucione dhe unë besoj që kjo mund të ndodhë.

Aurela Anastasi – Ne do të thoshim që edhe SPAKU të jetë në të njëjtën godinë, por qëllimi është që në bazë të ligjit të gjejmë vetë vendin ku do të rrinë, që të mos e implikojmë shumë qeverinë në këto gjëra.

Fatmir Xhafaj –Qeveria është e detyruar, ajo do ta mbajë me buxhet, kurse ju thoni që mos ta implikojmë qeverinë.

Aurela Anastasi – E kemi fjalën që të mos rrijë afër qeverisë me dhoma.

Fatmir Xhafaj – Nuk po them të rrijë në godinën e Kryeministrit, t'i ndajmë gjërat. Këshilli i Ministrave është institucioni që administrojnë pasurinë shtetërore dhe ai do të gjejë vendin, sepse qeveria ka marrë angazhimin që ta implementojë këtë, ajo do të marrë detyrimet e veta, nuk do ta implementojë Brukseli këtë. Qeveria do ta kontrollojë, do ta vëzhgojë, sepse ajo, që kur ka filluar këtë reformë, ka marrë përsipër që edhe ta implementojë. Kjo që po kërkon ju këtu është një pikë uji, me gjithë koston që ka ky projekt. Kjo mund të jetë një nga 7-8 godinat që do të sistemojë qeveria. Është një dhimbje koke e madhe, por do ta gjejë zgjidhjen.

(Ndërrhyrje e pa mikrofon)

Janë 12 plus stafi, janë afërsisht 40 veta, nuk ka vend. Të mos vëmë në ligj gjëra që do na kthejnë në të kundërt. Qeveria ka detyrim që të gjejë ambientet brenda kaq muajsh.

Riformulim neni 68.

Neni 69 “Marrëdhëniet kalimtare midis institucioneve”.

Vasilika Hysi – Kam një pyetje që lidhet me ligjin që sapo kaluam, “ Për qeverisjen”. Ne në dispozitën kalimtare të ligjit të qeverisjes, rregulluam komunikimin midis inspektoratit të vjetër dhe inspektoratit të ri dhe ne thamë që do të rregullohet në bazë të atij ligji, ndërsa ju këtu keni përmendur ligjin për statusin, por edhe te statusi ka. Po të shikosh ka një shpërndarje të dispozitave. Është treguar shumë vëmendje për inspektorin, është rregulluar gjithandej në dispozitat kalimtare me shumë detaje edhe te ligji “Për statusin”, edhe te ligji për qeverisjen, edhe këtu.

Rainer Deville – *(përkthen përkthyesja)* Ky është një problem, me të cilin përballemi në të gjitha legjislacionet, sepse i kemi paralelisht. Çdo grup pune që ndërton legjislacionin e mendon këtë gjë, por mjafton që këto parashikime transitorë t'i kemi vetëm në një ligj. Mendoj se Agnes ka bërë një listë të gjatë me parashikimet transitorë dhe ndoshta kjo listë do të jetë lista baza, kryesorja, por duke qenë se ju e kaluat atë para dy orësh, ne nuk patëm mundësi që ta pasqyronim këtu.

Fatmir Xhafaj – “Deri në krijimin e Njësisë së Posaçme Hetimore, sipas nenit 27 të këtij ligji, monitorimi i telekomunikimit të anëtarëve të institucioneve do të kryhet nga

Shërbimi Informativ Shtetëror”. Shërbimi Informativ Shtetëror me Kushtetutë dhe me ligj ka detyra të tjera, prandaj mos e fusni në këtë proces.

Pandeli Majko – Sepse Shërbimi Informativ Shtetëror nuk është i përgatitur për këtë lloj sistemi.

Fatmir Xhafaj – Jo, ka funksione të tjera kushtetuese.

Vasilika Hysi - Ai ka sigurinë kombëtare dhe ka përgjim parandalues.

Pandeli Majko – Në këtë lloj vakumi mund të kemi probleme, sepse dikush mund të jetë i interesuar në një fazë tjetër të na shtyjë deri në krijimin e Njësisë së Posaçme Hetimore, me qëllim që të mbetet në dorë të Shërbimit Informativ Shtetëror. Domethënë, po ofrohen skenare negative për të thënë që ta shikojmë pak.

Fatmir Xhafaj – Neni 69, dakord me ndryshimet.

Neni 70.

Vasilika Hysi – Në ligjin që sapo kaluam ne kemi dhënë dy konkurse për vitin 2016, një në shtator dhe një tjetër në prill, kurse ju këtu keni vënë numrat për kandidatët. Për cilin konkurs bëhet fjalë, për atë të shtatorit, apo atë të prillit? A është bërë një vlerësim aktual i nevojave? Ndërkohë, ne në ligj kemi thënë që sapo të hyjë në fuqi të dyja këshillat do të rakordojnë me Shkollën e Magjistraturës për të përcaktuar nevojat. Atëherë, duhet ta heqim këtë lloj parashikimi.

Rainer Deville – *(përkthen përkthyesja)* Fillimisht kapaciteti maksimal i Shkollës së Magjistraturës për një kurs është 25 dhe ky rregullohet me përmasat e klasave. Ky është numri maksimal që mbahet në një vit, për një grup profesorësh që mban një brez të caktuar. Nëse doni më shumë, atëherë do të kemi një kurs të ri, sisteme të reja dhe klasa të reja. Problemi tjetër është që shkolla e Magjistraturës në shtator fillon vetëm me 5 vende që janë kërkuar. Pra, kursi nuk do të jetë i plotë, duhet të fillojë me të paktën 25 vende, sepse, si rezultat i procesit të vlerësimit, disa njerëz, 10 njerëzit, mund të japin dorëheqjen dhe në vitet në vijim do të na duhen ata 10 njerëz që të na i plotësojnë këto vende bosh. Pra, në ligj na duhet numri 25, sepse ndryshe Shkolla e Magjistraturës dhe legjislacioni aktual nuk do të kenë mundësi të mbushin vendet bosh dhe duam të fillojmë që në shtator me këtë gjë. Pra, ky ligj kalon menjëherë për kursin e radhës. Do të keni dhe një tjetër në prill, nuk e kemi marrë parasysh këtu, edhe tjetrin, që do të jetë në shtator të 2017-s, bëjeni po kështu. Edhe në Kosovë 10% dhanë dorëheqjen. Nëse marrim me mend që edhe në sistemin tonë numri i të dorëhequrve do të jetë 10%, atëherë 10% do të largohen, pra nga 800 njerëz do të largohen 80, të cilët do të na duhet t'i zëvendësojmë. Pra 3 x 25 do të jetë numri që do të na plotësojë kapacitetet që do të na mungojnë.

Fatmir Xhafaj – Jam shumë dakord në parim, por pjesërisht me zgjidhjen tuaj.

Arsyetimi është shumë i drejtë, sepse, së pari, neni 70 nuk e ka vendin këtu, por te ligji “Për organizimin”, sepse ai përcakton dhe atje le ta vendosim.

Së dyti, është momenti që atje të vendosim një dispozitë, që Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, në bashkëpunim me misionet e asistencës dhe me organizmat e tjerë përgjegjëse të kësaj fushe, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi, të bëjë një rivlerësim të nevojave të mundshme dhe mbi atë bazë të përcaktojnë numrin e konkurrenësve për konkurrimin e parë.

Zonja Bernhard së bashku me zonjën Anastasi dhe me zoti Ibrahim, që kanë punuar, nën kujdesin tuaj dhe të relatorëve, të bëjnë një parashikim. E vendosim këtu apo atje nuk ka rëndësi, por duhet t’u japim atyre mundësinë që të kuptojnë se çfarë nevojash kemi. Për shembull, unë jam i bindur që, edhe pa e ndryshuar këtë, por vetëm me disa ndryshime që kemi bërë, pa dhënë njeri dorëheqjen, për shembull ndihmesat, njësitë e shërbimit ligjor, që keni krijuar ju, në Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë e të tjerë duhet të jenë me Shkollë Magjistrature. Vetëm sikur ta marrim atë kapacitet dhe ta investojmë menjëherë, në fillim, kam përshtypjen se për të krijuar njësitë e shërbimit ligjor do të na duhen të paktën 50-60 veta me Shkollë Magjistrature. Atëherë, le ta hapim me ta. Domethënë, kjo është logjika, pa e ditur sa do të japin dorëheqjen, sa do të heqë rivlerësimi. Po të shtojmë edhe 10 apo 15%, që të shërbejë pranë ministrisë, pranë inspektorit të Lartë e të tjerë, sepse ne e dimë që Inspektorati i Lartë do të ketë nevojë, Gjykata Kushtetuese do t’i marrë ndihmësit nga Shkolla e Magjistraturës, Gjykata e Lartë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor po ashtu, atëherë, le të fillojmë me këta, por le të bëjmë një parashikim minimal, në mënyrë që të fillojmë. Pra, ta kemi një dispozitë, e cila t’i hapë rrugë dy muaj më pas, nën kujdesin e EURALIUS-it, s’ka ndonjë gjë të keqe nëse themi në bashkëpunim me misionet e asistencës që asistojnë, sepse dispozitë tranzitore është ajo.

Dakord zonja Anastasi dhe zoti Rainer?

Faleminderit!

Zonja Hysi, ramë dakord që këtë nen ta riformulojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, bashkë me ligjin “Për statusin”, sepse janë në kooperim me ligjin “Për organizimin gjyqësor”. Bëjmë një riformulim bashkë me dy grupet që kanë punuar ekspertët. Pastaj se ku e vendosim këtë dispozitë tranzitore, te ky ose tek ai ligj, që, sipas meje ndoshta do të jetë më i mirë, kjo nuk ka rëndësi, por ne themi për efekt të këtij ligji.

Neni 71, “Aktet nënligjore”.

Qeveria ka akte nënligjore për pagat, shpërblimet dhe të gjitha këto?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj –Pra, të gjitha këto duhen vendosur tek aktet nënligjore, të gjitha institucionet që kanë detyrimin të nxjerrin klasifikimin e pagave, buxhetin. Propozoj buxhetin e të tjerë.

Vasilika Hysi – Bëhet: “Ngarkohet Këshilli i Ministrave brenda 30-ditëve të përmbushë detyrimin në bazë të paragrafit kaq të nenit kaq”.

Fatmir Xhafaj – E kam parasysh. Edhe Aulona e ka parasysh, sepse ka bërë ligje.

Neni 72, “Mbarimi i institucioneve të rivlerësimit”, dakord.

Neni 73 dakord.

Kam vetëm një gjë lidhur me deklaratat, shtojcat që keni këtu, ne i konsiderojmë të pranuar në parim, por do të duhet t’i rishikojmë edhe një herë për merak, deri në reflektimin tuaj. Ndërkohë që ju reflektoni, para votimit në tërësi i rishikojmë edhe këto. Dakord?

Pandeli Majko – Aurela, besoj se duhet gjetur një dizajn i mirë, sepse janë dokumente shumë serioze. Me këto letra do të kalojë i gjithë sistemi gjyqësor në sitë. Nuk ka një simbol të stemës së republikës, ndoshta Komisioni i Verifikimit do të kërkojë të ketë atë siglën e vet.

Fatmir Xhafaj – Është më mbrapa ajo.

Pandeli Majko – Shikojeni në vazhdim, sepse ishin shumë të thata.

Vasilika Hysi – Kisha një pyetje për zotin Rainer. Formulari i deklarimit të pasurisë, është standard i miratuar, apo ju keni bërë ndonjë ndryshim?

E dyta, është formati fillestar i deklarimit të pasurisë, apo do të bëjmë dhe periodikun, sepse janë dy lloj deklarimesh, deklarimi fillestar, pastaj periodik. Nëse këto formate janë standarde, i ka shumë mirë Inspektorati i Lartë i Kontrollit të Deklarimit të Pasurive, nëse i kanë bërë ndryshime, atëherë duhet ta formatojmë.

Aurela Anastasi – Faleminderit!

Këtu përpara keni formularin e ILDKPI-së për vlerësimin fillestar të pasurisë, por është adoptuar, duke përmbushur edhe kërkesat e ligjit tonë. Nuk është vetëm ajo çfarë na është ofruar vetëm nga ILDKPI-ja, por e kemi përshtatur në përputhje me kërkesat e ligjit tonë.

Fatmir Xhafaj – E keni marrë në konsideratë formularin e integritetit, atë që plotësojnë deputetët, zyrtarët e lartë? Shikojeni një herë, se kam përshtypjen nuk e pashë këtu.

Aurela Anastasi – Këtu është në bazë të ligjit tonë.

Fatmir Xhafaj –Shikojeni atje, se është më i plotë ai.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Pse të duket e çuditshme? Patjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fatmir Xhafaj – Jo, është shumë i varfër. Formulari për integritetin që ka miratuar Kuvendi, si standard është shumë i mirë, pastaj, plus, minus elemente mund t’i vendosni ju.

Atëherë, biem dakord për t’i reflektuar edhe te formularët.

Edhe një herë shumë faleminderit!

Keni bërë një punë të shkëlqyer, ky nuk është vetëm vlerësimi im, është vlerësimi i relatorit, i të gjithëve, i kolegëve, i grupit të deputetëve këtu.

Shpresoj që edhe këto ditë do të duhet të reflektoni se çfarë u tha, përputhshmërinë e saj me ligje të tjera, sepse është shumë e rëndësishme që të kemi një standard dhe të kemi mundësi që në ditët e para të javës së ardhshme të bëjmë votimin në tërësi të projektit. Kjo do të thotë që projekti duhet të jetë i zbardhur, i reflektuar, me ndryshimet përkatëse, me *footnote*-t e nevojshme që të jetë i gatshëm për Kuvendin.

Faleminderit zonjës Anastasi dhe zoti Deville.

Zoti Deville, është pak t’ju falënderoj vetëm për këtë ligj, por për të gjitha atë se çfarë jeni duke bërë. Është merita juaj që keni koordinuar dhe jeni duke koordinuar një punë të jashtëzakonshme në këtë proces dhe ne ju jemi mirënjohës për këtë gjë.

Faleminderit ekipit tuaj për punën e lodhshme që kanë pasur me këtë projekt, si edhe me projektet e tjera!

Faleminderit kolegëve dhe stafit tonë për durimin e treguar gjatë ditës së sotme!

Pa dyshim një falënderim shkon edhe për dy zonjat e përkthimit, që me thënë të drejtën, gjatë gjithë kësaj kohe ju kam pasur në vëmendje, por besoj se nuk keni bërë keq që keni qëndruar, sepse, nëse doni reformën në drejtësi, duhet që edhe ju të jepni prova.

Faleminderit teknikës dhe të gjithëve! Për ata që do të kenë mundësi të bëjnë pushim në fundjavë, t’ia kalojnë gëzuar, ne të tjerët le të vazhdojmë të punojmë për atdheun.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë